



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 DHE 17 MAJ 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. I 17. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe të plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin rrugor,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012,
13. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012,
14. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013,
115. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o tržištu nafte i naftinih produkata na Kosovu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-048 o Menadžiranju javnih financija i odgovornosti, izmenjenog i dopunjenog zakonima br.03/L-221 i br. 04/L-116,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti izvora novinarstva
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o putnom prevozu,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o bezbednosti i zdravlja na radu,
9. Drugo razmatranje Nacrta Poslovnika Skupštine Republike Kosova,
10. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja o budžetu Republike Kosova za 2012.godinu,
11. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Nezavisne komisije za rudnike i minerale, za 2012.godinu,
12. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Nezavisne komisije za medije, za 2012.godinu,
13. Razmatranje Izveštaja o radu Sudskog instituta Kosova za 2012.godinu,
14. Razmatranje zahteva Fonda za penzijske štediše Kosova za usvajanje godišnjih tarifa za 2013.godinu,
15. Formiranje Ad hoc komisije o izboru jednog člana Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas Rendit të Ditës, të përgatitur nga Kryesia në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pika e parë e rendit të ditës është:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka disa kohë që mediat e ndryshme të shtypit, të përditshme apo elektronike, duke abuzuar në emër të lirisë së shtypit, kanë rifilluar edhe njëherë një fushatë të shfrenuar shpifjesh, sajesh dhe përbaltje të disa prej vlerave më të vyera të ngjarjeve dhe personaliteteve publike e politike të Kosovës.

Në epiqendër të gjithë këtij shfrenimi propagandistik janë sidomos ngjarjet e luftës së fundit në Kosovë, personalitete drejtuese të saj, figurat më thelbësore dhe më eminente dhe e gjithë kjo të duket si një reminishencë nga e kaluara pushtuese e vendit tonë. Ndoshta, rastësisht e ndoshta jo rastësisht, në kuluaret e mediave kanë dalë e po dalin terma që kemi menduar të jenë përdorur vetëm nga strukturat politike e policore serbe, por që mjerisht po shfaqen edhe njëherë fuqishëm me tërë tërbimin e tyre mediatik.

Unë e kuptoj dhe e vlerësoj lirinë e shtypit, sidomos lirinë e shtypit të lirë, të pavarur, i cili nuk ka drojë se duke investiguar mbi ngjarjet e djeshme e të sotme po bën gjë që nuk duhet, përkundrazi, me gjithë forcën time e mbështes fuqishëm një shtyp të tillë. Mirëpo, pa dashur të futem në një terren që nuk më takon, mendoj se është koha që Kuvendi me ligje të veçanta të marrë në mbrojtje vlerat e pamohuara shumëdekadëshe të luftës për liri, sidomos të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bartësve të saj.

Është e pazakontë që Kuvendi i Kosovës, deputetët e strukturat e tij të lejojnë këtë përdhosje të vlerave të cilat në fund të fundit janë shndërruar në lirinë e vendit tonë, ashtu si është e pazakontë që nëpërmjet këtyre telallimeve, me të cilët duket të bashkëpunojnë edhe strukturat e vendosura në Kosovë, të hidhet baltë mbi vlerat e luftës.

Nuk më duket e paqëllimshme, që përmes këtyre portaleve mediatike e pastaj përmes faqeve të gazetave, të lansohet lajmi se po përgatitet arrestimi e penalizmi i njërit prej drejtuesve kryesor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotit Sylejman Selimi e 6 bashkëluftëtarëve të tjerë.

Në 14 vjet, në të gjitha zonat më të rëndësishme operative të Luftës Çlirimtare, ka pasur procese të tilla, dënime pas dënimesh, ende vazhdojnë disa procese, janë ngritur e po ngritën grupe hetimore e pas tyre vijojnë lansime mediatike, të cilat jo vetëm që nuk janë të njohura, por edhe të papranueshme.

Sylejman Selimi, ka qenë drejtues i Zonës Operative të Drenicës, e njohur si Zona e Parë e UÇK-së e më pas edhe komandant i përgjithshëm i saj. Është njëri ndër figurat më të spikatura të luftës, jo vetëm për aftësitë e trimëritë që tregoi, por edhe për qëndrimin e tij humanitar e njerëzor.

Në 14 vjet, që pas përfundimit të luftës, asnjëherë e nga askush nuk u dëgjua dhe nuk u përfol figura e tij politike ushtarake, ndërsa tani si një lajm i sigurt, megjithëse mund të jetë krejt i rremë, mësojmë se ndaj tij dhe 16 bashkëluftëtarëve po ngritët një aktakuzë e periudhës së luftës.

Edhe më herët kam diskutuar në këtë sallë, të nderuar, për atë që mund ta quaj “syleviqizimi” i politikës ndëshkuese në Kosovë, ose më saktë fabrikimi i fakteve e dëshmimeve. Kur e ngrita për herë të parë këtë problem, dikush edhe në këtë sallë u trazua, se mos po futem në kompetencat e dikujt tjetër, pavarësisht se njerëz të pafajshëm po vuajnë dekada burgu dhe nuk u trazuan të bëjnë presion mbi Qeverinë, për të sjellë ligjin e duhur të pastrimit të politikës dhe të institucioneve nga shërbyesit e djeshëm të policisë dhe shërbimeve sekrete serbe, që ndodhin në çdo vend të pavarur.

Me fabrikime provash u dërgua dy herë në Hagë, komandanti i Zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj dhe dy herë u deklarua i pafajshëm, me fabrikime provash u dënua në Kosovë togeri Idriz Balaj, por në Hagë këto prova u dëshmuan të fabrikuara.

Me prova të sajuaara ishte në Hagë, Fatmir Limaj, ndërsa atje doli i pafajshëm, në Kosovë vazhdon tragjikomedia e gjyqit të tij. Me prova të tilla vazhdon gjyqi kundër drejtuesve të Zonës Operative të Llapit, Remit e shokëve të tij.

Dhe, unë kam të drejtë të pyes, deri kur do të lejohet që në Kosovë, një tufë sojsozësh të fabrikojnë prova kundër drejtuesve të luftës dhe në 14 vjet nuk kemi asnjë gjyq ndaj atyre që vranë mijëra shqiptarë dhe i zhdukën edhe trupat e tyre.

Të nderuar deputetë,
Shumë prej jush që jeni në këtë sallë...

(Ndërprerje nga regjia)

Pjesë e diskutimit e dorëzuar me shkrim

...keni qenë pjesë e rëndësishme e pavarësimit të Kosovës.

Të mos lejojmë që kjo pjesë vitale e jetës sonë të merret nëpër këmbë, në emër të sajuesve dhe fabrikuesve të provave e dëshmimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola që në emër të Grupit Pralamentar të LDK-së të shpreh shqetësimet tona për zhvillimet e fundit në Agjencinë Kosovare dhe për Agjencinë Kosovar të Privatizimit.

Këto që po ndodhin ditëve të fundit vërtetojnë edhe njëherë qëndrimin korrekt, të drejtë, ligjor, parimor të LDK-së, që ka qenë që ky bord i cili është zgjedhur nga deputetët e Kuvendit, ata që e kanë votuar, po vërtetohet që LDK-ja ka pasur qëndrimin e drejtë, sepse e kemi thënë, e përsërisim që politizimi dhe shndërrimi i bordeve dhe agjencive të pavarura në borde partiake, po e sjell vendin në këtë gjendje që e ka sjellë.

Prandaj, po ashtu e konsiderojmë që është edhe hipokrizi edhe cinizëm tash të dëgjosh po nga ata që e kanë votuar, se po u dashka shkarkuar zotin Rexha, në këtë rast. Sidoqoftë, mbetet në ndërgjegjen e të gjithë atyre që e kanë bërë një gjë të tillë më herët, por ajo që po e them në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne jemi të bindur që edhe institucionet tjera të ashtuquajtura të pavarura e që janë votuar nga ky Kuvend dhe që LDK-ja s'ka marrë pjesë në votim edhe BQK-ja, edhe kjo agjenci, edhe ato tjerat do t'i presë fat i njëjtë.

Ky fat i keq dhe fatkeqësisht i keq për ne, sepse po dëshmohet se në këtë agjenci dhe në disa agjenci tjera, thjesht bëhet politikë partiake në dëm të interesave të vendit. Andaj, largimi i zonjës Roberts, përfaqësueses së SHBA-ve nga kjo agjenci është sinjali edhe më i fuqishëm për ata që deri tash s'e kanë pasur të qartë se në këtë agjenci punët janë shumë keq dhe po luhet me pronat e vendit tonë dhe me privatizimin e atyre aseteve të rëndësishme që i ka Kosova.

Prandaj, kërkojmë që të iniciohet procedura konform asaj që e parashohin rregulloret, ligjet, të shkarkimit të zotit Rexha nga kryesuesi i bordit, por ne jemi që të shkarkohet i tërë bordi, sepse konsiderojmë që ky bord jo vetëm zoti Rexha, po edhe anëtarët tjerë nuk përfaqësojnë ata që do të duhej t'i përfaqësonin, por përfaqësojnë interesa të caktuara politike dhe partiake. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, në emër të Grupit të "Vetëvendosjes".

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në muajin mars të vitit 2011 Qeveria e Thaçit doli e suksesshme përfundimisht me kontrabandimin e privatizimit të PTK-së përmes Kuvendit. Pra, pas dy përpjekjeve të dështuara, që i patëm gjatë vitit 2010, kur herën e parë llogaritej se Kuvendi ka miratuar vendimin edhe pse qartazi nuk kishte pasur kuorum dhe herën e dytë, kur ky tentim kontrabandimi e shtyu përpara procesin e rrëzimit të Qeverisë, me kontrabandimin e tretë Qeveria e futi vendimin për privatizim të PTK-së si nën të Ligjit për buxhetin për atë vit.

Që prej këtij momenti PTK-ja u tenderua dy herë. Në procesin e dytë atë të ritenderimit, kushtet e parakualifikimit ishin, që aplikuesi ose udhëheqësi kryesor i konsorciumit duhej të demonstronte, se

- a) Është ofrues i shërbimeve të telefonisë mobile gjatë tre vjetëve të fundit, ose nën
 - b) Në tre vjetët e fundit të ketë të hyra mbi 300 milionë euro, ose nën
 - c) Duhet të ketë asete në menaxhim prej së paku 750 milionë euro në vitin 2012, ose të ketë ngritur së paku 250 milionë euro në 7 vjetët e fundit.
- Dhe, nga këto kritere:

- 1. I ka investuar ose është investitor me 20% pronësi në një operues të telekomit, që kalon vlerën në një vit të investimit, ose nën
- 2. Ka pranuar letër të qëllimit për të hyrë në një konsorcium më së paku 10% të një kompanie me vlerë prej 300 milionë eurosh,
- 3. Ka pranuar letër qëllimi për të hyrë në një marrëveshje me operues të telekomit, që kalojnë vlerën 500 milionë euro, ose nën
- 4. Ka aksionarë që kanë menaxhuar një investim mbi 20% në 10 vjetët e fundit, që ka pasur qarkullim së paku 500 milionë euro gjatë një viti, ose punëson njerëz që kanë investuar më shumë se 20% në 10 vjetët e fundit me një operator të Telekomit me qarkullim mbi 500 milionë euro.

Më 29 prill të vitit 2013 gazeta “Jeta në Kosovë” e ka publikuar një intervistë me drejtorin menaxhues të AXOS-it, i cili zbulon se mjetet për privatizimin e PTK-së vijnë nga një entitet, të cilin e kontrollon ACP (AXOS Capital) e që quhet AXOS Kajman, i cili ndodhet në ishujt Kajmen, kompani kjo e cila ka shërbyer si vegël për investime që nga viti 2007.

Ishujt Kajman janë të njohur si parajsa për para që i shmangen tatimeve dhe që fshihen nga kontrolli i shteteve për prejardhjen e tyre. Ky fakt e bën edhe më tronditës privatizimin e PTK-së, përkatësisht përzgjedhjen e kësaj kompanie të jetë fitues i këtij tenderi.

Përveçse bilancet financiare të ACP AXOS tregojnë për një kompani, e cila nuk ka muskuj të mjaftueshëm financiar, gjithashtu tashmë dihet se prejardhja e parave që do të përdoren për blerjen e PTK-së është e fshehur.

Nëse kjo kompani, ashtu siç pretendon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka menaxhuar ose mbledhur mbi 250 milionë euro viteve të fundit, si është e mundur që të hyrat e saj si dhe fitimi, në asnjë moment të mos kalojnë disa mijëra euro. Çdo kompani serioze në botë e që merret me menaxhim të mjeteve ka tarifë prej së paku 0,3% të shumës që e ka në menaxhim.

Rrjedhimisht, nëse ACP AXOS ka menaxhuar mbi 250 milionë euro, atëherë të hyrat e saj do të duhej të ishin së paku 7 milionë e 500 mijë euro për këtë menaxhim, por, në rastin e AXOS-it kjo shumë është mijëra euro.

Pra, nuk dihet prej nga vijnë paratë për blerjen e PTK-së, s'dihet se kush qëndron prapa AXOS-it dhe pretendimet e AXOS-it se ka menaxhuar 250 milionë euro nuk qëndrojnë dhe nuk mbështeten me asnjë dokument që ka të bëjë me këtë kompani. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Javën e kaluar më 10 maj, qytetarët e Zhegrës dhe të Karadakut, kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me protestën për mosrealizimin e një kërkesë të kamotshme për themelimin e Komunës së Zhegrës. Kjo ka ndodhur për shkak të interpretimit joprofesional dhe injorues që është bërë nga disa vendimmarrës, të cilët në mesin e 13 kërkesave që janë shtruar për komuna, nuk e kanë përmendur fare çështjen e Zhegrës.

Disa qindra qytetarë kanë organizuar protesta për tri ditë me radhë në shenjë të pakënaqësisë për këtë shpërfillje.

Kërkesa për komunë daton nga viti 2005, në të cilin vit është themeluar një iniciativë qytetare e Zhegrës, e të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre që të jetojnë në një komunë të mëvetësishme. Këtë vullnet ata e kanë deklaruar publikisht edhe me anketa, me intervista, me deklarata të ndryshme dhe ia kanë prezantuar edhe Kuvendit edhe Qeverisë edhe institucioneve tjera. 12 mijë banorët e asaj ane me 20 fshatra e kanë shprehur vullnetin e tyre dhe janë të interesuar që kjo gjë të ndodhë sa më shpejt.

Më duhet ta theksoj faktin se Zhegra për shkak të themelimit të komunës së Parteshit ka mbetur si një zonë e ndarë, si një trevë e ndarë, me të cilën trevë pak komunikohet. Ka mbetur, si të thuash, prapa diellit, madje edhe në një pano që ata e kanë nxjerrë, thuhet se: na janë mbyllur rrugët, na është mbyllur edhe goja.

Ata janë braktisur edhe nga përkujdesi institucional, për shkak se në atë pjesë është shkuar dhe shkohet nga institucionet vetëm në rastet kur ka përkujtime. Është e vetmja rrugë që shkon atje, i ngjan një rruge, një xhadeje të kohës së Turqisë, e cila duket se spërkatet herë pas here me asfalt, sa për t'u dukur që është një rrugë normale.

Unë apeloj nga këtu, nga njerëzit që marrin vendime, që t'i qasen këtij problemi më mirë dhe ta përfillin edhe kërkesën e qytetarëve të Zhegrës, e cila kërkesë është një vullnet i tyre e fundi i fundit, shprehja e vullnetit është diçka demokratike, të cilën ne nuk kemi ndonjë arsye që të mos e marrim parasysh, por që është e drejtë që ta trajtojmë me fuqinë ligjore, ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Përshëndetje, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë desha sot të ngre çështjen e një vendimi të Qeverisë javës së kaluar për themelimin e edhe një komune të re, pra të komunës së regjionit të Hasit.

Edhe ishte një befasi, po pak është edhe shqetësim, se cila është qasja në raport me këtë çështje. Kur të gjithë kemi pritur se ashtu siç ka qenë edhe e paraparë me Pakon e Ahtisarit, pas tre vjetësh t'i bëhet një analizë decentralizimit e i cili pastaj do të mund të shtohet apo të hiqet diçka nga ai proces, i cili nuk ka qenë shumë i sigurt se si do të përfundojë, po ne e dimë se deri ku ka shkuar.

Dhe, atëherë kur është pritur që t'i bëhet një analizë dhe kjo të rregullohet, ajo çka duhet të rregullohet, t'i hiqet apo t'i shtohet, tani kemi një vendim për themelimin e komunës, që në realitet unë konsideroj se është diçka shumë e ngutshme. Pse po e them këtë? Sepse në çdo rast, në këso situata, te këto reforma kaq të rëndësishme dhe të thella, gjithmonë duhet t'i paraprijnë parimet se mbi çka do të ecën ky proces më tutje?

Pra, duhet të përcaktohet edhe parimi i numrit të banorëve, edhe parimi i qëndrueshmërisë financiare, pastaj tërësisë territoriale, specifikave kulturore, e tjera, pra nga përvojat e ndryshme që kemi edhe në vendet tjera.

Nuk do të thotë, që Kosova të mos i ketë edhe 100 komuna nëse ka nevojë, por duhet paraprakisht të thuhet se cili është interesi dhe cilat janë parimet mbi të cilat do të ndërtohet kjo. Unë jam, jo vetëm për një komunë të regjionit të Hasit, unë jam bile edhe për dy, sepse tani do t'u largohen shërbimet qytetarëve nga Gjonaj deri tek Rugova atje. Pse të mos bëhen dy? Të jetë një komunë e Hasit për regjionin e Gjakovës, me seli në Rugovë dhe një komunë e regjionit të Hasit, pra të regjionit të Prizrenit, me seli po e zëmë në Zym apo në Gjonaj. Nuk është një problem kjo.

Mirëpo, unë mendoj se kjo është një qasje e gabueshme dhe nuk është serioze, sepse ligji për kufijtë administrativë, që do të duhet pastaj ta futë brenda këtë çështje, nuk është reale që do të miratohet brenda dy muajve. Dhe, nga ana tjetër, komuna nuk duhet të lejë përshtypje se po i dhuron dikush. Unë e di, që nga njëherë ka qenë situata kur sundimtarët dhe grurin edhe orizin e kanë përshkruar që është meritë e tyre, por komuna nuk duhet të falen, komunat duhet të bëhet analizë, që të emërohet.

Prandaj, unë thërras Qeverinë, që ta hapë si proces. Do të marrim pjesë edhe ne si LDK, nëpërmjet komisionëve parlamentare, t'i japim një kontribut, sepse është një proces që po që se sot gabohet, vështirë që mund të sanohet edhe pas tre muajsh apo edhe në ndërrim të pushteteve, që sigurisht që do të ndodhin së shpejti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë do të ngre për diskutim po ashtu një çështje që paraprakisht e ngriti deputeti Ferati, i cili ka të bëjë me këtë vendim arbitrar, që ditë më parë mori Qeveria e Kosovës për themelimin e komunës së rajonit të Hasit, përkatësisht të Rugovës.

Ky vendim i çuditshëm dhe paradoksal ngre shumë pikëpyetje dhe dilema për banorët e asaj ane, si për kohën kur është marrë, kohë kjo kur Kosova është në vit zgjedhor, mënyrën se si është vendosur për krijimin e këtij entiteti të ri administrativ, ashtu edhe motivet e dyshimta politike, që e kanë kushtëzuar një veprim të këtillë të kësaj Qeverie.

Kështu, shqetësimet e qytetarëve të Hasit lidhur me këtë çështje e kanë burimin, që nga baza e dyshimtë ligjore e këtij vendimi, analizat e munguara të fizibilitetit lidhur me këtë komunë, limitet financiare për vetë ekzistencë komunale e deri tek shpërfillja flagrante e vullnetit të shumicës së banorëve të asaj ane, që iu bë nga ana e kësaj Qeverie para se të merrej ky vendim.

Rrjedhimisht, në vend të ofrimit të informatave të duhura për arsyeshmërinë e këtij vendimi, se pse u mor në këtë mënyrë dhe në këtë kohë, zyrtarët e këtij Kabineti qeveritar tentuan t'i kompensojnë këto deficite sipas një fryme tipike propagandistike.

Kështu, konkretisht, madje edhe ministri i Punëve të Jashtme, ngarendi që ta kumtojë këtë lajm në rrjetin e tij social, me një retorikë tipike demagogjike, duke e quajtur atë një vendim të zhvillimit dhe identitetit e deri tek një vendim për “Hasin evropian”. Situata më absurde, besoj që nuk ka, një ministër i Punëve të Jashtme, që merret me ndarjen e brendshme administrative të vendit.

Sidoqoftë, në mënyrë simptomatike kjo ngjarje tregon karakterin manipulativ të këtij vendimi dhe frymën e arbitraritetit që e ka pushtuar çdo pore të kësaj qeverie, mirëpo përtej absurditetit të kësaj situatë, është më se e qartë, se nëse ky vendim implementohet në këtë mënyrë, do të jetë me pasoja negative si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë administrativ dhe juridik për qytetarët e Hasit.

Përgjithësisht, ky vendim nën emrin e pavarësisë formale administrative e thellon edhe më tej vartësinë ekonomike të kësaj komune. Ndërkaq, në anën tjetër, ai shpërfill njërën nga qëllimet bazike për krijimin e një komune me synim ofrimin e shërbimeve administrative më afër qytetarit, sepse në bazë të këtij vendimi, pjesa më e madhe e fshatrave të Hasit, për shkak të konfiguracionit dhe terrenit që e karakterizon atë rajon, do ta kenë edhe më të largët dhe më të vështirë qasjen në këto shërbime.

Prandaj, me këtë strategji manipulative, kjo Qeveri jo vetëm Hasin, por edhe gjithë Kosovën e ka larguar me vite dritë e larg nga vlerat dhe standardet evropiane.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Duke kërkuar dokumentacionin për të aplikuar në Komisionin Qeveritar për Zhdëmtimin e ish të Burgosurve Politikë, në materialet e organizatës së vetme të pazbuluar të ilegalitetit të kohës, e cila ka pasur edhe sektorin e shtypit për të rinj dhe të rritur me titujt

“Zëri i Nxënësit” dhe “Republika e Kosovës”, për shpërndarjen dhe leximin e këtij shtypi janë dënuar në Gjykatat e Kosovës, në vitin 1981 dhe 1982, por baza e kësaj organizate ilegale asnjëherë nuk është zbuluar dhe e ka një arkiv modest.

Në këtë arkiv janë gjetur foto të fillim vitit 1989, ku identifikohet i uniformuar dhe i armatosur në regjionin e Prizrenit, në Therandë dhe në Malishevë, atëherë i riu, i hajthëm e i gjatë, i uniformuar dhe i armatosur, tani ministër i Mbrojtjes dhe zëvendëskryeministri i tashëm i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në këtë kohë kemi shumë të varurë dhe më shumë të plagosur, si në gjithë Kosovën edhe në këtë regjion në këtë kohë. Kërkoj nga kjo foltore, që në rrugë zyrtare të kërkohej sqarim nga zëvendëskryeministri i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, se çfarë veprimesh ka bërë duke qenë i armatosur në uniformë në këtë kohë, në këtë regjion të Kosovës dhe cili ishte roli i tij në vrasjet e kësaj kohe, ku dëshmitë e pranisë së tij, në mos më gjatë, atëherë nga janari deri në gjysmën e vitit 1990 janë të pamohueshme. Në rast se nuk mund ta mohojë praninë e tij në uniformë dhe i armatosur, gjithashtu praninë e tij, i uniformuar dhe i armatosur, do të duhej të sqaronte për opinionin sikundër implikimin e tij në këtë kohë kur dihen vrasjet makabre të kohës në këtë regjion, atëherë jo vetëm se e bën të pabesueshëm rolin e tij në këtë proces, por institucionet tona përkatëse duhet të hapin procedurë përgjegjësie për rolin e tij të drejtpërdrejtë në vrasjet dhe krimet e kësaj kohe, duke kërkuar nga ai të deklarojë edhe bashkëpjesëmarrësit tjerë në këto zhvillime tragjike madje edhe të tjerat më vonë në Kosovë.

Duke e rikujtuar deklaratën e tij para serbëve në veri të Kosovës se ‘jemi të detyruar ta pranojmë marrëveshjen, por kurrë ta njohim Kosovën e pavarur dhe çizmja shqiptare nuk do të shkelë në këtë pjesë të Kosovës’, të lë kuptosh se ky njeri ka përcaktim të hershëm kundër këtij vendi dhe është rob i krimeve të mundshme dhe dijeve të tij për krimet në të kaluarën e afërt, në Kosovë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče,

Poštovani poslanici,

Poštovani premijeru,

Meni je pripala čast da danas izvestim Parlament, kao i poslanike koji danas sede u ovom visokom domu, da je formirana nova poslanička grupa pod nazivom “Zajednička Budućnost”.

Kao i sam naziv što kaže, naša programska opredeljenja biće rad na poboljšanju stanja zajednica na Kosovu.

Poštovani predsedniče,

Poštovani premijeru,

Poštovani poslanici,

Poštovani ministri i članovi Vlade,

Rad ove poslaničke grupe u budućće će se bazirati na prioritetima kao što su sprovođenje i implementacija bliskog dogovora, kojem dajemo безусловnu podršku i gde želimo biti

aktivni učesnici procesa sprovođenja, kao i u procesu dijaloga koji se vodi između Beograda i Prištine, kojim se otvara evropski put Kosovu i integracija u evropsko društvo.

Ovom prilikom želim ta istaknem i podršku Vladi, s kojom ćemo nastaviti saradnju i podržavati procese koji su započeti kao što su izborne reforme, kao osnovne i planirane strategije, na kojima smi i do sada zajednički radili. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Ministra të Kabinetit Qeveritar,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Po dal të flas edhe unë lidhur me zhvillimet në pushtetin lokal dhe zhvillimet që lidhen me vendimin e fundit të Qeverisë mbi themelimin e komunave të reja në Kosovë.

Duke qenë njëri prej ministrave të parë, ministër themelues i portfolios dhe bartës i kësaj portfolioje në Qeveri dhe ministër i cili është marrë me reformën e pushtetit lokal, më lejoni që të them qartë, që edhe si kryetar i komunës së Gjilanit për pesë vjet edhe si ministër edhe tash si deputet, kam besuar se Kosova ka një nevojë për një pushtet të decentralizuar, funksional dhe në shërbim të qytetarëve.

Por, ajo që do të flas sot ka të bëjë me procesin i cili për mendim timin ka filluar mbrapsht në themelimin e komunave të reja me shumicë shqiptare, sepse ajo që lidhet me reformën e vitit 2005 mbi studimin, analizën, vlerësimin dhe fizibilitetin e pushtetit lokal në Kosovë e ka pasur historikun e vet dhe është arritur me konsensus në këtë Parlament, konsensusi në mes Qeverisë dhe opozitës në atë kohë, i cili ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në marrëveshjen, në Pakon e Ahtisarit, që lidhet me procesin e Vjenës.

Pas luftës Kosova i ka pasur 28 komuna, sipas kufijve të vjetër administrativ nga ish-krahina e Kosovës, ndërsa Përfaqësuesi Special i ka themeluar edhe dy komuna, me kërkesë të qytetarëve. Duke e balancuar prapë raportin etnik, Malishevën e rikthen apo ia rikthen statusin e komunës dhe Leposaviqit po ashtu, si komunë me shumicë serbe.

Me këto 30 komuna dhe me këtë hartë të kufijve komunal ne kemi negociuar diçka që në Vjenë ka pasur të bëjë me rishikim të plotë të drejtave të pakicave në pushtetin lokal dhe duke garantuar autonominë në pushtetin lokal, ne kemi themeluar 5 komuna me shumicë serbe, që kryesisht kanë përfshirë regjionin e Anamoravës, për shkak të koncentrimit të serbëve, e jo për shkak të dhuratës, që është bërë për ta.

Por, njëra nga provizionet kryesore të Pakos së Ahtisaarit ka qenë, që 3 vjet pas shpalljes së Pavarësisë, Kosova ka të drejtë ta rishikojë në tërësi funksionimin e pushtetit lokal, në veçanti komunat e reja, funksionalitetin e këtyre komunave, efektin që kanë mbërri, eventualisht numrin e popullatës dhe zhvillimet tjera.

Unë i kam bërë pyetje kryeministrit vitin e kaluar, duke e pyetur se kur është në plan të bëhet rishikimi, kryeministri ka premtuar se do të bëhet ky rishikim. Për të qenë edhe më specifik, dy herë zëvendëskryeministrin Petroviq, i cili është ministër i linjës, për dy vjet radhazi ia kam tërhequr vërejtjen se është vonuar në rishikimin e procesit dhe po ashtu, ka premtuar që do ta bëjë në fund të viteve e jemi në vitin e 5-të, kur Kosova hyn në rishikim të sektorit të sigurisë.

Sidoqoftë, më lejoni të them që procesi ka filluar mbrapshtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Për këto çështje, mendoj se mund të kërkonit debat e jo të ngrihet kaq shumë ky problem, se nuk është aq problem për publikun.

Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryetar!

Sot është 16 maji dhe pikërisht këtu e 14 vjet më parë, shokët e tij të burgut ishin ata që për herë të fundit e panë atdhetarin, intelektualin dhe politikanin e shquar shqiptar, Ukshin Hoti.

Ai u mor nga policët serbë dhe prej atëherë nuk është gjetur, por, sot kur forcat politike në Kosovë po garojnë më shumë se cila betejë e UÇK-së, cilit subjekt politik i takon më shumë, ne kemi nevojë më shumë se kurrë t'i kujtojmë disa porosi shumë të vlefshme politike të Ukshin Hotit.

Te Filozofia politike e çështjes shqiptare, Ukshin Hoti shkruan se pushteti politik nuk mund të jetë në funksion të vetvetes, përveç kur deformohet në tërësi, kurse sot në Kosovë ka ndodhur pikërisht kjo, për të cilën shqetësohej Ukshin Hoti, pushteti politik më së shumti i shërben vetvetes.

Ukshin Hoti thoshte se liria kuptimin e vet esencial e ka në funksion të zhvillimit të bashkësisë, kurse, këtu te ne liria është degraduar në mundësi përfitimi dhe pasurimi për një pakicë politike, e cila e ka monopolizuar pushtetin.

Edhe një porosi shumë e vlefshme e Ukshin Hotit për politikën e jashtme të Bashkimit Evropian dhe për EULEX-in. Ai në librin e tij shkruan se Kosova nuk mund të arrijë në Evropë, pa një demokraci autentike të vetëlindur prej saj. Me fjalë të tjera, demokracia e imponuar nuk është demokraci.

Prandaj, kur doni t'i nderoni dëshmorët është shumë kollaj, punoni sipas idealit të tyre, për të cilin ata e dhanë jetën, kurse kur doni ta nderoni Ukshin Hotin, nuk keni nevojë t'i thurni lavde shterpë, por më mirë aplikoni porositë e tij politike, se sa të derdhni lot krokodili për të, duke vepruar plotësisht kundër mësimit të tij kaq të çmueshëm politik.

Qeveria jonë ka dështuar po ashtu, edhe në një aspekt tjetër, ajo iu ka premtuar qytetarëve se do t'i sjellë të pagjeturit dhe do ta ngris çështjen e Ukshin Hotit edhe nëpërmjet negociatave me Serbinë dhe nuk e ka bërë asnjërin.

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
I nderuari kryeministër,
Ministra,

Unë desha të ngris një shqetësim të qytetarëve që pronat e tyre janë të kufizuara me Malin e Zi dhe një shqetësim tjetër që ka të bëjë me miratimin e Ligjit për zonën e Bjeshkëve të Nemuna si park nacional.

Është një shqetësim shumë i madh i 12 fshatrave të Rugovës, të cilët e kundërshtojnë dhe kanë dalë edhe në protesta dhe vërtet janë të shqetësuar për mënyrën se si do të zbatohet ky ligj.

Unë e di interesin që si zonë të jetë zonë e pastër, zonë e rregulluar me ligj, por ata kanë shqetësimin e pronave të tyre, të cilat kanë frikë se nuk do të kenë mundësi të përdoren. Prandaj, do t'i preferoja Qeverisë në këtë rast edhe deputetëve, që të komunikojnë me qytetarët e Rugovës për t'i sqaruar lidhur me ligjin.

Ndërsa, sa i përket zonës që kufizohet me Malin e Zi është në proces, janë në proces bisedimet lidhur me rregullimin e kufirit, por dua t'ju them se sipas vijës së shënuar dhe futjes së kufirit të Malit të Zi në Kosovë, shumë prona të shqiptarëve kudo, nga kufiri që lidhet në Istog dhe deri në Bjeshkët e Deçanit, kufiri i Malit të Zi i ka bllokuar rrugët lidhëse, të cilat janë përdorë nga qytetarët e Kosovës, për kullosat e tyre, për vendbanimet e tyre verore që i kanë pasur dhe pronat e tyre.

Prandaj, gjatë procesit të bisedimeve mendoj që ata që duhet të bisedojnë, duhet ta zgjidhin këtë problem, me qëllim që të mos e bllokojnë qarkullimin e qytetarëve në pronat e tyre dhe në zonat ku i kanë ata. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe i fundit që do ta ketë fjalën për sot, deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet Qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot e ngris një çështje e cila ka të bëjë me mos emërimin e ministrit të Financave. Po bëhen afër 4 muaj, që Ministria e Financave, Ministria më e rëndësishme e Qeverisë, e cila ka të bëjë me buxhetin e Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me paranë publike dhe me taksapaguesit e Republikës së Kosovës, është pa ministër. Pra, pas largimit të ish ministrit Bedri Hamza, qeveria Thaçi ende nuk e ka emëruar askënd në postin e ministrit për këtë Ministri.

Mungesa e ministrit në kohën kur është përgatitur raporti tremujor i shpenzimeve të parasë publike, si dhe aprovimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitin 2014-2016, tregon se për çdo shkelje eventuale apo shpenzim të tepruar, që janë bërë jashtë planifikimeve buxhetore për tremujorin e vitit 2013 është papërgjegjësi dhe jo seriozitet i kësaj qeverie, si ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe ndaj deputetëve të parlamentit të Kosovës, si dhe jo seriozitet ndaj organizatave financiare ndërkombëtare, siç është Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Pra, mosemërimi i ministrit nga Qeveria tregon papërgjegjësinë e institucioneve karshi shpenzimeve të financave publike. Raportet tremujorë të shpenzimeve tregojnë që po bëhen shpenzime të pakontrolluara, sidomos në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha organizatat buxhetore, ku vetëm këtë tremujor janë shpenzuar mbi 37 milionë buxhet për mallra dhe shërbime.

Prandaj, nëse kjo është arsye politike, mos emërimi i ministrit të Financave është vetëm për Partinë Demokratike dhe po ashtu, për partnerët e koalicionit, por jo edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe jo për Lidhjen Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu edhe përfundon pika e rendit të ditës koha për deklarime jashtë rendit të ditës nga deputetët.

Fjalën e ka kërkuar kryeministri. Zoti Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke respektuar edhe opinionet tuaja, duke respektuar edhe interesimin e opinionit publik kosovar, natyrisht se ndjej obligim që edhe t'i sqaroj disa çështje, që ju i ngritët këtu, por edhe të informoj drejtpërdrejt opinionin publik për çështjet që u ngritën edhe sot në Parlament, por edhe në ditët e kaluara.

Unë i kuptoj shumë drejt dhe i respektoj këto opinione, sepse vijnë drejtpërdrejt nga baza, vijnë drejtpërdrejt prej interesimit të qytetarëve të Kosovës anekënd Kosovës, opinione këto të shprehura prej deputetëve të gjitha partive politike të përfaqësuara në Parlamentin e Kosovës.

Do të ndalem menjëherë tek funksionimi i pushtetit lokal, pasi që ishte edhe temë që u ngrit këtu prej disa deputetëve, por që është ngritur edhe prej disa partive në ditët e kaluara edhe sa i përket vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për formimin e komunës së Hasit.

Unë dua të sqaroj që në fillim se në kohën e implementimit të pakos së Ahtisarit, ne në atë kohë nuk kemi pasur mundësi që të bëjmë komuna të reja, megjithëse disa prej tyre janë bërë. Qëllimi për formimin e komunave të reja nuk ka ndonjë qëllim as etnik, as motiv etnik, as qëllim politik, por është në kuadër të reformimit të pushtetit lokal dhe me

qëllim të qartë ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e këtyre komunave që janë krijuar. Pra, ofrimi i shërbimit më i afërt, më i mirë, më i lehtë dhe kjo është e nevojshme.

Unë dua t'ju siguroj, se për formimin e çdo komune të re në Kosovë do të respektohet Kushtetuta e Kosovës, ligjet e Kosovës, dokumenti i presidentit Ahtisari dhe Karta Evropiane për Pushtetin Lokal, vetëqeverisjen lokale. Gjithashtu, ju siguroj se do të merren përvojat më të mira të funksionimit të pushtetit lokal edhe në rajon.

Tani të ndalem te pyetjet konkrete që u shtruan.

Edhe unë personalisht si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, qeveria që udhëheq unë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, viteve të fundit ka pranuar një numër të konsiderueshëm të iniciativave qytetare për themelimin e komunave të reja.

Një nga kërkesat e hershme të pranura ka qenë edhe iniciativa e qytetarëve të regjionit të Hasit. Kjo shtrihet në kufijtë aktualë administrativë, siç e dini, të komunës së Prizrenit dhe Gjakovës.

Tjetër, dua të jem shumë i hapur me ju, por edhe duhet të jemi të sinqertë me njëri tjetrin, nuk ka parti që është në Parlamentin e Kosovës dhe që nuk është fare në Parlamentin e Kosovës, që se ka premtuar në fushata elektorale formimin e komunës së Hasit. E një nga ata të parët që e kam premtuar jam edhe unë dhe ndjehem shumë krenar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për formimin e komunës së Hasit.

Hasi me rrethinë e meriton për të qenë komunë më vete, por kemi pasur parasysh gjithmonë të gjitha kriteret e nevojshme për formimin e komunave të reja. Një gjë nuk duhet të harrojmë, unë personalisht dhe shumë prej jush, e di shumë mirë dhe e njeh kontributin e jashtëzakonshëm dhe heroik të Hasit, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Hasi dhe çdo familje në Has ka qenë shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kanë rrezikuar familjet e tyre, kanë ndodhur masakra dhe kontributi i tyre për çlirimin e Kosovës është heroik, i burrave dhe grave e fëmijëve. Kanë dhënë shumë heronj, ka shumë veteranë, kanë dhënë shumë dëshmorë dhe shumë invalidë të luftës.

Prandaj, ata qytetarët e nderuar të Hasit, meritën për komunën e vet e kanë vulosur me gjakun për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Dhe unë ndjej obligim edhe moral edhe qytetar edhe shtetëror edhe kombëtar për nxjerrjen e këtij vendimi, për formimin e komunës së Hasit.

Kam marrë vendim në Qeverinë e Kosovës dhe atij vendimi i qëndroj deri në fund. Sot, autoritetet e pushtetit lokal janë në terren. Do të formohet një grup transitorë dhe menjëherë do të fillojë funksionalizimi i kësaj komune, që do të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme.

Në këtë komunë do të përfshihen fshatrat që i takojnë regjionit të Prizrenit dhe fshatrat që i takojnë regjionit të Gjakovës. Kjo komunë do të përfshijë 41 fshatra. Kemi menduar se

si qendër provizore të jetë Rugova e Hasit me diku rreth 8 mijë banorë, që është fshati më i madh, ndërsa, të gjitha këto fshatra, kjo zonë e Hasit përfshin rreth 44 mijë banorë, duke përfshirë edhe diasporën.

Tjetër, se cila do të jetë qendra e komunës së Hasit, pas zgjedhjeve të lira, do të zgjedhën autoritetet legjitime dhe vetë autoriteti komunal le të vendosë, a janë që qendra të jetë në Rugovë të Hasit, në Gjonaj, apo në Zym. Ata le të vendosin, nuk është autoriteti ynë të vendosim. Unë do ta respektoj vullnetin e qytetarëve dhe vullnetin e të zgjedhurve të tyre, por ne kemi obligim të gjithë, ta mbështetim këtë vendim.

Pse e them këtë? As Komuna e Prizrenit, që është udhëhequr më herët nga LDK-ja, tash udhëhiqet nga PDK-ja, as Komuna e Gjakovës, që është udhëhequr më herët nga LDK-ja dhe tash nga AAK-ja, nuk kanë bërë mjaftueshëm për...

Pse Hasi të mbetet ende vetëm duke kërkuar qoftë për ndërtimin e rrugëve të reja, ambulancave, ujësjellësve apo elektrifikimit. Ai që e njeh Hasin, gjendjen në Has, ai e mbështet këtë vendim, prandaj unë i ftoj të gjitha forcat politike që për të investuar drejtpërdrejt në Has duhet të funksionalizohet kjo komunë dhe do të funksionalizohet dhe Hasi do të jetë përfitues i drejtpërdrejt i projekteve infrastrukturore për rrugë të reja, shkolla, ambulantë, ujësjellës, elektrifikim dhe të gjitha nevojat e tyre, drejtpërdrejt nga buxheti i Kosovës, dhe jo për të kërkuar vazhdimisht nga komuna e Prizrenit dhe për të mbetur në vullnetin e Komunës së Prizrenit apo të Gjakovës.

Të shtunën do ta vizitoj Hasin, të gjithë deputetët edhe të asaj zone dhe zonave tjera, të gjitha partive politike, jeni të ftuar të shkojmë ta inaugurojmë këtë vendim të gëzueshëm për qytetarët e Hasit.

Në anën tjetër, ky vendim nuk është partiak, është shtetëror, është në interesin e të gjithë qytetarëve të Hasit dhe më lejoni nga kjo foltore e shenjtë e Parlamentit të Kosovës, qytetarët e Hasit t'i uroj për formimin e komunës së re.

Por, ajo që dëshiroj të them tjetër, është kjo. Ne do të marrim vendime, do të marrim vendime tjera që do të formojmë edhe komuna të reja, sepse kemi iniciativa të qytetarëve për formimin e komunave të reja.

Unë kam pritur, një grup të qytetarëve, të udhëhequr nga zoti Pajaziti, gjithashtu zoti Idrizi....

(Ndërprerje e shkurtër)

...Zhegra, dhe vendimin për formimin e komunës së Zhegrës, unë prita që do ta ngrit edhe zoti Haziri, kur e kishte harruar, do të merret.

Falënderoj deputetët Pajaziti dhe Idrizi, për mbështetjen e tyre, për iniciativat e tyre, ndërsa zoti Hazirit, besoj se ndoshta do t'i bjerë ndërmend edhe atij, si Lidhje Demokratike e Kosovës, për Zhegër.

Në anën tjetër, sot në tavolinën time e kam edhe kërkesën e Orllanit, të Podujevës – Besianës, për formimin e komunës. Është kërkesa e Runikut të Skenderajt, Hogoshtit të Kamenicës, Reçan në Prizren, Gorë, Prizren, Rogoçicë, komuna e Kamenicës, Krushë e Madhe, Rahovec, Vitomiricë-Pejë, Komoran Glllogovc, Ponashec, Gjakovë, e gjithashtu edhe iniciativën e qytetarëve të Strelcit dhe Isniqit, zoti Zemaj, ata tash duhet të merren vesh se si do të bëjnë ndarjen administrative, por unë do ta respektoj vullnetin e këtyre qytetarëve. Por, në të njëjtën kohë, sot befasisht është kërkuar një takim nga një grup i madh i qytetarëve të Kodrës së Trimave, sepse janë të pakënaqur me investimet në këtë trevë të komunës së Prishtinës.

Pra, do t'i dëgjoj me vëmendje të gjithë iniciativat e qytetarëve të Kosovës, të gjitha lokaliteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Të gjithëve do t'ua jep fjalën, por me rend. Ismet Beqiri, e ka kërkuar fjalën, i ke dy minuta.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet ky ka filluar të bëhet shakaxhi tash, sepse e din fort mirë që Ligji i Prishtinës, që s'e ka bërë asnjëherë, s'e ka proceduar, parasheh qysh do të ndahet Prishtina. Po e nisi prej kësaj, edhe për Kodrën e Trimave, vazhdon të ëndërrosh, është punë e jotja, ata numër të mëdhenj të banorëve që të paskan qenë, OK!

Por po e them diçka se kjo është çështje më e madhe se sa kjo që e thatë veç për Kodrën e Trimave.

Së pari, vendimi juaj nuk është vendim, por është një iniciativë, sepse vendim për të formuar komuna, mund të bëjë vetëm ky Kuvend. E para.

E dyta, zoti kryeministër, ju e dini, ose do të duhej ta dini, që e thatë edhe vetë, po bëni fushatë, sepse këtë punë, shtrohet pyetja e thjeshtë, pse s'e keni bërë më herët?

Ju e dini që Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji për kufijtë administrativë, Ligji për financa lokale, të gjitha këto duhet të ndryshohen për ta bërë atë që po tentoni ta bëni, që ne nuk jemi kundër formimit të komunave, por ju po e shkelni ligjin me dy këmbët, sepse po merrni vendime joligjore, sepse po e bëni të kundërtën e asaj.

Së pari duhet të bëhen këto ndryshime e pastaj të formohen komunat. Dhe ky ishte marketing i juaji dhe përmendja e shumë komunave tjera. Duhet të merret, të studiohet qëndrueshmëria ekonomike, mendimi i banorëve, të bëhen këto ndryshime të ligjeve.

Ju asnjëherë prej këtyre s'e keni bërë dhe vetë e thatë që po e bëni për fushatë. 19 fshatra të Prizrenit, gjegjësisht të Hasit të Prizrenit e kanë më larg Rogovën se sa Prizrenin. Kështu nuk i ndihmoni në ofrim të shërbimeve të mira.

Ju thatë këta do të vendosin vetë e cila do të jetë qendra, më herët keni thënë që do të jetë Rogova, do të thotë e keni ndërruar këtë qëndrim të mëhershëm.

Prandaj, zoti kryeministër, respektoni procedurat dhe ne si Kuvend dhe si parti politike e kemi obligim edhe do t'iu ndihmojmë të gjithë atyre banorëve që kanë nevojë për komuna, por kështu siç e keni bërë, absolutisht është vendim i paligjshëm. Iniciativë mund të jetë për formim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka për dy minuta gjithashtu, Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kur kryeministri e mori fjalën prita që do të na ofrojë informacione që i adresojnë shqetësimet e qytetarëve të Hasit lidhur me këtë vendim, mirëpo ky vazhdoi me demagogjinë e tij politike që është madje edhe thelbi i veprimit të tij politik.

Tha se sa i përket vendimit për themelimin e Hasit, qëllimi nuk ka qenë qëllim etnik as politik, ndërsa pak më vonë tha se premtimi për komunën e Hasit ka qenë premtim i të gjitha partive elektorale, edhe premtim i partisë time. Pra, brenda një minute shumë të shkurtër, ra në kontradikta me vetveten.

Po ashtu tha se ky vendim nuk është as partiak, tha po është shtetëror. Unë i tregoj kryeministrit se nuk ka shumë kohë, para nja 2-3 javëve është mbajtur një takim edhe i deputetëve të Partisë Demokratike, me disa banorë të Hasit dhe iu është thënë se nëse e votoni Partinë Demokratike të Kosovës, ne do t'i marrim vendimet e këtilla.

Pra, është kërkuar vota, domethënë që të merret vendimi për themelimin e komunës së Hasit.

(Reagime)

Po, po! Edhe sa i përket, kush e njeh Hasin, unë ju garantoj se Hasin e njoh shumë më mirë se ju dhe pikërisht se e njoh më mirë se ju e kundërshtoj këtë vendim i cili është marrë në këtë mënyrë dhe nuk i adreson shqetësimet kryesore të qytetarëve të Hasit por ua vështirëson edhe më tepër shërbimet administrative dhe juridike atyre qytetarëve.

Pra, në bazë të këtyre konditave ky vendim është vendim puro politik dhe i cili nuk i kontribuon zhvillimit të Hasit në të gjitha segmentet e jetës.

Tha se edhe komuna e Prizrenit dhe e Gjakovës nuk kanë bërë sa duhet për Hasin. Është mirë që e pranoi, sepse slogani i tyre elektoral ka qenë se Prizreni është Jerusalemi i PDK-së ose slogane tjera, por kjo ka dëshmuar se ai është shndërruar në Jerusalem, në parajsë për pushtetarët e PDK-së, ndërsa në ferr për qytetarët e atij rajoni. Faleminderit.

KRYETARI: Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fatkeqësisht, kryeministri po i sheh qytetarët e Hasit si numra. Ata qytetarë nuk janë numra, janë njerëz me dinjitet, me të kaluar të pastër dhe me të ardhme të ndritur.

Komuna e Gjakovës asnjëherë nuk është pajtuar që ka bërë mjaft, por asnjëherë nuk ka qenë larg tyre dhe ne nuk kemi dilemë fare që do ta udhëheqim edhe një komunë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Pozdravljamo vašu odluku u vezi formiranja buduće opštine Has i čestitamo svim građanima na novoformiranu opštinu i lokalnu samoupravu.

Ali koristim priliku da vas upitam, poštovani premijeru za proces decentralizacije u mestima gde je većinsko stanovništvo Bošnjakë, konkretno mislim na opštinu Rečane koje zadovoljava i ispunjava sve adekvatne kriterijume Ministarstva lokalne samouprave. Zahvaljujem se.

KRYETARI: Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Pasi që kryeministri i Kosovës po më duket po e sheh Kosovën për nga aspekti territorial më të madhe dy herë se sa Gjermaninë, unë vetëm po i tregoj se Strellci ka qenë komunë në 1943, 1944, kështu që ambiciet e qytetarëve të Strellcit janë shumë më të mëdha se sa të jenë një komunë. Faleminderit!

KRYETARI: Më shumë se komunë veç nëse bëhet Republikë.

A e do fjalën? Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, i nderuar Zemaj, sa për autoritetin që me të vërtetë të ketë statusin e komunës, Strellci, mbështetjen time do ta ketë të plotë, ndërsa për Republikë, unë s'mund të siguroj dhe të garantoj, por si do që të jetë ne e kemi obligim t'i dëgjojmë vullnetet e qytetarëve dhe t'i respektojmë, atëherë kur krijohen kushtet, rrethanat dhe mundësitë. Tash është krijuar mundësia, e theksoj edhe një herë, nuk ka parti politike që është në Parlamentin e Kosovës, por edhe jashtë Parlamentit të Kosovës, që qytetarëve të respektuar të Hasit nuk u ka premtuar formimin e komunës së Hasit. Dhe këtu duhet të jemi të singertë të gjithë – edhe PDK-ja, edhe LDK-ja, edhe ky djali i “Vetëvendosjes”, edhe AAK-ja, edhe të gjithë.

Dhe, tash ne e kemi marrë vendimin dhe një nga ata të parët që e kam premtuar ka qenë jam edhe unë.

E tash, ne mund të flasim çka të duam, mund të flasim në emër të vullnetit të qytetarëve të këtij apo atij lokaliteti, por jam i sigurt se sikur të mbahej apo të respektohej vullneti apo një referendum në Has, rrafsh 100% qytetarët e Hasit janë për formimin e komunës së tyre. Dhe këtë të drejtë s'mund t'ua mohojmë ne, prandaj asnjë parti politike të mos kërkojë dhe ju ftoj që këtij lajmi të Qeverisë së Kosovës t'i gëzohen të gjithë, edhe LDK-ja, edhe këta të "Vetëvendosjes", që janë kundër.

Prandaj, e kam dëgjuar edhe opinionin e partive të ndryshme në nivel lokal. Kanë të drejtë të diskutojnë, kanë të drejtë t'i shprehin opinionet e tyre, por unë ju ftoj të gjithëve ta mbështesni, pastaj le t'i fitojë zgjedhjet kush të dojë kush e meriton në Has. Por e di që ai që fiton në Has, do të ketë punë shumë, se unë do ta përkrah si Qeveri e Kosovës në mënyrë shumë të fuqishme në projektet për rrugë, për shkolla, për infrastrukturë, për të gjitha nevojat e qytetarëve atje, për ujësjellës, për elektricitet dhe nevoja tjera të qytetarëve, kanalizime dhe ujësjellësve në Has.

Unë e theksova edhe më herët se kam pritur që edhe deputetët e partive tjera ta ngrenë çështjen e formimit të komunave të reja, sidomos në Zhegër, qysh e ka ngritur edhe zoti Pajaziti, Kryeziu dhe zoti Hyseni.

Zoti Haziri diskutoi këtu, as që e përmendi Zhegrën, ndoshta e ka harruar, por unë ju ftoj që në momentin që e marrim vendimin të na përkrahni se nuk bëhet për një parti politike as Hasi, as Zhegra e as komunat e tjera.

Ndërsa, unë e theksova, jo për të polemizuar me ju, i nderuari zoti Beqiri, as me LDK-në, as me askënd tjetër, por vetëm e prezantova informatën e interesimit të iniciativës qytetare të Kodrës së Trimave për formimin e komunës së tyre.

Mirë se erdhe zoti Kryeziu, urime komuna e Hasit! Faleminderit për mbështetje, se edhe ju e keni premtuar herët.

Prandaj, zoti Beqiri e dini që edhe komuna e Prishtinës e meriton së paku t'i ketë 5 komuna, por kur do të merret ky vendim, natyrisht se ky është kryeqytet do të diskutojmë bashkërisht kur është e nevojshme dhe e domosdoshme edhe funksionale.

KRYETARI: Kundër-replikë, një minutë, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Jo shumë kundër-replikë sa edhe një sqarim, sepse është interesant se si i devijon gjërat. E thatë në fund, e pranuat një fakt, Ligji për Prishtinën, zoti kryeministër që është në procedurë, i parasheh 5 distrikte në komunën e Prishtinës, ose në kryeqytet, në mesin e tyre është edhe Kodra e Trimave.

5 distrikte, ju e dini këtë, quhen kësisoj, por i quajmë komuna, emri, është problemi më i vogël. Po është marrë nga rregullimi i Londrës. Kësisoj i kanë quajtur, distrikte, ne mund t'i quajmë komuna, prandaj, në emër të kësaj, ju e dini, s'kemi nevojë ta pritni asnjë banor, sepse këtë do t'ua garantojë ligji që shpresojmë do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe një herë po e them, nuk është LDK-ja kundër formimit të komunave, nuk është kundër, por të respektohet ligji.

Ju lutem kryeministër, shpjegoja qytetarëve a duhet të ndryshohet Ligji për vetëqeverisje lokale, a duhet Ligji për kufijtë administrativë, a duhet Ligji për financa publike...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe kryeministri, kundër-replikë, një minutë e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë përsëri, i nderuari zoti Beqiri, dëshiroj të sqaroj. Distrikti është diçka tjetër, është qark, ndërsa komuna është komunë.

Ligjin do ta nxjerrim bashkërisht, Qeveria e Kosovës dhe komuna e Prishtinës, në koordinim. Natyrisht, ne do të mendojmë, edhe sikur në të kaluarën, se Prishtina ka nevojë për 5 komuna, por jo distrikte, që të jenë më funksionale dhe nuk është e drejtuar kjo kundër asnjë partie politike, por të qenë më funksionale.

Ndërsa për Hasin, sinqerisht ju ftoj për mbështetje. Ata qytetarë kanë nevojë. për mbështetje politike, se vendimi tanimë është i arritur nga Qeveria e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë seancën.

Njoftim:

Ju njoftoj se në mbështetje të nenit 67 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 20 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2013, u njoftua lidhur me formimin e Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” në përbërjen e këtyre deputetëve:

1. Goran Marinković, kryetar i Grupit;
2. Sasha Gjokiq, zëvendëskryetar,
3. Biserka Kostiq, anëtare,
4. Vesimir Saviq, anëtar,
5. Boban Todorović, anëtar,
6. Milivoje Stojanović, anëtar dhe
7. Etem Arifi, anëtar.

Kalojmë në pikën – Koha për pyetje parlamentare.

Për këtë seancë janë parashtruar 14 pyetje parlamentare.

E fillojmë me deputetin, Nijazi Idrizi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

Blerandi nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen, deputet?

Atëherë, po vazhdojmë.

Deputetja Vesna Mikiq, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

VESNA MIKIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Gospodine ministre, imajuci u vidu da sastav zaposlenih unutar policijskih stanica u srpskim opštinama treba da oslikava sastav stanovništva odnosno proporcionalnost opština. Zašto to slučaj nije sa opštinom Ranilug, ako uzmemo u obzir da opštinu Ranilug čini više od 99% zaposlenih srpske nacionalnosti, a trenutno stanje zaposlenih unutar policijske stanice je više od 50% zaposlenih iz albanske zajednice.

Da li je ovo slučajnost ili namera? Hvala!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Në Policinë e Kosovës kemi instaluar sistem të bashkëpunimit me komunitetin në forma të ndryshme, sidomos përmes forumeve për siguri publike në të cilët janë të përfaqësuar të gjitha komunitetet përbrenda komunës. Kjo na ka mundësuar të jemi më afër qytetarëve, të ndërtojmë një partneritet të qëndrueshëm me institucionet e pushtetit lokal, që ta zhvillojmë vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikojë brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandojë planet e veprimt për t'i adresuar këto brenga.

Komuna e Ranillugut është një nga komunat e reja dhe pas themelimit të kësaj komune, Policia e Kosovës e ka themeluar stacionin policor. Përfaqësimi në këtë stacion është 54,17% shqiptarë, dhe 45,83% të komunitetit serb.

Kjo situatë e përfaqësimit të stacionit policor me shumicë serbe është për këtë arsye. Drejtoria rajonale e Gjilanit bën përpjekje për caktim të policëve të përkatësisë serbe nga komunat tjera, por që të njëjtit nuk e parapëlqejnë caktimin e tyre në këtë stacion, për shkak të vullnetit që të shërbejnë në komunat e tyre për arsye familjare dhe kostos së shpenzimeve.

Ka zyrtarë policorë të komunës së Ranillugut, por që të njëjtit janë të sistemuar në pozita dhe njësitë tjera në Drejtorinë rajonale të Gjilanit dhe në nivelin qendror në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme.

Gjithashtu stacioni policor në Ranillug është ndër stacionet më të reja në Policinë e Kosovës dhe kuptohet se seleksionimi dhe caktimi i personelit kërkon kohë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar dhe e vendosur që të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve t'u ofrojë shërbime cilësore përmes përfaqësimit të punonjësve të Policisë

së Kosovës në shkallën më të lartë të mundshme që reflekton përbërjen etnike të popullsisë.

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zonja deputete?

VESNA MIKIĆ: Hoću da vas ispravim da nije istina da Srbi ne žele da rade u svojim opštinama odnosno policijskim stanicama, jer ja mislim da problem leži zapravo prilikom raspisivanja konkursa i suviše dovoljan broj je prijavljen od strane srpske zajednice ali nažalost prilikom konkurisanja su oni odbijeni, ne znam iz kog razloga, i verovatno leži u tome problem prilikom zapošljavanja. Mi nemamo dovoljan broj Srba koji će konkurisati u policijskim stanicama u srpskim opštinama upravo iz tog razloga što nije primljen adekvatan broj konkurenata iz Srpske zajednice. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Atë që e thash më parë se te disa nuk ekziston vullneti që të shkojnë në Ranillug nga komunat tjera për shkaqet që i përmenda, është shumë e vërtetë, ndërsa konkursi që ka qenë, i ka kriteret goxha të ashpra dhe natyrisht që nuk mund të bëhen lëshime në ato kriteret vetëm për shkak të etnicitetit.

Mendoj se edhe ashtu më tepër se 10.5% janë në Policinë e Kosovës, që edhe e tejkalon përqindjen demografike dhe ne jemi në proces që të arrihen ato kuota dhe ku ka mundësi, si në Ranillug, të përmirësohet kjo përqindje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mikiq, pyetje për kryeministrin Thaçi. Zonja deputete!

VESNA MIKIĆ: Gospodine predsedavajući, ja ne vidim premijera prisutnog. Volela bih da bude prisutan i da mi odgovori na pitanje, kada budem postavila.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Regjia, zonjës Bytyçi, fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Duke u bazuar në disa informacione, kanë dalë rezultate të cilat tregojnë se gruri i cili importohet nga Serbia është me përmbajtje kancerogjene dhe paraqet rrezik serioz për përdorim nga qytetarët e Kosovës.

Duke i marrë parasysh këto fakte, pyes ministrin se a është në dijeni për këtë çështje dhe a ka marrë ndonjë veprim me qëllim të evitimit dhe ndalimit të importimit të këtij lloji të grurit, kur dihet fare mirë se shumica e grurit të importuar vjen nga Serbia dhe konsumimi i të cilit rrezikon seriozisht shëndetin e popullsisë së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja Bytyçi,

Ju falënderoj për pyetjen, megjithatë përgjigja në pyetjen tuaj nuk është në kuadër të kompetencës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka të bëjë më saktësisht përgjigjem në kapacitetin tim si zëvendëskryeministre për shkak se i takon Agjencionit të Veterinës të Ushqimit, kjo kompetencë.

Sipas legjislacionit në fuqi, më saktësisht Ligjit të ushqimit 03/L-016, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka rolin e autoritetit kompetent për sigurinë ushqimore në vend.

Sipas Ligjit në fuqi, atë që e përmenda, për kontrollet zyrtare të ndërmarra për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me Ligjin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve kreu V, neni 14, 15, 16 AVU ka marrë me kohë verifikimin e çdo ngarkese të grurit të importuar nga Serbia, që nga data 1.3.2013, të dyshuar për prezencë të metaleve të rënda jashtë normave të lejuara për konsum.

Parametrat e kërkuara janë: plumbi, kadmiumi, arseni dhe mercuri, kurse sasia deri m tani e testuar përfshin masën prej 1.928.940 kilogramë ose 74 vagonë me grurë, kryesisht me prejardhje nga Serbia.

Gjithnjë duke u bazuar sipas rregulloreve të lartpërmendura, testimet e grurit janë realizuar në laborator të akredituar me standardet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe fatmirësisht të gjitha rezultatet tregojnë se gruri i importuar nuk ka prezencë të lartë të këtyre metaleve të rënda, as afër nivelit i cili kishte për të shkaktuar ndonjë efekt negativ në shëndetin e njeriut, që dëshmon edhe referenca sipas rregulloreve të Bashkimit Evropian për nivelin maksimal të kontaminimeve në ushqim.

Gjithashtu janë bërë edhe teste të miellit që ka derivuar nga ky grurë, të destinuar për eksport në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu në metalet e rënda të lartpërmendura dhe rezultatet e këtyre testeve tregojnë se as mielli nuk përmban nivele të larta të metaleve të rënda mbi nivelin e lejuar maksimal, me ç'rast është mundësuar edhe eksporti i këtij gruri për në Shqipëri.

Gjithsej janë realizuar 87 analiza laboratorike, për sasinë prej 2 515 tonelatave të miellit tani, të cilat të gjetura kanë rezultuar negative.

Të gjitha dokumentacionet, rezultatet laboratorike dhe dëshmitë tjera të kontrolleve zyrtare gjenden në Arkivin e Agjencisë së Ushqimit të Veterinës në dispozicion për verifikim sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, deputete? Deputetja Bytyçi e ka fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Jo, desha t'i tregoj ministres se juve, në qoftë se ka, po ju u deklaruat që s'ka, por desha për të ju treguar që juve ju takon në qoftë se ka për ta parandaluar këtë importim, sepse ju jeni edhe ministre për këtë çështje.

KRYESUESE: Zonja ministre, në rregull, nuk e kërkon fjalën.

Prapë zonja Bytyçi, pyetje për ministrin Gashi. Ministri nuk qenka këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Fjalën zonjës Bytyçi.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Dihet fort mirë se disa ministra po janë shumë të pandërgjegjshëm, që nuk vijnë t'iu përgjigjen deputetëve. Mirëpo, me qenë se s'paska kohë, me siguri është duke pirë kafe ministri, atëherë unë do ta parashtroj pyetjen për hir të qytetarëve.

Siç e dini komuna e Suharekës dhe e Malishevës përballen me konteste të shumta të marrëdhënieve pronësore-juridike të pazgjidhura nga ish- sistemi i Jugosllavisë.

Qytetarët e dy komunave vazhdimisht janë të pakënaqur dhe disa herë kanë bërë protesta me qëllim të zgjidhjes së statusit të tyre, kur ata vazhdimisht kanë theksuar se pronat kanë qenë në pushtetin e tyre si titullar i pushtetit faktik dhe juridik, mirëpo, sistemet e atëhershme, në dobi të zgjerimit të kompleksit të pronave, u mori pa bazë dhe pa dokumente përkatëse.

Pyes ministrin se çfarë jeni duke ndërmarrë rreth zgjidhjeve të ankesave të qytetarëve lidhur me këto komplekse të pronave të cilat kanë kaluar në Agjencinë e Privatizimit të tokave dhe në cilat fazë ndodhen, me qëllim që të gjendet një zgjidhje adekuate për qytetarët e brengosur lidhur me tokat e marra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramadani, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër, gjatë muajit prill të vitit 2013, pra të këtij viti, është raportuar për një numër të madh të aksidenteve fatale në rrugët e Kosovës. Thjeshtë, humbja e jetëve në trafik tregon për një mungesë të sigurisë në trafik.

Pyetja ime është krejt e thjeshtë: Pse mungojnë masat e nevojshme për rritjen e sigurisë në trafik? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Ramadani,

Policia e Kosovës në vazhdimësi zbaton plane operative për të rritur masat e sigurisë në komunikacion. Në kuadër të masave që janë ndërmarrë dhe planifikon të ndërmerren përfshinë: masat e shtuara, kontroll gjatë sezonit të verës, lidhur me respektimin e shpejtësisë, kontrollin e shtuar sa i përket lëvizjes së makinave bujqësore, kontroll të shtuar sa i përket lëvizjes së këmbësorëve, biçiklistëve dhe motoçiklistëve.

Vlen të ceket se në interes të ofrimit të sigurisë së qytetarëve të vendit, Policia e Kosovës ka themeluar njësi të veçanta, siç është njësia për kontrollin e autostradës dhe njësia e komunikacionit për kryeqytet, njësi të cilat në vazhdimësi po sjellin rezultate pozitive në afrimin e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

Gjithashtu, me qëllim të përafrimit me standarde evropiane, Policia e Kosovës në bashkëpunim me institucionet e tjera ka hartuar raportin evropian të aksidentit i cili është në implementim nga muaji prill i këtij viti.

Në çerekun e parë janar - mars 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak janar - mars 2012, gjendja e sigurisë në fushën e aksidenteve me fatalitet kemi zbritje për 11,76% dhe zvogëlim të numrit të personave të vdekur për 5,56%, ndërsa aksidente me lëndime, kemi pasur rritje 26,73%, kurse aksidente me dëme materiale ka zbritje për 15,93%.

Vlen të ceket se numri i përgjithshëm i aksidenteve për periudhën kohore të lartcekur, ka zbritje për 7,40%. Mirëpo në muajin prill të këtij viti - 2013, në krahasim me muajin prill të vitit paraprak 2012, është vërejtur ngritje e numrit të përgjithshëm të aksidenteve për 23,56%. Si shkaktarë më të shpeshtë të aksidenteve në komunikacionin rrugor, ndër të tjera, janë evidentuar: mospërshtatja e shpejtësisë, kushteve dhe rrethanave të rrugës, tejkalimi i parregullt, goditja e këmbësorëve dhe kyçjet e parregullta. Andaj, aktiviteti i Policisë së Kosovës është i orientuar në parandalimin dhe luftimin e këtyre shkaktarëve të cilët kanë kontribuar në rritjen e numrit të aksidenteve.

Vlen të ceket se Policia e Kosovës për periudhën përkatëse të këtij viti ka shqiptuar 90 636 tiketa apo 20,62% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Policia e komunikacionit rrugor, në vazhdimësi, e veçanërisht gjatë kësaj periudhe, do të shtojë edhe më shumë prezencën në të gjitha rrugët e Kosovës, me të vetmin qëllim që të krijojë sa më shumë siguri për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

Gjithashtu, për të qenë niveli i sigurisë i garantuar, kërkojmë dhe bashkëpunimin e plotë të qytetarëve të Republikës së Kosovës duke i respektuar rregullat e komunikacionit, andaj shfrytëzoj rastin të apeloj tek të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ramadani? Po, urdhëro!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit zoti ministër, është tepër e qartë dhe ju falënderoj edhe për të dhënat që i dhatë. Do të thotë edhe pyetja ishte për muajin prill, sepse vërtet u raportua për një numër tepër më të madh. Ju e thatë edhe vetë se janë 23,56% rritje prej prilli 2013 me prillin 2012.

Sidoqoftë, mospërshtatja e shpejtësisë, që thatë, është një prej elementeve kryesore, ose arsyeve kryesore, por në të njëjtën kohë ne i shohim pak shenja në rrugët e Kosovës që paralajmërojnë radarët dhe në të njëjtën kohë i shohim policët e Kosovës të cilët fshihen, ose pas një objekti, ose pas një peme për të vendosur radarin. Dhe, po ashtu shumë prej policëve të Kosovës që punojnë në këtë fushë ose këtë sektor, ankohen për mungesën e madhe të radarëve funksionalë në rrugët e Kosovës.

Kjo do të jetë edhe një prej elementeve për të cilat ju, besoj, do të fokusoheni, pra edhe në aspektin e pajisjes, por edhe në aspektin e ndërrimit të kësaj strategjie të fshehjes së policëve, sepse kjo nuk besoj, që është më e mira.

Unë besoj se është më mirë qytetarët e Kosovës ta kenë të qartë se ku janë të vendosur radarët, në sa kilometra distancë ka radarë, sikurse që është në secilin vend në Evropë e po ashtu edhe përtej...

KRYESUESI: Zoti Rexhepi!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Mendoj, i nderuar deputetë, që për të pasur një analizë të saktë të arsyes pse është ardhur deri te kjo rritje, duhet pak më e thuktë. Ato ishin disa nga shkaqet. Po ashtu edhe punimet në infrastrukturë rrugore dhe mos sinjalizimi janë një prej shkaqeve.

Ndërsa, sa i përket çështjes së radarëve, janë dy qasje. Me këtë në një mënyrë mundohemi t'i vetëdijesojmë, në bazë të dënimeve që mos të vozisin shpejt, por dua të them se në gjykata përpara që kanë qenë për kundërvajtje lëndët qëndrojnë me vite dhe asnjëherë nuk implementohen. Prandaj, vozitësit e ndiejnë veten komotë që të vozisin shpejt se s'do ta marrin atë dënim.

Ndërsa sa i përket se a duhet të jenë transparentë radarët apo jo, më mirë do të ishte që ata të jenë statikë se nëpër shumë shtete tjera e bën fotografimin dhe i shkon drejtpërdrejt në gjyq, ndërsa qasja dhe numri i radarëve ka numër, por natyrisht se bëhen freskime për arsye se edhe kalibrimi dhe koha e tyre është e limituar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma, të lutem ulu në vend, ke kohë kur të lobosh dhe në seancë nuk lobohet me letra. Uluni në vendin tënd! Mos na shpërndaj letra nëpër Parlament këtu, sepse ke kohë mjaft dhe deri sot ke pasur kohë të lobosh për çfarëdo që ke pasur dëshirë. Mos na pengo në punë!

Zoti Ramadani, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, edhe një herë, zoti nënkryetar!

Edhe një herë e falënderojmë ministrin e Brendshëm për qasjen profesionale dhe konstruktive në temën tepër të rëndë që e kemi, e për të cilën duhet me vazhduar dhe ndryshuar.

Zoti ministër Mujota, pyetja është në të njëjtën temë.

Rrugët e Kosovës, sidomos ato rajonale kanë mungesë tepër të madhe të sinjalizimit dhe ndriçimit publik. Kjo është një prej elementeve që po ashtu e rrit mundësinë e aksidenteve në trafik.

Pyetja ime është: Sa për qind e rrugëve të Kosovës kanë sinjalizim dhe sa për qind e rrugëve të Kosovës kanë ndriçim publik? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mujota, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Ramadani,

Në kuadër të përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës hyn edhe mirëmbajtja dhe sinjalizimi i rrjetit rrugor në rrugën nacionale e rajonale të Republikës së Kosovës.

Ky rrjet rrugor, pa llogaritur rrugën e kombit, ka gjatësinë prej 1.925.1 kilometër, prej të cilave 630.4 kilometra janë rrugë nacionale, ndërsa 1.294.7 kilometra janë rrugë rajonale.

Bazuar në ndarjen buxhetore për Ministrinë e Infrastrukturës, është bërë planifikimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal, i ndarë në ... ose grupe ku përfshihen edhe pajisjet në rrugë.

Vlera e punëve të kontraktuara vjetore sillet rreth 800.000 euro për tërë rrjetin rrugor në Republikën e Kosovës që menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës, ku përfshihen: shigjetat, mbishkrimet dhe të gjitha shenjzimet tjera.

Gjatësia e segmenteve rrugore të ndriçuara në Republikën e Kosovës është 24 kilometra. Pra rruga nacionale ND, segmenti Prishtinë-QMI, në gjatësi prej 12 kilometrave dhe rruga nacionale... segmenti Prishtinë - Sllatinë po ashtu në gjatësi prej 12 kilometrave.

Punimi i sinjalizimit horizontal, si vijat, shigjetat, udhëkryqet e tjera, realizohen çdo vit në gjatësi prej 1 000 kilometrave, ndërsa shenjat e komunikacionit vendosen 1 000 deri 1 500 sosh në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Problemet me të cilat përballet Ministria e Infrastrukturës rreth sinjalizimit dhe pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, afërsisht janë këto. Në vazhdimësi kemi dëmtime dhe vjedhje të shumta nga persona të papërgjegjshëm.

Dëmtimi i shenjave dhe tabelave të vendbanimeve, si dhe dëmtimi i mbishkrimeve; dëmtimi i mbrojtësve anësore në rrugë në gjatësi prej 500 metrave; dëmtimi i numëruesve të trafikut, përkatësisht evidentimi i numrit të automjeteve që lëvizin në rrugët e Kosovës; dëmtimi i shtyllave ndriçuese nga automjetet si pasojë e aksidenteve automobilistike; dëmtimi i portaleve të semaforëve në disa raste dhe vjedhja e kabllave; kyçjet ilegale në ndriçim publik dhe dëmtimi i aseteve të Ministrisë së Infrastrukturës.

Si Ministri, brenda kompetencave këtë vit po ndërmarrim veprime shtesë bashkë me institucionet tjera përgjegjëse për të parandaluar dhe mënjeluar fenomenet e evidentuara që të mos shndërrohen në një dukuri.

Pra Ministria e Infrastrukturës po punon për përmirësimin e gjendjes në fushën e sinjalizimeve dhe mirëmbajtjes në të gjitha rrugët e vendit dhe kjo rritë nevojën për më shumë mjete buxhetore në mënyrë që të kemi cilësinë e dëshiruar dhe në përputhje me ndërtimet që po ndodhin në Kosovë dhe shtimin e numrit të kilometrave në rrugë.

Prandaj, ne po i marrim të gjitha masat që të kemi edhe këtë fushë për ta rregulluar ashtu si duhet dhe njëkohësisht dua të bëj apel te të gjithë qytetarët e vendit që të mos dëmtojnë shenjëzimet në rrugë, të mos dëmtojnë shenjat e komunikacionit sepse vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ramadani. Po! Vazhdoni!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, edhe një herë!

Normalisht se kjo temë nuk është temë e thjeshtë, ne po flasim për jetën e njerëzve, do të thotë për aksidentet në rrugë, lëndimet, por mbi të gjitha jetën e njerëzve, që sikur e pamë, është rritur numri në krahasim me vitin e kaluar. Ministria juaj, zoti Mujota, bashkë me Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë tepër fushë të përbashkët këtë punë. Ju e keni po ashtu brenda Ministrisë tuaj atë që quhet Këshilli Kombëtar për Siguri në Trafik, i cili sa për njohuritë e mia është jofunksional që një kohë.

Dhe në të njëjtën kohë, edhe një problem tepër i madh që mbetet tek ju, është çështja e kontrollimit të automjeteve – kontrollit teknik të automjeteve. E dimë, dhe po them, që ndoshta shumica e aksidenteve ndodhen prej automjeteve qofshin do Gollf 2-sha e kështu, të cilët realisht nuk e kalojnë kontrollin teknik në formën më të mirë dhe ka elemente të rëndësishme që duhet parë se si bëhet kontrolli teknik.

Pra, po ju...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari deputet Ramadani!

Vetëm sa isha duke bërë thirrje që të gjithë ata qytetarë të cilët në mënyrë a tjetër kanë treguar një lloj pandërgjegjësimi në raport me rregullat, në raport me shenjat, në raport me të gjitha shenjëzimet në komunikacion të jenë të kujdesshëm.

Ne kemi rastin edhe të vjedhjes së kablllove elektrike edhe në autostradë, që është një dëm shumë i madh.

Pra, me këtë rast unë dua të them që puna e madhe e policisë që bën mund të përbaltet me një veprim shumë të keq të pak individëve të pandërgjegjshëm dhe përgjithësisht ta shkaktojnë një dëm të madh në shoqëri. Dhe në këtë rast, po bëjmë apel.

Sa i takon çështjes së Këshillit kombëtar për siguri në rrugë, ai ka mbajtur takimet e veta të rregullta sipas ligjit. Vitin e kaluar 3 i ka pasur, tani është në përgatitje të mbajtjes së takimit të radhës dhe këtu do të evidentohen edhe shumë çështje tjera dhe bashkërisht me ministrinë tjera në fushat në të cilat bashkëpunojnë do të shohim masat që duhet ndërmarrë si Ministri dhe përgjithësisht si Qeveri për të zbutur këto pasoja, ndonëse ministri Rexhepi i përmendi fatbardhësisht numri i njerëzve që humbin jetën në komunikacion ka rënë, por numri i aksidentëve në muaj të caktuar rritet dhe ne jemi tani para sezonit veror kur shtohet numri i banorëve në Kosovë dhe rritet numri i trafikut për shkakun se kemi edhe numër të madh të njerëzve tanë që vijnë nga bota e jashtme dhe do të merren masa adekuate që të kemi pasoja sa më të vogla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit kryesues!

Zoti ministër, së fundi keni qenë në Bruksel në krye të delegacionit për çështjen e planit të zbatimit.

Ju kemi parë të raportoni në media për çfarë është folur dhe çfarë ka ndodhur aty, por deri më sot nuk jemi në dijeni se keni bërë kërkesë apo të keni rezervuar kohë që t'i raportoni Kuvendit apo ta informoni Kuvendin apo edhe Komisionin për punë të jashtme.

Po ashtu në një prej pikave të marrëveshjes, siç e quani ju historike, bën me dije se faktikisht do të ketë gjykatë të veçantë të apelit në Mitrovicë dhe kjo vetëm për serbët. Ligji dhe Kushtetuta e përcakton qartë që Kosova ka vetëm një Gjykatë të Apelit dhe atë me seli në Prishtinë.

Pra pyetja është se, pse nuk keni raportuar ende për dy takime të realizuara në Bruksel dhe në emër të shumë gjyqtarëve dhe juristëve ju pyes se ju në cilësinë e ministrit të Drejtësisë, me çfarë baze juridike keni lejuar dhe për më tepër vazhdoni të punoni në realizimin e kësaj shkeljeje juridike e kushtetuese, pra duke themeluar kështu gjykatën e veçantë të apelit në Mitrovicë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, e keni fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

E nderuara deputete Haxhiu, faleminderit për pyetjen.

Më lejoni që ta ndaj në tri pjesë pyetjen tuaj. E para ka të bëjë me raportin tim, duhet të them se kam qenë në cilësinë e ekspertit atje dhe e kam përfaqësuar vendin, por nuk kemi arritur ndonjë marrëveshje. Kemi pasur diskrepancë për ato që i kam thënë, por nuk kam pasur asnjë ftesë nga asnjë komision që t'i raportoj.

Përndryshe, deputete e nderuar, besoj që e dini, nuk ka ftesë të ndonjë komisioni që më është drejtuar dhe nuk i jam përgjigjur pozitivisht. Kurdo, që nga sot, jam i gatshëm të jap raport të tillë edhe në Komision, por edhe në Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket çështjes së dytë, dua t'ju njoftoj që po i thoni në emër të gjyqtarëve dhe prokurorëve, unë me vete në delegacion kam pasur kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që mendoj se ai i përfaqëson gjyqtarët, jo ju ose unë. Kam pasur kryeprokurorin e shtetit, që mendoj ai i përfaqëson ata, jo unë apo ju dhe, po ashtu duhet të them, ekziston një konstatim i juaj, që nuk është e vërtetë se do të ketë një Gjykatë të Apelit në Mitrovicë. Në pikën ku flitet për gjykata, nuk thuhet askund, bile përkundrazi thuhet Gjykata e Apelit në Prishtinë, që nënkupton që vetëm një Gjykatë të Apelit dhe këtu nuk ka asnjë...

Për hir të opinionit ta them këtë, jo vetëm për ju, që ju e dini edhe më mirë se sa unë, do të ketë një panel në kuadër të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që do t'i shqyrtojë rastet të cilat kanë të bëjnë me komunat me shumicë serbe. Natyrisht është menduar për raste sensitive.

Në Mitrovicë, në kuadër të Gjykatës Themelore theksohet shumë qartë, do të jetë një divizion, me staf administrativ që aty do t'i marrin njerëzit kërkesat, pastaj apelin, e panelin ju e dini që e cakton kryetari i Gjykatës së Apelit, që momentalisht është zoti Mekaj në Prishtinë dhe e dini që po ashtu thuhet do të përcaktohet paneli sipas natyrës së lëndëve, do të thotë, nëse lënda është e natyrës civile e penale, e kështu me radhë.

Unë po them që nuk ka dy gjykata dhe s'është e paraparë që të jenë dy gjykata, është vetëm një sistem unik në Kosovë, një sistem i drejtësisë, janë vetëm një palë ligje të aplikueshme dhe do të ketë hierarki të plotë të Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial mbi të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, për informatë për ata që nuk janë juristë, mbase ju jeni, në gjykatat themelore gjykimi do të jetë për të gjithë qytetarët i barabartë, pra asnjë qasje, as në Mitrovicë, as në Leposaviq, në Pejë, Deçan apo diku tjetër.

Pra, këtu nuk ka as ndryshim dhe unë e them me bindje të plotë kjo që nuk ka ndryshuar sistemi juridik në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, a dëshironi pyetje shtesë? Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Unë nuk e di se ku saktësohen këto që ju po i thoni, pra në cilin dokument, sepse ju po flisni kështu, mirëpo nuk dihet se ku saktësohen këto dhe unë po e përmendi çështjen që themelimi i Njësisë së Veçantë të Gjykatës së Apelit në veri e shkel parimin e një pushteti unik dhe gjyqësor, ngase është në kundërshtim me strukturën e gjithë gjyqësorit të organizuar mbi baza të një principi unik, pra principit të territorialitetit, dhe jo principit të përkatësisë etnike të qytetarëve të Kosovës, siç flitet aty për serbët.

Sipas Ligjit për gjykatat, po citoj: Gjykata e Apelit themelohet si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës, pra, kjo bie në kundërshtim me atë që ju po thoni.

Pra, kjo gjykatë, pra e Apelit në veri, nuk funksionon mbi bazën e kompetencës territoriale dhe kështu cenohet uniteti i sistemit gjyqësor dhe standardet e vëna me legjislacionin në fuqi. Për më tepër mohohet edhe parimi kushtetues i qasjes së barabartë në Gjykatë për të gjithë qytetarët dhe afirmohet parimi i qasjes në gjykatë të caktuar....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Kuçi, e keni fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: E nderuar deputete, atë që e thash unë, e parafrazova, ekziston në pikën 10 taksativisht në marrëveshje që e keni edhe ju draftin. Dhe para se ta bëni pyetjen, është mirë ta lexoni marrëveshjen.

Në anën tjetër, unë dhe ju si jurist duhet të lexoni pa letra, në kuptimin kur flasim për gjykata. Ju po e thoni njësi apo divizioni ne e kemi thënë, Divizioni nuk është Gjykatë. Nuk ka dy gjykata të apeleve dhe s'ka pranuar askush në këtë vend të jenë dy Gjykata të Apelit. Është një Gjykatë e Apelit me seli në Prishtinë dhe unë po them se ka kërkesa të qytetarëve të Sharrit ta kenë një vend ku i bëjnë ankesat, të mos vijnë prej Sharrit në Prishtinë, por do të ketë një juridiksion, një kryetar gjykate, një gjykatë, një palë gjyqtarë, me ligje të Kosovës, të emëruar nga Këshilli Gjyqësor, të dekretuar nga Presidentja e Republikës dhe nuk ka asgjë tjetër. Dhe, ajo çka dua të them, nuk ka dy gjykata. T'ua themi qytetarëve drejt: nuk ka dhe mos t'ua nxisim ambicien qytetarëve serbë atje se janë dy gjykata. Jo! Vetëm një. Ata e dinë, besoj se edhe ju e dini.

KRYESUESI: Edhe një pyetje tjetër zonja Haxhiu e ka për zëvendëskryeministrin, ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Më 12 maj 2013, zëvendëskryeministri i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mbajti takim në Mitrovicë me të ashtuquajturit përfaqësues të komunave në veri dhe me eksponentë të strukturave ilegale atje. Besim Hoti ka deklaruar publikisht se Policia e Kosovës i ka detyrat e rëndomta të ruajtjes të rendit publik. Pra, janë përgjegjësi të rregullta të tyre. Njësitet policore do ta përcjellin eskortën e tij, ndërsa sa i takon hyrjes së tij në Kosovë çdo gjë është në rregull me autorizimet e lejuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Herëve të tjera, Qeveria, në përgjithësi, e ka përdorur si alibi faktin se lejen atij ia jepte EULEX-i apo KFOR-i. Pyetja është se në bazë të cilit ligj keni lejuar që të hyjë në Kosovë një përfaqësues i Serbisë që nuk e njeh shtetin tonë dhe që organizon takime me persona, pjesa më e madhe e të cilëve janë struktura ilegale të MUP-it dhe BIA-s, që punojnë kundër Republikës. Faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë me dëshirë, zonja Haxhiu, do të vija një ditë në Komision Parlamentar dhe do të isha në gjendje t'i debatojmë këto procedura, që të mos marrim kohë. Por, dua ta them një: asnjëherë në këtë vend prej shpalljes së pavarësisë nuk ka dhënë leje EULEX-i apo KFOR-i. Ne jemi sovran i këtij vendi dhe çdo herë që kanë ardhur me leje, kanë ardhur me leje të Qeverisë të Republikës së Kosovës, respektivisht me lejen time si i autorizuar në emër të Qeverisë.

Në anën tjetër, ka pasur raste që kanë hyrë ilegalisht, por kësaj radhe zoti Vuçiq e ka bërë një kërkesë sipas procedurave të parapara dhe të pajtuara nga ne dhe BE-ja. Në zyrën e BE-së, zoti Zhbogar indirekt te unë, dhe unë jam përgjigjur pozitivisht dhe mendoj se kam bërë mirë. Qëllimi i kësaj vizite është arsytuar: do të vijë dhe t'i bindë qytetarët serbë për t'u pajtuar që ta implementojmë marrëveshjen. Dhe, unë besoj që është mirë kushdo që mund të kontribuojë. Procedurat, edhe në kufi, edhe lejen dhe të gjitha të tjerat kanë shkruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe po ju them se leja është lëshuar me Republika e Kosovës dhe zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe nuk ka asgjë të keqe. Policia e Kosovës e ka kryer punën ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

ALBULENA HAXHIU: Zoti ministër!

Ne e dimë shumë mirë qëllimin, se pse Aleksandër Vuçiq e ka vizituar Kosovën, mirëpo fatkeqësisht që këtë nuk po e dini ju. Por, nuk m'u përgjigjet në pyetje. Unë ju pyeta se në bazë të cilit ligj, pra ku e merrni ju legjitimitetin për të lejuar përfaqësues të Serbisë në Kosovë, të cilët përditë po e cenojnë rendin kushtetues të Kosovës. Domethënë vetëm këtë përgjigje e dua, asgjë më shumë.

KRYESUESI: Zoti Kuçi, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë besoj që hyrja e zyrtarëve të lartë të një pushtetit tjetër, në rastin konkret ju e dini që rregullohen me marrëdhënie diplomatike. Me shtetet që nuk e kanë njohur një çështje të tillë, ne kemi procedura të ndryshme. Në raport me Serbinë, kur vijnë zyrtarisht, kërkojmë procedurë që duhet të respektohet, se ndalen në kufi, dhe besoj se e dini që edhe presidentin e Serbisë, në rastin e kërkesës së tij nuk ia kemi dhënë pëlqimin dhe nuk ka ardhur. Ju e dini këtë, por ne duhet ta kemi po ashtu parasysh: Kosova nuk është një vend, se janë bukur disa shtete që nuk na kanë njohur, dhe nuk guxojmë që kush na njeh t'i themi 'mos eja në Kosovë'. Ata që vijnë në Kosovë, duhet të vijnë t'i respektojnë ligjet dhe vendin tonë. Kosova është

vend liberal dhe vend që lejon të hyjnë njerëzit, të qëndrojnë, të dalin, por logjika kryesore është të hyjnë dhe t'i respektojnë ligjet tona.

Mos u bëni merak në këtë drejtim, se ai ka ardhur kësaj radhe mirë, i ka respektuar ligjet tona, i ka respektuar procedurat. Atë duhet ta pyesin pse e ka pranuar lejen e Republikës së Kosovës, e jo ne pse ia kemi lejuar në vendin tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj,

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me planin Banjsko, zoti ministër, i cili është paraqitur në media dhe të cilin e kemi parë edhe nëpërmes sllajdeve të paraqitura dhe në të cilën është thënë që parashikohet rritje ekonomike prej 7 deri 8% për çdo vit, domethënë prej momentit kur fillon së zbatuarit ky plan. Është lënë të kuptohet kështu.

Pyetja ime është: Sa ka qenë rritja mesatare ekonomike këto dy vjetët e fundit në Kosovë dhe sa parashihet ose planifikohet që për vitet e ardhshme, ta zëmë për dy edhe tre vjetët e ardhshme.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Ymeri,

Mendoj që për hir të qartësisimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, është se unë në asnjë dokument dhe asnjëherë nuk kam bërë një prezantim të planit Banjsko. Nuk e di ku e keni marrë atë dokument. Qeveria e Republikës së Kosovës punon me dokumentet e saj strategjike dhe në kuadër të dokumenteve të veta strategjike është dokumenti mbi zhvillimin e ardhshëm ekonomik, dokument i cili është dokument publik në ueb-faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dokument i cili e ka një grup punues që merret me implementimin e këtij dokumenti dhe dokument që na ka siguruar rritje ekonomike më shumë se sa të gjitha vendet e rajonit.

Do të ishte jokorrekte t'u themi qytetarëve se ne nuk mund të ndikohemi nga vendet tjera dhe nga ekonomia botërore, por duhet të jemi gjithashtu korrektë dhe të gëzohemi se ne, si Republikë e Kosovës, i kemi rezultatet më të mira ekonomike në tërë rajonin, po flasim për rritjen ekonomike dhe edhe më gjerë. Njëkohësisht ky program, i cili është program ekonomik, po rrit besueshmërinë për çdo ditë e më shumë të institucioneve financiare ndërkombëtare. Ky është program i trajtimit me përgjegjësi të lartë të çështjeve ekonomike, është program i rritjes ekonomike, është program i adresimit në mënyrë shumë serioze të çështjeve të papunësisimit, stabilitetit makrofiskal, respektivisht program i një perspektive të qartë evropiane për qytetarët e Republikës së Kosovës. Për më shumë, duhet të ju përkujtoj që në bazë të këtij programi për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim e ka pranuar Kosovën si anëtar të plotë në BERZH, e ka bërë një strategji të BERZH-it për Republikën e Kosovës, e cila i sheh prioritetet dhe njeh prioritetet e këtij programi, për të cilat do të jetë e angazhuar

për t'i përkrahur financiarisht dhe në këtë drejtim është edhe Banka Evropiane për investimet, për të cilat shumë shpejt pritet të bëhet një marrëveshje kornizë me Republikën e Kosovës për këtë program, pra për programin e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Dua të ju them që mbi këtë program, gjithashtu është mbajtur Konferenca e Donatorëve para dy ditësh në Prishtinë, konferencë e cila edhe një herë e ka rikonfirmuar programin qeveritar ekonomik, respektivisht strategjinë energjetike të Republikës së Kosovës, duke premtuar 100 milionë nga Bashkimi Evropian donacion për sektorin e energjisë së ripërtërishme dhe për eficiencën e energjisë, respektivisht për dekomisionimin e “Kosova A”, të Qeverisë amerikane 15 milionë euro për ta përkrahur dhe forcuar sistemin rregullator...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pyetje shesë, zoti deputet?

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Ministër, nuk di a po e mohoni tash ekzistencën e planit që e kemi parë në media, apo keni problem me emërtimin që e quajta unë plani Banjsko, i cili natyrisht nuk është emërtim zyrtar, pajtohem me ju, por ashtu njihet në publik. Pra, sikur ajo që quhet Pakoja e Ahtisarit, nuk e ka emërtimin zyrtar ashtu, por të gjithë e njohin si ‘Pakoja e Ahtisarit’. Titullin e ka krejt ndryshe. Pra, nëse keni problem me titullin, tregoni. Por, ju tash e mohuat ekzistencën e planit, dhe çka është më me rëndësi, elementin kryesor të tij, premtimin për rritje prej 7 deri në 8% rritje ekonomike për çdo vit. Pra, nuk treguat a ka qenë, a e mohoni këtë? Edhe nëse paska qenë problemi që tash nuk e kemi rritjen e njëjtë për shkak të zhvillimeve ekonomike në botë, si është e mundur që nuk i keni ditur këto zhvillime ekonomike në vitin 2011, kur ato ndodhnin dhe po ndodhin vazhdimisht. Në këtë e dimë. Pyetja ime është pra: Sa ka qenë rritja ekonomike në vitin 2011, 2012, sa planifikoni të jetë në vitin 2013, 2014 dhe 2015, nëse keni këso planifikimesh, nëse e dini sa do të jetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Edhe një herë deputet Ymeri, unë të falënderoj për pyetjen, sepse ma dhatë mundësinë që edhe një herë t'i shpalosim sukseset e programit qeveritar, zyrtar të Republikës së Kosovës, i cili nuk njihet me emrin plani Banjsko. Ju mund ta njihni si të doni, por ky është dokument zyrtar i një qeverie të një republike që quhet Republika e Kosovës.

Lidhur me atë që të jepni orientime për këtë program është mirë që të lexohet programi. Është mirë që lexohet programi dhe programi ka paraparë 7 deri 8% rritje në kornizën afatmesme, pra për 3 vjet, jo në bazë të viteve ashtu siç po thonë ju. Ju e dini informacionin, sepse ky Kuvend e ka aprovuar buxhetin dhe raportet vjetore, të cilat për çdo vit përdoren këtu. I dini mirë shifrat të cilat janë të dhëna, pra në 5 vjetët e fundit e kemi pasur mbi 5% rritjen ekonomike mesatare.

Në dy vjetët e fundit ka qenë rreth 4% dhe projeksionet janë që në vitet e ardhshme do të jetë edhe më shumë, sepse këto programi, po them edhe një herë, kanë krijuar dëgjueshmëri të plotë te investitorët, të cilët po japin shenja që pavarësisht prej disa ftesave, të cilat po bëhen për ta braktisur Kosovën dhe për ta lënë Kosovën në terr ekonomik, ata po u besojnë institucioneve, po i besojnë ligjshmërisë së Kosovës, po u besojnë procedurave të Republikës së Kosovës dhe mbi këtë bazë presim të bëjnë investime, jo vetëm investitorët e huaj, por edhe investitorët tanë vendorë, të cilët janë shumë të respektuar dhe të cilët në mënyrë aktive po merren me problematikën e zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Fetoshi, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime është për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, që ka të bëjë me emërimin e ministrit të Financave. Dihet që nga 14 janari, Republika e Kosovës në Qeverinë e saj nuk ka ministër të Financave. Pyetja për kryeministrin është se pse ende nuk kemi ministër të Financave dhe kush është duke i marrë vendimet në këtë ministri, meqenëse ligji ia kufizon veprimtarinë e zëvendëskryeministrit në këtë drejtim. Pra, përderisa zëvendëskryeministri e ka të kufizuar veprimtarinë në këtë drejtim, ishte dashur që nga 14 janari, prej kur ne jemi pa ministër të Financave, ta kemi një ministër të Financave për shkak se Ministria e Financave, konkretisht ministri i Financave është person përgjegjës për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë në lidhje me financat publike dhe është një përgjegjësi shumë e madhe e kësaj Qeverie që ende në këtë kohë nuk e kemi një ministër të tillë. Gjithashtu është dashur që kryeministri të jetë i pranishëm këtu dhe të përgjigjet në pyetjet e deputetëve, sepse në deklaratimet jashtë rendit të ditës ishte këtu. Është dashur të presë edhe pak dhe të përgjigjet në pyetjet e deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kasolli, pyetje për ministrin Buja. Ministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Pyetjen do ta lë për javën tjetër.

KRYESUESI: Zonja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Që në fillim të vitit 2011, kur zonja Tahiri i filloi rundet e takimeve me Borislav Stefanoviçin në Bruksel, nën lehtësimin e Rober Kuper, u deklarua publikisht dhe u mor zotim nga Qeveria dhe kryeministri se këto bisedime teknike do të sjellin rezultate për çështjen e të pagjeturve dhe të rrëmbyerve, të vrarë prej shtetit serb. Po ashtu, edhe kryeministri Thaçi deklaroi para takimit të parë me Daçiqin dhe gjatë takimeve tjera se do të flitej dhe do ta kishin prioritet këtë çështje. Deri më tani, as familjarët e as ne këtu në Kuvend, as opinionin publik nuk ka parë asnjë rezultat. Pyetja për zëvendëskryeministren do të ishte: Çfarë informatash të reja keni mbi çështjen e Ukshin Hotit? Por, meqenëse zëvendëskryeministria nuk është këtu, unë pres përgjigje javën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për ministrin Mujota.

REXHEP SELIMI: Zoti nënkryetar!

Në ndërtimin e magjistrales Prishtinë-Pejë është planifikuar të bëhet devijimi i trasesë, përkatësisht në segmentin nga fshati Mleqan deri në dalje të fshatit Kijevë, në pjesën rreth fshatit Cerovik. Ky devijim shmang trasenë e rrugës ekzistuese. Banorët dhe afaristët e kësaj zone kanë shqetësim se me devijimin e kësaj traseje izolohet zona e tyre dhe aktivitetet afariste me të cilat ata mbajnë rreth 10 mijë familje të banorëve të këtyre zonave. Po ashtu, ata e kanë shqyrtuar me vëmendje këtë çështje dhe konstatojnë se jo vetëm interesi i komunitetit të tyre preket, por edhe kostoja e shpenzimeve për këtë magjistrale, pas devijimit të trasesë, pra rritet disa herë. Pyetja është: Zoti ministër, ata i janë drejtuar Qeverisë, më 29 prill 2013, me një kërkesë të nënshkruar prej tyre, me të cilën e sqarojnë këtë çështje. Çfarë keni bërë deri më tash në lidhje me kërkesën e tyre legjitime? Pse jeni duke e devijuar trasenë e rrugës dhe njëkohësisht sa i kushton ky devijim buxhetit të shtetit për shkak se devijimi do të implikojë edhe shpronësimet tjera të pronave private?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari deputet Selimi!

Në kuadër të planit të punës dhe projekteve të përcaktuara nga Ministria e Infrastrukturës për vitin 2013 dhe sipas ligjit të buxhetit, të aprovuar për këtë ministri nga Kuvendi i Kosovës, bën pjesë edhe zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugës nacionale N/IX, përkatësisht rruga Prishtinë-Pejë, nga Gjergjica në drejtim të Klinës.

Nevoja për ndërtimin e kësaj rruge me standarde dhe me cilësi të lartë është e padiskutueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, e veçmas për rajonin e Pejës. Është konstatuar nga ekspertët se ndërtimi i kësaj rruge, me gjithë investimet jo të pakta, e arsyeton ndërtimin dhe qasjen e saj deri në qytetin e Pejës dhe më tej në vitet që vijnë, aq më parë kur ndërtimi i saj është kryer deri në kycjen e autostradës.

Objekti për hartimin zgjerimit të rrugës N/IX, segmenti Gjurgjicë-Kijevë, është hartuar nga kompania "Proiin" nga Prishtina, ndërkaq projekti kryesor është finalizuar në prill të vitit 2010. Gjatë hartimit të projektit ideor nga ekspertë të fushës janë analizuar disa variante në të cilat janë shqyrtuar mundësitë e zgjerimit të rrugës ekzistuese dhe alternativat tjera për një rrugë të re. Me propozimin e kompanisë projektuese dhe aprovimin e grupit teknik nga ish-Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, tani Ministria e Infrastrukturës, është miratuar varianti i devijimit të rrugës në segmentin në gjatësi prej 2 750 metra, në lotin 3.

Ndër arsytet për devijim kanë qenë: pamundësia e zgjidhjes teknike të kalimit të rrugës së re nëpër Kijevë për arsye se aty ndodhen objektet e ndërtuara shumë afër rrugës ekzistuese. Rruga ekzistuese e ka gjerësinë vetëm 7 metra të asfaltuar, ndërsa në të dyja anët e saj ka vetëm nga 1,5 metra bankina, që do të thotë gjithsej 10 metra, ndërsa rruga e re e ka gjerësinë prej 26,20 metra. Varrezat janë shumë afër rrugës ekzistuese në dalje të Kievës, nga ana e djathtë në drejtimin Prishtinë-Pejë. Edhe kjo është një çështje mjaft e

ndjeshme në këtë drejtim. Pamundësia e ndërtimit të udhëkryqit në Kijevë për shkak të hapësirës së pamjaftueshme për profilin e rrugës së zgjeruar është edhe një nga arsyet. Zgjidhja e re mundëson qarkullim të sigurt dhe pa pengesa në këtë aks rrugor dhe e anashkalon, siç thuhet, fytin e ngushtë të trafikut në Kijevë. Rruga e re ofron zgjidhje të mira për të gjitha udhëkryqet e saj, përfshirë edhe kyçjen e rrugës së vjetër dhe rrugëve anësore për Cerovik dhe për Malishevë.

Prandaj, nëse flasim edhe për çështjet e shpronësimit, i nderuari deputet Selimi, për ju dhe për publikun, duhet të bëj të ditur se Ministria e Infrastrukturës bënë vetëm elaboratin e shpronësimit. Ministria e Financave, nëpërmjet njësisë së vet të kontraktuar, bën vlerësimin, ndërsa Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor bënë pagesat për pronat e shpronësuar. Nuk mund të flasim tani për çmimin e shpronësimeve, por një gjë është e sigurt, se shpronësimi në pjesën ku ka ndërtime të mëdha është shumëfish më i shtrenjtë sesa në pjesët ku nuk ka ndërtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

REXHEP SELIMI: Po, kam pyetje shtesë.

Banorët, në veçanti afaristët, pikërisht të atyre objekteve që u referoheni si janë objekte që bri rrugës, kërkojnë që të mos devijohet traseja me arsye kryesisht ekonomike. Pra, pikërisht ato objekte që janë afër rrugës në trasenë ekzistuese, ata biznesmenë kërkojnë që të mos devijohet për shkak se nuk u rrezikohet atyre biznesi duke kaluar rruga në trasenë ekzistuese, por përkundrazi u rrezikohet duke i anashkaluar këto biznese. Ata u janë drejtuar, siç thashë më herët, me një kërkesë. Pyetja ime shtesë është kjo: A do ta respektoni kërkesën e të gjithë atyre afaristëve, të cilët përfaqësojnë rreth 10 000 banorë të kësaj zone, apo nuk do ta respektoni kërkesën e tyre dhe do të vazhdoni me projektin e kompanisë projektuese, siç thoni ju. Pra, a do të respektohet vullneti i tyre për shkak se edhe në pikën e mëhershme të rendit të ditës u thirrën shumë në vullnetin e komunitetit. Kësaj radhe, nga Qeveria ekzistuese a do të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Unë them se për qytetarët e Republikës së Kosovës rrugët ndërtohen me qëllim që të kemi siguri më të lartë dhe rruga ndërtohet që të kemi cilësi më të lartë. Unë besoj se duhet t'i përmbahemi projektit, sepse i ka dhënë të gjitha elementet e nevojshme për sigurinë, për cilësinë dhe për aspektet e tjera. Në qoftë se do t'i bënim shpronësimet në këtë drejtim të rrugës, për çka ju flisni, është teknikisht e pazbatueshme dhe unë si ministër duhet ta respektoj projektin që është teknikisht i zbatueshëm, që ofron siguri më tepër dhe që shpronësimet janë më të lehta dhe sigurisht edhe më të lira se sa në segmentin për të cilin ju flitni.

Edhe një gjë duhet ta them për publikun. Në të gjitha segmentet rrugore ku punon Ministria e Infrastrukturës, e që në fund të ditës pengohet Ministria e Infrastrukturës në zbatimin projekteve, të mos ketë asnjë lloj ndikimi në kuptimi negativ, sepse ku ka

mundësi të iket nga shpronësimet e shtrenjta, nga ndërtimet e mëdha që kanë ndodhur dhe të dëmtohet afarizmi më shumë nëse shkatërrohen sesa nëse lejohen rrugët aty, të ju ndihmojmë të gjithë, sepse kështu mund të arrijmë standard të lartë të rrugëve dhe të siguri të lartë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Nuk kemi pyetje tjera.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 21 prill dhe 2 maj 2013

A ka kush vërejtje lidhur me procesverbalet? Nuk ka.

Prania në sallë është 68 deputetë. Konstatoj që miratohen procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 21 prill dhe 2 maj 2013.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë

Për rendin e ditës e kemi një mocion nga Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re. E ka bërë një mocion, e ka protokolluar dhe e ka dorëzuar në Kryesi. Fjalën e ka zonja Myzejene Selmani. Procedurat i kanë plotësuar, mund ta sqarojë dhe pastaj vendosim.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritet për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh situatën e fundit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e ngreh një debat parlamentar, mirëpo zhvillimet e sotme tregojnë që kryetari i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka dhënë dorëheqje. Shpresojmë dhe besojmë shumë që edhe anëtarët e tjerë të atij bordi të japin dorëheqje, se një AKP, një Agjenci Kosovare të Privatizimit, nga i cili Shtetet e Bashkuara të Amerikës e heqin përfaqësuesin e vet nga kjo agjenci që e kanë formuar vetë, shpresoj se ndërgjegjja e pastër dhe vetëdija e tyre nuk do të...

KRYETARI: Zonja kryetare e Grupit, nuk ta kam dhënë fjalën për debat. Për mocionin, a qëndron pranë tij apo jo?

MYZEJENE SELMANI ...Jo! Nuk dua debat parlamentar, sepse kanë dhënë dorëheqje dhe mos më ndërhyj kur flas!

KRYESUESI: Konstatoj që mocioni i dorëzuar nga Koalicioni Kosova e Re, tërhiqet për shkak që propozuesi tërhiqet dhe nuk e futim më tutje në votim. Nuk e di kush ka dhënë dorëheqje, e kush nuk ka dhënë. Zonja Lama e keni fjalën.

ALMA LAMA: Zoti kryesues, desha të jua tërheq vërejtjen për mënyrën se si po e drejtoni seancën, duke ma tërhequr vërejtjen të ulem apo mos të ulem në vendin tim apo të bëj lobim. Më vjen shumë keq, por ne nuk jemi këtu...

KRYESUESI: Ndërpritja fjalën! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Unë kërkoj që Ligji për tregun e naftës dhe produktet e naftës në Kosovë të tërhiqet, pasi është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, me nenin 10, ku cenohet konkurrenca e lirë. Këtë e kam kërkuar edhe herën e kaluar, por tash përsëri kërkoj që ky ligj t'i kthehet. Gjithashtu mendoj se nuk është në rregull që t'u ndërpritet fjala deputetëve e zgjedhur të popullit...

KRYESUESI: Nëse do, edhe ty ta ndërpres! A do ta thuash mocionin, të lutem! E keni mocionin në emër të Grupit, apo në emrin tënd?

TEUTA SAHATQIJA: Normalisht që në emër të Grupit.

KRYESUESI: Thuaje mocionin në emër të Grupit, e jo në emrin tënd!

TEUTA SAHATQIJA: Mocionin e thashë në emrin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Kërkoj që Ligji për tregun e naftës dhe produktet e naftës në Kosovë, që është pika e katërt e rendit të ditës, t'i kthehet Qeverisë, sepse nuk i plotëson kushtet, është në kundërshtim me Kushtetutën, neni 10 të saj, me nenin për ekonominë e lirë dhe konkurrencën e lirë. Kaq, në emër të Grupit.

KRYESUESI: Tash unë dua të jua lexojë Rregulloren, meqenëse ju e dini, por sidoqoftë amendamenti lidhur me rendin e ditës, neni 44, përcaktimi i rendit të ditës. Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit. Rendi i ditës u dërgohet deputetëve.

Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveç kur në fillim të mbledhjes, ose së paku më shumë grupe parlamentare, përfaqësues të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë, ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngre çështje të ngutshme dhe kjo e merr miratimin e shumicës.

Ju nuk e keni dorëzuar me shkrim. Ne e kemi praktikuar këtë që ta hedhim në votim dhe unë nuk kam asgjë kundër asaj që të hidhet në votim propozimi. Varet se si votojmë. Radha është e grupeve parlamentare që të deklarohen. Zoti Muja, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Rendi i ditës, i parashtruar dhe i miratuar me këtë radhitje, për Grupin Parlamentar të partisë Demokratike nuk paraqet asnjë problem, por paraqet një befasi për qasjen që i bën edhe Lidhja Demokratike dhe zonja deputete, e cila është anëtare e komisionit, në të cilin është miratuar që të kalohet në lexim të parë ky ligj në Parlament, kurse në mënyrën tjetër thuhet se është antikushtetues. Gjatë leximit të dytë, në atë interval kohor, të gjitha ato mangësi të cilat i ka lënë Ministria e tregtisë dhe Industrisë, ekzistojnë mundësitë të përmirësohen. Prandaj, është e pakuptimtë që të largohet ligji, ose po duam të bëjmë ligj,

ose nuk duam të bëjmë ligj. Këtu është problemi se, nëse duan të mos të ketë një ligj gjatë një mandati, gjatë një kohe, një periudhe dhe me debat të brendshëm, edhe me amendamente, t'i mund t'i ndërpresësh, prandaj është e pakuptimtë, se as politikisht, as logjikisht nuk mund ta sjellin një diçka që sjell vlerë. Prandaj, mendojmë që ky ligj duhet të procedohet edhe të amendamentohet gjatë leximit deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERY: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe ne jemi plotësisht të bindur që ky ligj, veçanërisht në një nen të tij është shkelje e parimit kushtetues të lirisë në treg dhe në këtë drejtim, konsiderojmë që Kuvendi natyrisht nuk do të duhej ta kishte të drejtën që të votojë ligje të cilat janë në shpërputhje me Kushtetutën për shkak se në këso raste, vetë ideja e ekzistencës së një kushtetute, si një dokument ligjor më i larti në vend, përçudnohet. Po që se Kuvendi ka të drejtë ta shkelë Kushtetutën me ligjet që i miraton me shumicë të thjeshtë, një Kushtetutë e cila miratohet me 2/3 në Kuvend, atëherë vërtet çfarë kuptimi ka të ekzistojë ajo kushtetutë si e tillë, dhe në këtë drejtim konsiderojmë që me gjithë mundësinë që votat të jenë për ligjin, me gjithë faktin që ky ligj ka kaluar në Komisionin Funkcional me shumicë votash, prapëseprapë nuk do të duhej ta kishim këtë të drejtë që ta shkelim Kushtetutën me ligje, dhe rrjedhimisht ky ligj duhet t'i kthehet Ministrisë, në mënyrë që ajo të kujdeset që të jetë në përputhje me Kushtetutën kur sjell ligje të tilla në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës definitivisht mendon se ky projektligj nuk duhet të futet fare në rend dite sot dhe në të njëjtën kohë besoj se Kuvendi i Kosovës duhet që në një formë ta edukojë Qeverinë e Kosovës që të mos sjellë ligje ose projektligje, të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe krijimi i monopoleve është qartë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, i ftoj edhe deputetët e tjerë që të votojnë që ta heqim nga rendi i ditës këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar Kosova e Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk ke të drejtë të ma ndalësh fjalën kur flas, aq më tepër që jam shefe e Grupit Parlamentar!

Koalicioni për Kosovë të Re kërkon që Projektligji për naftën të shkojë sot në lexim të parë për arsye se brenda Komisionit Parlamentar dhe nga vetë kërkuesit e mocionit, me përjashtim të zonjës në fjalë, të tjerët e kanë votuar ligjin. Zoti Lutfi Zharku ka qenë abstenues në këtë ligj dhe nuk e di tash kur në Komision Parlamentar i jepet e drejta që të kalojë në seancë plenare dhe brenda seancës plenare kërkohet që ligji prapë t'i Ministrisë, është diçka absurde. Në rast se është vendi ku mund të ndryshohet një projektligj, ai është Kuvendi i Kosovës, e jo diku tjetër. Koalicioni e përkrah ligjin që të shkojë në lexim të parë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe Infrastrukturë, zoti Pajaziti

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit, Kabinet qeveritar,

Mendoj që kjo pikë e rendit të ditës duhet të mbetet kështu. Dëshiroj të ju njoftoj që për çështjet që u trajtuan si problematike këtu, edhe vetë Qeveria i ka pasur parasysh në ndërkohë që e kemi pasur këtë projektligj në Kuvend, e kemi pasur një reagim të shoqatave të ndryshme që merren me naftën, me tregtimin e naftës. Kemi një reagim të menjëhershëm të ministres. E ka bërë një propozim në adresën time, të cilin do t'ia deponoj Grupit Punues, e që ka të bëjë pikërisht me amendamentin që e trajton krejtësisht ndryshe këtë çështje.

Është shumë me rëndësi që kjo pikë e rendit të mbetet dhe në grupet punuese, pastaj partitë politike, grupet parlamentare të komisionit t'i trajtojnë idetë e veta, në mënyrë që sa më shpejt ta kemi këtë ligj të kompletuar. Pra, e kemi një propozim të ri të Qeverisë, të ministres, i cili përputhet plotësisht me kërkesat që dolën këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Zonja deputete e tha në emrin e Grupit tanë Parlamentar, por ajo që po më bën përshtypje tash është çfarë thotë parafolësi. Pikërisht do të bëhet ky plotësim, le të kthehet ligji e të bëhet vlerësimi, sepse kjo si po e thotë sot, për mendimin tim, është shumë e paqëndrueshme. Prandaj, ne mbetemi pranë qëndrimit që e thamë, që ligji të kthehet, të plotësohet dhe të hiqet kjo që në start. Është absurde të miratohet diçka antikushtetuese, e të bëhet kushtetuese më vonë në lexim të dytë. Duhet të sillemi në mënyrë serioze, sepse tash po pranohet që kjo është antikushtetuese dhe është antikushtetuese, dhe është e drejtë jona si grup parlamentar - të mos të na mësojnë të tjerët çfarë është votuar në Komision.

Grupi ynë Parlamentar e ka thënë qartë, na nuk po u prejudikojmë të tjerëve çka të thonë. Është punë e tyre. Qëndrimi ynë, kërkesa jonë, e drejta jonë elementare është ta bëjmë një mocion të tillë dhe le të vendosë Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Unë jam plotësisht dakord me këtë, por ligji ka ardhur në seancë. Ne do ta diskutojmë dhe, në fund, mund të mos e miratojmë dhe të votojmë që të kthehet mbrapshtë. Rrugë tjetër nuk ka. I vetmi autoritet për ta tërhequr ligjin është Qeveria.
(Reagime)

KRYESUESI: Po mirë, ne kemi të drejtë të debatojmë, kemi të drejtë ta themi fjalën tonë lidhur me ligjin. Ministrja ka të drejtë ta prezantojë ligjin, e në qoftë se na e mbush mendjen, e votojmë, në qoftë se jo votojmë kundër miratimit të ligjit në parim dhe kthehet mbrapa në Qeveri, në mënyrë automatike. Unë dua proceduralisht bashkë me ju të procedojmë drejt.

(Reagim nga salla: Ju e keni një mocion, e thatë më herët...!)

KRYESUESI: Po, me Rregullore është i paraparë ky lloj mocioni. Nuk është paraparë që të kthehet ligji. Me Rregullore, ligjin vetëm Qeveria e tërheq në fillim të seancës, ose me diskutim ne nuk e miratojmë, ose e miratojmë në fund, në parim.

(Reagime)

KRYESUESI: Po, zoti Beqiri, nuk ka problem për ta diskutuar.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Ne e kemi bërë një mocion për rend të ditës. Nuk është hera e parë që kjo praktikë ka ndodhur pa shkrim, siç e thoni ju, për grupe të ndryshme parlamentare. Kka ndodhur edhe për kërkesë të LDK-së, edhe PDK-së, edhe të tjerëve. Mos e ndërroni këtë praktikë! Nëse nuk e hidhni në votim, është e drejtë e jona, nëse nuk kalon mocioni ynë normalisht që ne do të votojmë kundër në fund, por mos na detyroni ta lëshojmë sallën. Ne nuk marrim pjesë në debat nëse nuk mocioni hidhet në votim për rend të ditës. Nëse nuk e hidhni në votim, ne e lëshojmë sallën. Ju votoni pa ne dhe kryejeni pa ne, pa Grupin Parlamentar të LDK-së. Është e drejtë e jona - kërkojmë të hidhet në votim. Le të mos kalojë. Nuk po paragjykoj. Është vendim i Kuvendit, por është një e drejtë jona që është praktikuar edhe herëve të tjera. Prandaj, mos bëni përjashtim. Edhe vetë e thatë, zoti nënkryetar, më herët që do ta nxirrni në votim, por i more mendimet e grupeve parlamentare. Ky është qëndrimi ynë.

KRYESUESI: Nuk e kam problemin aty fare. Problemin e kam vetëm ta zbatoj Rregulloren. Asgjë tjetër nuk më pengon. Alma, të lutem, mos, se jemi miq! Unë e di çfarë thashë. Nuk ka nevojë për zhurmë për asgjë. Zonja Sahatqija e ka kërkuar edhe një herë fjalën. Jua jap fjalën me qëllim që të sqarohemi, por ju lus që ta keni parasysht - e drejta jonë është me votë, e pastaj në fund ta kthejmë. Ne mund ta hedhim në votim, por në qoftë se është e kundërta, njësoj.

TEUTA SAHATQIJA: Sa i përket këtij ligji, edhe informatën që e dëgjuam nga kryetari i Komisionit, mendoj se ka qenë e drejtë që pas kthimit të këtij ligji, më 25 prill, ta kemi një informatë. Jo pas kthimit, por pas shtyrjes për seancë tjetër, ta kemi një informatë prej ministrisë me kohë ne anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, e jo që ligji të vijë dhe aty për aty të sillet një informatë për të cilën ne me shkrim nuk kemi kurrëgjë. Do të ishte shumë e drejtë po ta kishim pasur atë informatë dhe që vendimi për këtë ligj të jetë i bazuar në atë informatë. Në anën tjetër, mendoj që zoti Muja, i cili ma përmendi emrin, e i cili është deputet për herë të parë dhe i cili po mësohet me procedurat parlamentare, duhet ta dijë që Kuvendi dhe seanca plenare është shumë më e fuqishme se sa cilido komision funksional. Prandaj, nuk ka nevojë ta mësojë askënd se si duhet votuar, çfarë duhet të bëjë. Është seanca plenare ajo që vendos. Unë atë ditë nuk kam qenë, por edhe të kisha votuar për, seanca plenare edhe Grupi Parlamentar e ka fuqinë më të madhe sesa një individ, apo se një komision parlamentar.

Dhe e fundit, mund të ju tregoj se në tri traste ua ndalët fjalën grave. Ku e keni problemin? A po ju pengon që deputetet flasin, apo ku e keni problemin?

KRYESUESI: Ne ju kemi dhënë përparësi. Nuk je ti kujdestare këtu për mbrojtjen e grave. Jo, nuk je kujdestare! Ne i kemi grupet parlamentare dhe i kemi qëndrimet tona.

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Unë dua ta bëj një sqarim. Mocioni i grupeve parlamentare mund të bëhet për shtyrjen e një pike të rendit të ditës, por nuk mund të bëhet për kthimin e ligjit. Ne mund të bisedojmë sa të doni, por mocioni mund të vlejë vetëm për ta shtyrë, e jo për ta tërhequr ligjin. Ligji tërhiqet me votim, pasi të bëhet diskutimi, dhe mendoj që duhet të jemi të qartë. A është ministrja ta arsyetojë ligjin?

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,
E nderuara Kryesi e Kuvendit,
Ministra,
Deputetë,

(Reagime nga salla)

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti, shkurtimisht ta paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për tregun e naftës dhe produkteve të naftës në Kosovë.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Deputet, nuk ke të drejtë me mocion për t'ia kthyer ligjin Qeverisë. Rendi i ditës është i miratuar në Kryesinë e Kuvendit. Lexojeni Rregulloren dhe e shihni siç është. Ministre, e ke fjalën, vazhdo.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Arsyeshmëria për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore që do të mundësojë transfuzimin dhe implementimin e direktivës evropiane për sigurimin e furnizimit me karburante të naftës, direktivës për promovimin e përdorimit të biokarboranteve në transport, për lehtësimin e procedurave të licencimit, mbrojtjen e ambientit dhe konsumatorit, sigurimin e cilësisë dhe një treg të barabartë, si dhe qartësimin e çështjeve të rregullimit në sektorin e naftës.

Ndryshimet e propozuara në Projektligjin për tregun e naftës dhe produkteve të naftës janë:

1. Në projektligj është krijuar baza ligjore për rregullimin e çështjes së rezervave të obligueshme të produkteve të naftës në pajtim me direktivën 2009/119 për të vendosur detyrimin mbi shtetet anëtare për t'i ruajtur rezervat minimale të naftës bruto, ose produktet e naftës.

Direktiva 2009/119, ndër të tjera, kërkon që shteti të ketë rezerva të naftës për së paku 90 ditë të neto të importit mesatar ditor të vitit paraprak.

Në takimin e dhjetë të Këshillit të Ministrave të shteteve kontraktuese të komunitetit të energjisë, edhe Kosova ka pranuar ta përmbushë këtë obligim në tërësi deri më 1 janar të vitit 2023.

Me konsumin aktual, Kosovës i duhen rreth 150 mijë tonë rezerva të produkteve të naftës. Por, importi i produkteve të naftës parashihet të rritet deri në vitin 2023, e me këtë edhe sasia e rezervave.

Kosova ka kapacitete deponuese rreth 100 mijë metër kub. Për deponimin e rezervave të nevojshme Kosovës i duhen deri në 2 ose 3 herë ta dyfishojë këtë kapacitet deponues.

Në projektligjin e ri është paraparë të themelohet divizioni i rezervave të obligueshme të produkteve të naftës në Departamentin e Rezervave Shtetërore të Mallrave, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili do të jetë autoriteti për krijimin dhe menaxhimin e rezervave të obligueshme të produkteve të naftës.

Financimi i rezervave të obligueshme, ashtu si në shumicën e shteteve tjera, parashihet të bëhet nëpërmjet një tarife të veçantë, madhësia e së cilës do të përcaktohet me udhëzim administrativ dhe të cilin do ta paguajnë të gjithë importuesit e naftës dhe produkteve të naftës me rastin e importit.

Deponitë ku do të ruhen rezervat do të jenë të ndërtuara dhe të financuara nga operatorët ekonomikë, pas kontratave me divizionin.

Divizioni do t'u paguajë qira operatorëve ekonomikë, të cilët kryejnë shërbime të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rezervave.

2. Në projektligjin e ri është krijuar baza ligjore për përdorimin e biokarburanteve në transport, në pajtim me direktivën 2009/28 për promovimin e përdorimit të energjisë prej burimeve të ripërtërishme.

Sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe karburanteve të tjera të rinovueshme në treg do të përcaktohet me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministria.

Në takimin e dhjetë të Këshillit të Ministrave të shteteve kontraktuese të komunitetit të energjisë, edhe Kosova ka pranuar që më së voni nga 1 janari i vitit 2014 të fillojë me transfuzimin e direktivës 2009/28 për promovimin e përdorimit të energjisë prej burimeve të ripërtërishme dhe deri në vitin 2020 të arrihet implementimi i plotë, pra 10% të karburanteve në transport të jenë nga burimet e ripërtërishme të energjisë, biokarburantet.

Në projektligj është bërë thjeshtësimi i procedurës së licencimit nëpërmjet zvogëlimit të numrit të licencave nga 20 dhe grupimi i tyre në 4 licenca, në përputhje me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për heqjen e barrierave dhe procedurave burokratike, me qëllim të lehtësimit të ambientit afarist në Kosovë.

Afati i licencës është zgjatur nga 2, në 5 vjet. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për licencë do të rregullohet në tërësi me akt nënligjor nëpërmjet të cilit do të eliminohen kërkesat e panevojshme që do t'i vështirësojnë bizneset, por njëkohësisht do të parashtrojnë kërkesa, të cilat janë të nevojshme për sigurimin e kushteve teknike, mbrojtjes së ambientit, shëndetit dhe konsumatorit.

Për të ndihmuar në sigurimin e cilësisë së karburanteve dhe një tregu të barabartë, në projektligj janë paraparë masa si në vijim:

- Kushtëzimi i veprimtarisë së importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve me licencë për deponim,
- Mundësia e kushtëzimit me ngarkim, shkarkim të karburanteve një nga deponia para dërgimit të tyre tek subjektet e tjera,
- Obligimi që të gjitha autobotet që e kryejnë transportin e karburanteve të naftës ta kenë të vendosur mbishkrimin e qartë të kompanisë së tyre,
- Rritja e numrit të dispozitave ndëshkuese, qartësimi i tyre dhe zvogëlimi i gjobave.

Në tregun e Kosovës ka mjaft konkurrencë sa i përket importit dhe shitjes me shumicë të produkteve të naftës. Momentalisht i kemi të licencuara 16 deponi, prej të cilave 12 merren me shitje me shumicë, si dhe 4 të tjera që merren me industri.

Megjithatë, pas takimit me përfaqësuesit e shoqatave të ndërmarrjeve që merren me qarkullimin e produkteve të naftës, ata kanë kërkuar heqjen e kushtëzimit të importit me deponi të licencuar.

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë u ka afruar që ky afat të jetë deri më 1 janar 2017 dhe tani kemi afruar ta shtyjme me afatin e zbatimit të këtij neni deri më 30 qershor 2017, pra rreth 4 vjet. Afati që është kërkuar nga ata është 5-vjeçar për aplikimin e këtij kushti. Letra e dërguar Komisionit për Zhvillim Ekonomik daton 26 prill 2013, me të gjitha këto alternativa.

Një opsion tjetër do të ishte që kushtëzimi me deponi të vlejë vetëm për shitësit me shumicë, përderisa pikat e shitjes me pakicë do të mund të importonin vetëm për vete.

Ne gjithashtu i kemi bërë kërkesë Komisionit Parlamentar për këto ndryshime dhe presim që t'i adresojnë në fazën e grupeve parlamentare.

Së fundi, në projektligj është qartësuar çështja e rregullimit të tregut të naftës, vëzhgimit, raportimit nëpërmjet përcaktimit të përgjegjësisë të Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 9/2011 të punës së Qeverisë së Kosovës.

Gjithashtu është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave, deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integritetit se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me 'aqui' të BE-së.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë, me të cilin do të mundësohet krijimi i një midisi më të favorshëm dhe më rregullues për funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të naftës, duke pasur parasysh se projektligji i propozuar është draftuar në përputhje me Legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe gjithashtu është në përputhje të plotë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ju propozoj të miratohet në këtë seancë plenare nga ju, të nderuar deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Një sqarim edhe për ju që jeni të pranishëm, edhe për ata që nuk janë. Ligji nuk mund t'i kthehet Qeverisë pa u zhvilluar debati dhe pa u votuar në fund. Mocionet për kthimin e ligjeve pa debat janë kundër Rregullores, me të cilën jemi duke punuar. Prandaj, kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike ishte kundër asaj që shkruan Rregullorja dhe të cilën e kanë votuar edhe ata vetë. Unë nuk e paragjykoj ligjin, sigurisht që kam thënë edhe në një rast, po e përsëris edhe një herë, jam që ky Parlament ta miratojë ligjin antimonopol, dhe ky ligj, siç ka ardhur, e krijon një farë monopoli, ndoshta jo në kuptimin më të mirë të fjalës, por krijon dhe favorizon kompani të caktuara, dhe si i tillë është i dëmshëm dhe realisht e godet edhe qytetarin, edhe bizneset e caktuara. Ne jemi të obliguar t'i mbrojmë edhe bizneset e vogla, edhe bizneset e mesme, si Kuvend dhe si shoqëri. Fjalën e ka kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri më 16 prill e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe ka nxjerrë rekomandimin për miratim në parim.

Dëshiroj të ju njoftoj që nuk kemi pasur debate të tilla në komision, është për keqardhje, dëshiroj të jem korrekt edhe para kolegëve deputetë, edhe para gjithë atyre që na shohin, të tregoj që nuk ka pasur një debat të tillë brenda komisionit, e do të ishte mirë që debatet e tilla, kërkesat e tilla të shteren një herë në komision, e pastaj të dalim në seancë.

Dëshiroj po ashtu të ju them që pikërisht për çështjet që u ngrehën si delikate, ministrja e ka deponuar një letër më datën 26, të cilën e kam kërkuar prej stafit mbështetës që posa të fillojmë trajtimin, pas miratimit në parim me grupe punuese, t'i deponohet grupit punues, në mënyrë që të jetë material i trajtimit të ardhshëm në komision. Nuk e kemi pasur një pikë të rendit të ditës në ndërkohë që ta trajtojmë këtë çështje ose këtë kërkesë shtesë, që ka ardhur nga ministria.

Po ashtu, dëshiroj të njoftoj që pikërisht në çështjen që është më delikate në këtë komision, e kemi një pikë të rëndësishme që është sfidë në Raportin e Progresit, e që thuhet gati tekstualisht se Kosova nuk ka rezerva të naftës as për dy ditë dhe pikërisht në këtë çështje Ministria ose Qeveria dëshiron ta rregullojë këtë formë. Mirëpo, me propozimin shtesë të ministres, që do të jetë pjesë e trajtimit në komision, është një version i cili nuk e lejon monopolin, pra i lejon bizneset e vogla të merren me tregtimin e

naftës dhe i obligon ata që merren me tregtimin me shumicë të kenë rezerva, të cilat i parasheh shteti.

Prandaj, unë i lus deputetët, grupet parlamentare që të punojnë në grupe punuese, në mënyrë që këtë ligj ta kemi sa më shpejt të miratuar, që këtë fushë që është kaq e rëndësishme dhe kaq delikate ta rregullojmë të paktën sa më mirë me ligjin që ne do ta aprovojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit, fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar ligjin dhe është unanim që të kalojë në debat në leximin e parë dhe të aprovohet në parim me vërejtjet e mundshme, të cilat mund të dalin gjatë debatit në komisionin e krijuar për dizajnimin e këtij ligji.

Ne kemi vërejtje, të cilat do t'i paraqesim edhe si grup parlamentar, por edhe si deputetë.

Është befasuese mënyra se si trajtohet nga disa deputetë që janë pjesëmarrës të partive tjera në komision. Është e vërtetë që edhe unë si anëtar i komisionit po befasohem tash kur thuhet shumë lehtësisht se po shkelet Kushtetuta, ose të kthehet. Një herë u kthye, tash edhe një herë tjetër, ose e kanë një interes personal diku ata që tërhiqen, ose nuk janë të interesuar të ballafaqohen dhe ta vënë ligjshmërinë në këtë sektor, i cili është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik.

Në planin tim personal, unë i kam vërejtjet e mia personale, të cilat janë në përputhshmëri edhe me disa deputetë, të cilët janë duke i tërhequr këto. Prandaj, ne kërkojmë që të hapet një debat, në të cilin gjatë kohës së leximit të dytë ne kemi mundësi t'i plotësojmë, t'i mangësojmë ose t'i dizajnojmë sipas standardeve, të cilat nevojiten, e jo të largohemi kështu.

Në fund fare, unë e kërkoja një formë replike me zonjën Teuta Sahatqija, e cila thotë që jam deputet i ri. Unë e di që jam deputet i ri, por nuk jam nomad politik, prandaj si nomad politik nuk kam nevojë që të vlerësohem nga ata të cilët nuk e gjejnë veten në asnjë parti, por bëjnë lëvizje sikur nomadët me çadra. Prandaj, mos i lini këto kërriga kështu të shkreta, sepse popullata ju ka dërguar për të votuar dhe për t'u ballafaquar me ligjet, për t'i plotësuar ligjet, e jo të tërhiqeni në këtë mënyrë që ne na krijon përshtypje se nuk janë të interesuar të vënë ligjshmëri. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë e thashë edhe herën e kaluar, që ky ligj qartë, me nenin e tij që e përqendron të drejtën e importimit të derivateve në ato kompani, të cilat kanë mundësi deponimi, pra që janë kompani më të mëdha, është shkelje e parimit të lirisë në treg, dhe këtë s'mund ta mohojë askush. Ky është parim kushtetues në Republikën e Kosovës, apo jo?

Jo domosdoshmërisht, unë pajtohem 100% me këtë parim, por tashmë është parim kushtetues në Republikën e Kosovës, dhe si i tillë nuk ka të drejtë të shkelet, as nga Kuvendi me shumicë votash, e as nga Ministria nëpërmjet ligjit dhe këtë duhet ta kemi të qartë. Pra, Kuvendi nuk ka të drejtë as të debatojë, e lëre më të votojë ligje të cilat janë në shpërputhje me Kushtetutën. Dhe, unë mendoj që ky Kuvend njëherë e përgjithmonë duhet të bëhet Kuvend, i cili mendon dhe vepron në bazë të këtyre dokumenteve, të cilat janë përmbi ne.

Dhe, mënyra e vetme, fatkeqësisht tash, për ta kushtëzuar një lloj pune të tillë në Kuvend për këtë çështje është të pamundësohet votimi i këtij ligji.

Dhe, rrjedhimisht, meqenëse kjo është mënyra e vetme, ne po ashtu do ta braktisim sallën për ta prishur kuorumin që të pamundësojmë votimin e këtij ligji.

Këto çka u thanë nga disa deputetë, që do të amendamentohet ligji, e do të përmirësohet, e që paska shkresë nga ministrja e kështu me radhë, edhe pse ne si anëtar të komisionit nuk e kemi parë këtë shkresë ende, këto janë pastaj mundësi goxha relative dhe nganjëherë të rrezikshme për shkak se i kemi pasur disa përvoja, që kështu është folur në seancë, dhe pastaj ka ndryshuar qëndrimi i deputetëve edhe nëpër komisione dhe edhe herën e dytë kur është votuar në seancë.

Pra, këto janë fjalë, të cilat këta deputetë, jo një herë, po shumë herë, i kanë ngrënë, i kanë tërhequr prapa dhe kanë vepruar prapë siç u është drejtuar dhe e njëjta gjë ka rrezik të ndodhë edhe këtu.

Prandaj, ne mendojmë që ky ligj në parim nuk ka të drejtë të kalohet nga ky Kuvend, për shkak se në parim e shkel Kushtetutën, pra si të tillë do ta marrim këtë masë të braktisjes së seancës, ose të kësaj pike, më mirë të them, për ta pamundësuar votimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, nuk është replikë. Vazhdojmë! Secili grup e ka qëndrimin e vet. Në emër të Aleancës, Donika Kada-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADA-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Është e çuditshme këmbëngulja e Qeverisë dhe e Ministrisë për ta vazhduar debatin edhe kur evidentohet se kemi të bëjmë me një ligj antikushtetues.

Unë dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk mund ta kuptojmë si të debatojmë për diçka që është antikushtetuese. Prandaj, nuk do ta përkrahim këtë ligj, i cili sigurisht që në këto momente na kujton edhe “Sharcemin”, edhe rastin e monopolit të vitit të kaluar. Tash ndoshta është përpjekja edhe këtë verë dikujt t’i lë shije të hidhur një monopol i radhës.

Prandaj, po ashtu, sikur edhe parafolësit dhe dy partitë tjera, nuk do të jemi pjesë e debatit për një ligj antikushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Duke pasur parasysh se Ligji për tregun e naftës dhe produktet e naftës në Kosovë e ka marrë miratimin në Komisionin Parlamentar, mund të themi se ministrja i paska sjellë disa vërejtje dhe kërkoj nga kryetari i Komisionit që tjera herë të gjitha sugjerimet që i dërgon Ministria të na i shpërndajë të gjithë deputetëve të Komisionit Parlamentar, që sot ta kemi një frymë më demokratike për kalimin e ligjit.

Janë disa vërejtje në tri nene. Unë e kam thënë edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit që ne do t'i ndryshojmë këto tri nene. Ministrja i paska sjellë rekomandimet, por unë nuk i kam parë dhe shpresoj që gjatë amendamentimit të këtij projektligji, që në leximin e dytë, ligji të jetë viza-vijë në interes të të gjithë operatorëve të naftës dhe qytetarëve, e jo në interes të disa grupeve të naftëtarëve, të cilët mendojnë që duhet të ketë monopol. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i SLS-së, e do fjalën? Jo. “6+”? Jo. Grupi i ri “Zajednička Budućnost”? Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Ako vam nešto znači u ovom trenutku, mi podržavamo usvajanje, da Nacrt zakona o naftnim derivatima ide na dalje procesiranje, i podržavamo rad po komisijama.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESH: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë mendoj se ky ligj krijon monopol dhe është në kundërshtim me ekonominë e lirë të tregut, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe as nuk është dashur të sillet në Parlament për votim.

Mendoj se ky ligj na e kujton monopolin që është tentuar të vihet vitin e kaluar edhe për çimenton në Kosovë, që qytetarëve të Kosovës u morri miliona dhe iu dhanë “Sharrcemit”, ose firmës “Titan” dhe kështu tentativa për ta vënë naftën në kontroll është shumë e dëmshme, sepse atëherë ky monopol do të mund ta kontrollonte tërësisht çmimin e naftës në treg dhe përsëri të merrte vendime e vendime të ndryshme në dëm të konsumatorëve të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj që një ligj i tillë nuk duhet të kalojë, nuk duhet të votohet dhe unë si deputet i pavarur do ta lëshoj seancën dhe të mos jem pjesë e një votim për një ligj të tillë, i cili plotësisht është në kundërshtim me të gjitha ligjet e Kosovës dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Justina Shiroka-Pula e ka fjalën.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje ministra dhe deputetë,

Tregtia me naftë dhe me derivatet e naftës vazhdon të jetë një ndër sektorët më të diskutueshëm në vendin tonë. Ky sektor është i një rëndësie të posaçme si për Qeverinë, ashtu edhe për subjektet që veprojnë në këtë lëmi.

Nga aspekti i politikave qeveritare, rëndësia e rregullimit të këtij sektori arsyetohet nga vëllimi i naftës dhe produkteve të naftës që konsumohen në vendin tonë, që e përfaqësojnë zërin më të rëndësishëm të bilancit tregtar, llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave dhe tatimet që mbliidhen së pari në rastin e importit, e pastaj në brendi të vendit.

Në anën tjetër, në këtë lëmi veprojnë mbi 1 000 subjekte ekonomike me kapital të konsiderueshëm të investuar në ndërtimin e deponive apo pikave të shitjes së karburanteve, si dhe me numrin e të punësuarve.

Tregtimi në këtë sektor është përcjellë me kujdes të shtuar edhe nga publiku i gjerë për shkak të ndikimit të drejtpërdrejt të konsumatorëve nëpërmjet çmimeve, sasisë dhe cilësisë të karburanteve, ashtu edhe nga institucionet publike nëpërmjet mënyrës së mbikëqyrjes së këtij sektori, përfshirë edhe autoritetin kosovar të konkurrencës për shkak të ndryshimeve të bazuara në fiksimin e çmimeve.

Projektligji që sot po diskutohet nuk jep përgjigje në çështje të caktuara më lart, por në shumicën e tyre kemi përkeqësime.

Më lejoni që shkurtimisht t'i adresoj çështjet e cilësisë së karburanteve që sot tregtohen në vendin tonë dhe qasjen e projektligjit ndaj kësaj çështjeje.

Është përshtypje e përgjithshme se cilësia e karburanteve është larg asaj që është përcaktuar në udhëzimin administrativ që është në fuqi. Për ta sqaruar më mirë këtë çështje, më duhet të kthehem pak në të kaluarën dhe të krahasoj politika të ndryshme qeveritare të asaj kohe dhe të sotme.

Në të kaluarën, përpjekje serioze për kontrollin e cilësisë së karburanteve, si të atyre që importohen, ashtu edhe në tregun e brendshëm, ka pasur gjatë vitit 2009-2010.

Gjatë kësaj periudhe, cilësia e derivateve kontrollohej nëpërmjet analizave të çdo autoboti që hynte në Kosovë nga laboratorit që autorizoheshin nga vetë ministria.

Mirëpo, duke u nisur nga paragjykimet politike dhe pa analizë të situatës reale në tregun e naftës, në maj të vitit 2011, Ministria aktuale ia ka tërhequr autorizimin këtij laboratorit dhe për disa muaj nuk ka pasur kurrfarë kontrolli se çfarë derivatesh hyjnë në Kosovë.

Të gjithë jemi dëshmitarë se çështja e licencimit të këtij laboratorit është hetuar nga organet kompetente, të cilat kanë vërtetuar se licencimi i tij është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Ky fakt do të duhej të ishte argument për ministrinë që t'i korrigjojë vendimet të mëparshme dhe të vazhdojë kontrollin e cilësisë në mënyrë të njëjtë nëpërmjet

laboratorit, i cili ka ekzistuar, apo në bazë të më shumë laboratorëve, të cilët do t'i përcaktojnë vetë ministria.

Por, personi i autorizuar në këtë ministri, i inkurajuar dhe i udhëzuar nga disa palë të interesit, e filloi kontrollin e cilësisë së naftës jo nëpërmjet ndonjë laboratorit, por nëpërmjet autorizimit të një trupi inspektues.

Në fakt, kontrolli i cilësisë nga trupi inspektues bëhet vetëm nëpërmjet shikimit të dokumentacionit të cilësisë, përkatësisht deklaratave të konformitetit të derivateve që importohen.

Për më tepër, importuesit kanë paguar dhe vazhdojnë të paguajnë çmime për shikim të dokumentacionit, i cili është i njëjtë apo më i lartë se çmimi që kanë paguar më parë për testimin laboratorik të mostrave të karburanteve.

Në anën tjetër, është e palogjikshme të pritet që ndonjë importues të paraqesë gjatë importit dokumente që nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit aktual për cilësinë e naftës.

Për më tepër, duhet cekur se sipas legjislacionit në fuqi vendi ynë nuk ka obligim të pranimit të dokumenteve të konformitetit nëse nuk ka marrëveshje ndërkombëtare në këtë fushë. Po ashtu, ne nuk jemi të bindur se trupat inspektues të autorizuar kanë të drejtë ta kryejnë inspektimin e këtillë, duke marrë parasysh se Ligji 04/L-039 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin të konformitetit në mënyrë së saktë përcaktojnë se kjo veprimtari kryhet vetëm nga organi kompetent inspektues, e të cilin ligji e përkufizon si organ të ministrisë kompetente.

Siç jemi në njohuri edhe nga mjetet e informimit, kjo mënyrë e kontrollit të cilësisë së derivateve është kundërshtuar ashpër edhe nga dy laboratorët e autorizuar nga Ministria, të cilët kanë ngritur padi ndaj disa zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për shkelje të ligjit në këtë fushë.

Çështjen e cilësisë së derivateve, projektligji i propozuar e degradon edhe më tutje, duke mos përcaktuar kurrfarë kriteri, por me formulime të përgjithshme se do të rregullohet me akte nënligjore, duke marrë për bazë standardet e harmonizuara të BE-së.

Duhet të përkujtojmë se ligji në fuqi është dukshëm më i avancuar, duke marrë për bazë jo vetëm standardet e harmonizuara dhe ndërkombëtare, por definon qartë se gjatë përcaktimit të standardeve ministria duhet çdo herë ta ketë parasysh që aplikimi i tyre të mos shkaktojë çrregullime të furnizimi i tregut me naftë dhe derivate të naftës, apo favorizim të ndonjë prodhuesi apo vendi, si dhe të jetë në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, me udhëzimin administrativ 07/2012 të datës 27.4.2012 mbi cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, ka përcaktuar standarde të reja të cilësisë së naftës që në esencë kanë të bëjnë me zvogëlimin e sasisë së 'surfullit' nga 50 PPM dhe 10 PPM, por ne nuk jemi të bindur se këto standarde të reja të cilësisë së

naftës të jenë në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe me cilësinë prodhuese dhe cilësinë e vendit që e ka favorizuar Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë.

Struktura aktuale në tregun e naftës dëshmon si miratimi i standardeve më të larta nuk është përcjellë me përmirësim real të cilësisë në treg, por me çmim më të lartë dhe se miratimi i këtyre standardeve e ka favorizuar Maqedoninë dhe përpunuesin grek të naftës në këtë shtet si furnizues kryesor i derivateve në tregun tonë.

E gjithë kjo pa dyshim na çon në përfundim se gjatë këtyre dy vjetëve kemi pasur pakënaqësi të vazhdueshme, kurse projekti i propozuar nuk afron zgjidhje për problemet e cilësisë.

Gjatë këtyre dy vjetëve i vetmi ndryshim në këtë fushë është se kontrolli i cilësisë nga një laborator është zëvendësuar me kontrollin e cilësisë nga një trup inspektues. Le të mbetet në gjykimin tuaj vlerësimi se a më mirë kontrollohet cilësia nëpërmjet testimit laboratorik apo shikimit të dokumentacionit, të cilin e sjell importuesi.

Edhe në hartimin e akteve nënligjore shihet se nuk është bërë kurrfarë përparimi. Duhet ta shikojmë nenin 21 të projektligjit, i cili vërteton se janë në fuqi dhe do të mbeten edhe më tutje të aplikueshme udhëzimet administrative, të hartuara gjatë periudhës së kaluar, që dëshmon mbi përpjekjet e drejta në rregullimin e kësaj fushe. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Kryetari i Parlamentit, zoti Krasniqi e ka fjalën.

KRYETARI: Unë fillimisht dua ta them një çështje.

Nuk mendoj që opozita nuk ka të drejtë në këtë që e ka thënë, por mënyrën si kërkon shtyrjen e ligjit me një mocion realisht nuk e parasheh Rregullorja e Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit e parasheh mundësinë që Qeveria, si sponsorues, ta tërheqë ligjin. Parlamenti mund t'ia kthejë ligjin Qeverisë, pas debatit dhe pas mos votimit në parim të projektligjit të sjellë nga Qeveria. Kjo është rruga procedurale për t'ia kthyer ligjin Qeverisë.

Në fakt, edhe unë mendoj që ligji i ri nuk është më i mirë se ligji i vjetër. Përkundrazi, mendoj që ligji që është në përdorim është në një segment më i mirë se ky që është na është ofruar ta diskutojmë dhe ta miratojmë në Kuvend.

Si duket, ligji është marrë nga ndonjë vend që e ka rafinerinë e vet të përpunimit të naftës. Kosova nuk ka. Ato vende që e kanë rafinerinë e naftës e kanë të drejtën ta mbrojnë vendin e vet dhe shtetin e vet, por pasi Kosova nuk ka rafineri të naftës mendoj që nuk duhet të përpiqet të krijojë monopol në këtë drejtim. Ndoshta nuk është monopol në kuptimin e plotë të fjalës, por është një favorizim i dukshëm i disa bizneseve që kanë deponi për derivatet.

Dhe, nëse e shikojmë në anën tjetër, pse bizneset që kanë deponi, që kanë mundësi të deponojnë, të frikësohen nga bizneset që tregtojnë me pakicë. Unë nuk e shoh këtë arsye. Për mua, thjesht është një përpjekje për të favorizuar biznese dhe për ngulfatur biznese të vogla dhe të mesme dhe konsideroj që ne edhe me Kushtetutë i kemi të ndaluar favorizimet dhe e kemi të ndaluar krijimin e monopoleve dhe e kemi pranuar tregun e lirë.

Nëse një kompani e vogël ose e mesme u bën konkurrencë kompanive të mëdha që kanë deponi për të deponuar miliona litra derivate, unë nuk e shoh në fakt nëse këta do të ishin konkurrentë në treg. Nuk ka asnjë arsye Ministria t'i marrë në mbrojtje, apo Qeveria. Kështu që realisht, ne do të duhej ta mbrojmë interesin e qytetarëve.

Tjetër? Nëse Qeveria do ta bëjë këtë diferencim, do të duhej t'ia arsyetonte Parlamentit se bizneset që kanë deponi e kanë cilësinë më të mirë të mallit në treg, kurse bizneset e vogla dhe të mesme që bëjnë tregti me naftë e kanë cilësinë më të dobët. Atëherë Kuvendi vërtet do të duhej të mendonte se si ta përmirësonte cilësinë e derivateve në tregun e Kosovës. E ne e dimë se cilësia e derivateve në tregun e Kosovës është jashtë standardeve, madje edhe jashtë standardeve që ne i kemi paraparë me ligjet tona dhe që nuk i respektojnë ata që marrin me shitblerjen e këtyre mallrave.

Prandaj, ne do të duhej ta kishim vërtet një analizë të tillë. Mendoj që po të bëhet një analizë e tillë do të dalë e kundërta, që kompanitë që kanë deponi në Kosovë i kanë derivatet me cilësinë më të dobët se sa ata që bëjnë tregti me naftën dhe nuk kanë deponi në Kosovë.

Mendoj që këtë analizë Qeveria do të duhej t'ia dërgonte Kuvendit dhe Kuvendi të marrë vendime. Kështu siç është, shihet qartë se Ministria, në këtë rast mundet edhe Qeveria po dëshiron të favorizojë biznese që edhe ashtu e kanë dëmtuar cilësinë e derivateve në tregun e Kosovës dhe cila është e mira e qytetarëve në këtë rast. Sa ne po i ndihmojmë qytetarët? E ne e dimë që me derivate të vogla është duke u goditur për çdo ditë xhepi i qytetarit tonë, kuptohet i atyre që kanë vetura që kanë automjete, se derivatet janë të një cilësie të dobët. Kështu që kjo është arsyeja që unë nuk e kuptoj opozitën që nuk e mbron këtë ligj. Dhe, në fund të fundit, nëse ligji është dhe është kundër Kushtetutës, atëherë duhet të jetë në fund, nëse e miraton Kuvendi, dhe deputetët mund ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese dhe ajo ta mbrojë Kushtetutën. Ajo është një institucion që e kemi krijuar për ta bërë këtë.

Por, unë edhe një herë kërkoj nga Qeveria që nëse vërtet nuk e ka menduar mirë këtë ligj dhe nëse ligji vërtet është kështu siç ka ardhur si projektligj dhe bie ndesh me Kushtetutën, le ta tërheqin dhe të mos na pengojnë punën e Kuvendit. Ne do të jemi të detyruar për një pauzë, e pastaj e vazhdojmë seancën.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
I nderuar nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po flasim për një sektor shumë të rëndësishëm, i cili drejtpërdrejt, jo vetëm që ndikon te konsumatorët, te qytetarët, te makinat të cilat i ngasin ata, mirëpo për shkak një kontrolli jo të mirë të kualitetit dhe cilësisë së kësaj naftë, e cila konsumohet në Kosovë, ajo po ndikon edhe në shëndetin e tyre nëpërmjet ambientit dhe lirimit të gazrave nga një naftë shumë jo cilësore, jo kualitative në këto vitet e pasluftës në Kosovë.

Mesatarisht, në bazë shënimeve dhe të dhënave nga Departamenti i Naftës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Kosovë shpenzohen afro 457 milionë litra naftë dhe benzinë gjatë një viti. Llogaritur në çmimin e tregut, i cili sot afërsisht është 1,25 euro për litër, në Kosovë shpenzohen diku 571 milionë euro në vit në këtë sektor.

Dhe, ky sektor në këtë formë të udhëheqjes apo menaxhimit, sigurisht që interesi i kompanive të cilat merren me tregti është që të vazhdohet me këtë lloj anarkie në këtë sektor, dhe me një kualitet jo të mirë, kualitet tepër të ulët të kësaj naftë dhe derivateve të saj që shpenzohen në Kosovë.

Gjithsesi, vendosja e kriterëve për import nuk është monopol. Vendosja e kriterëve i përcakton kushtet për licencim dhe këto kushte mund t'i përgatitin të gjitha ato kompani, të cilat janë të interesuara që të merren me këtë sektor dhe me importin e këtij sektori. Gjithsesi, monopol deri tani ka ekzistuar në sektorin e kontrollimit të cilësisë. Sektori i kontrollimit të cilësisë deri më tani kanë qenë një monopol dhe ky monopol ka bërë që nafta e konsumuar në Kosovë të jetë tejtejkualitative.

Gjithsesi duhet të merrem me kriteret për licencim dhe këtë për një fakt. Duke pasur parasysh që mospagesa e TVSH-së dhe mosvendosja e arkave fiskale nëpër pompat e benzinës ka bërë që qytetarët e Kosovës të paguajnë në vit afro 100 milionë euro për kompanitë dhe këto 100 milionë euro janë shpenzuar nga xhepi i qytetarëve për interesin e kompanive. Ndoshta edhe kjo është arsyeja pse një pjesë e opozitës apo opozita sot e ka braktisur sallën e Kuvendit për arsye se me këmbëngulje dëshiron që ta ketë ende këtë monopol dhe këtë anarki në sektorin e naftës për interesa të caktuara të kompanive të caktuara, të cilat deri sot këto 100 milionë, për këto 14 vjet, i kanë dërguar në xhepat privatë të kompanive, të cilat merren me tregtinë e naftës.

Qytetarët e Kosovës dhe Buxheti i Kosovës është dëmtuar për afërsisht 100 milionë euro në vit për shkak të mosaplikimit të arkave fiskale në pompat e benzinës dhe kjo duhet të jetë njëra nga kriteret për licencimin e kompanive, të cilat merren me këtë sektor, me tregtinë e naftës.

Aplikimi i arkave fiskale për të gjitha kompanitë që merren me tregtinë e naftës duhet të jetë njëri nga kriteret për licencimin e këtyre kompanive. Është bërë praktikë që Ministria zakonisht i paraqet kriteret për licencim me një udhëzim administrativ dhe këto kriteret për licencim varësisht nga ajo se kush ka qenë ministër i ka ndërruar vetë.

Propozimi im është që në kuadër të ligjit, kriteret për licencim nga pompa më e vogël dhe deri te rafineria apo ndërmarrjet, të cilat do të merren me përpunimin e derivateve të naftës, të përcaktohen dhe të përshkruhen saktë me ligj, që pastaj asnjëri nga ministrat të mos mund t'i ndryshojnë këto kriteret për dëshirën apo interesin e tij apo kompanive, apo të shoqatave të cilat do t'i mbështetin pastaj ata. Këto do të jenë të përshkruara në kriteret për licencim të të gjitha atyre kompanive, të cilat merren me tregtinë e naftës dhe ato duhet të jenë në kuadër të ligjit, e jo pastaj të rregullohen me udhëzime administrative.

Gjithsesi është një sektor i rëndësishëm dhe mendoj që gjatë hartimit dhe shqyrtimit të këtij projektligji në komision secili nga ne do ta japë kontributin dhe mendoj që këto vërejte dhe kriteret për licencim do të merren parasysht edhe nga komisioni, duke pasur parasysht se edhe kryetarin e komisionit e kemi të pranishëm. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë seancën. Të pranishëm janë 61 deputetë.

Në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare për Ligjin që e kishim në shqyrtim u dakorduam që pasi kryetari i Komisionit e ka marrë një letër shtesë nga ministrja, le të konsultohet Komisioni Funkcional, kurse pasi u kontestua, Komisioni për Legjislacion le ta shikojë çështjen e kushtetutshmërisë, kështu që po e shtyjme për një seancë tjetër.

Kush është për? Në sallë janë 61 deputetë. Faleminderit! Edhe çështja e Rregullores mendoj se i ka disa zbrazëti. Unë ju kisha lutur që edhe Rregullores së nënkomisionit t'i japim një afat prej një muaji dhe t'i bëjë disa ndryshime dhe plotësime. Kryetar i nënkomisionit, a je për? Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryetar!

Unë, në emër të nënkomisionit, më duhet të deklaroj sesa i përket punës dhe angazhimit për Projektregulloren e re të Kuvendit dhe që nga miratimi në leximin e parë, mendoj që është finalizuar dhe e mbështes këtë qëndrim.

Ajo çka nënkupton që edhe nga prania e vetë deputetëve, meqë kërkohet konsensus më i madh politik, sepse të gjithë e dimë që kjo duhet të votohet me 2/3, për këtë arsye ne pajtohemi që kjo të shtyhet në çfarëdo afati kohor, edhe pse ju e theksuat një muaj, për ne është e mjaftueshme, që të gjitha ato dilema që mund të dalin të paraqiten në afatin kohor brenda këtij afati mund t'i përmirësojmë dhe mund ta sjellim për votim në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe për këtë na duhet një votim formal. Kush është për? Faleminderit! Të pranishëm janë 62 deputetë.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet numër 03/L-221 dhe numër 04/L-116

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave ka paraparë që në programin legjislativ për vitin 2013 të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me qëllim të adresimit të disa çështjeve të rëndësishme sa i përket menaxhimit të financave publike.

Një nga çështjet kryesore, të cilat i trajton ky projektligj, është vendosja e një rregulle fiskale sa i përket deficitit të përgjithshëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës, i cili nuk duhet ta tejkalojë nivelin prej 2% nga GDP. Këto dispozita që kanë të bëjnë me rregullën fiskale janë diskutuar dhe pajtuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me partnerë tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Dispozitat e këtij projektligji përmbajnë disa ndryshime sa i përket klasës së investimeve të fondeve nga Fondi i Konsoliduar i Republikës së Kosovës, me qëllim që mjetet nga fondet publike të mund të investohen në institucionet relevante financiare brenda dhe jashtë Kosovës.

Përveç kësaj, janë qartësuar një numër i konsiderueshëm i dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë edhe sa i përket mekanizmave për zbatimin e tij.

Konsideroj se me miratimin e këtyre ndryshimeve do të avancohet procesi i menaxhimit të financave publike, duke përfshirë edhe një kontroll më të fortë të qëndrueshmërisë makro-fiskale të Republikës së Kosovës.

Ju informoj se ky projektligj nuk prodhon kosto shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në procesin e hartimit të këtij projektligji, Ministria e Financave është konsultuar me të gjithë aktorët që kanë të bëjnë me këtë fushë dhe i ka përfshirë komentet relevante në këtë projektligj.

Bazuar në këto vlerësime dhe në nevojën për ta miratuar këtë projektligj në përputhje me afatet kohore, të dakorduara edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, rekomandoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, kryetare e Komisionit FunkSIONAL.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ka ardhur në përfundim se Projektligji i plotëson të gjitha kushtet për t'u miratuar në seancë plenare.

Qëllimi kryesor i projektligjit janë rregullat fiskale që e përcaktojnë kufirin e deficitit buxhetor dhe synon ta mbajë borxhin në nivel të qëndrueshëm.

Ky projektligj i përcakton parimet e politikës fiskale dhe kornizën ligjore për përgatitjen dhe implementimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, pra synon që borxhin ta mbajë në nivel të qëndrueshëm nëpërmjet bilanceve buxhetore, niveleve të borxhit dhe rritjes afatmesme ekonomike.

Po ashtu, me projektligj, ministrit i jepet autoriteti dhe përgjegjësia për përgatitjen dhe implementimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe të amendamenteve të tij për ta shmangur apo kompensuar një deficit të tepruar, apo për ta rivendos kufirin e deficitit.

Projektligji si i tillë e përmban memorandum shpjegues për objektivat që synon t'i realizojë ligji.

Po ashtu, projektligji e përmban edhe deklaratën për ndikimet buxhetore që vlerësohet pa kosto shtesë buxhetore.

Projektligji po ashtu e përmban edhe deklaratën për përafrimin e këtij projektligji me ligjet e Bashkimit Evropian, që kanë të bëjnë me financat publike.

Projektligji po ashtu i përmbush edhe kushtet që parashihen formalo-juridike për miratim në parim.

Megjithatë, janë disa nene në të cilat kërkohet rregullim teknik dhe gjuhësor dhe përshtatje formalo-juridike e hartimit të legjislacionit, që mund të rregullohen pas miratimit në lexim të parë në Kuvend, pastaj me punën që do ta bëjë Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Këtu duhet të ndërhyhet në nenin 21, që ka të bëjë me legjislacionin e konsoliduar.

Mandej, në nenin 4, pika 5.1 dhe në disa nene tjera që si Komision mendojmë që mund të bëhen ndryshime të tilla të duhura gjatë punës së amendamentimit të këtij projektligji.

Në projektligj, nëse e marrim dhe analizojmë, nuk janë përfshirë të gjitha rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilat i ka dhënë ai nëpërmjet rekomandimeve me rastin e monitorimit të zbatueshmërisë së Ligjit për menaxhimin e financave publike. Kështu që ne mendojmë që gjatë punës tonë në Komision, aq sa na lejojnë dispozitat ligjore, do të bëjmë inkorporimin e këtyre rekomandimeve, të cilat janë miratuar në seancë plenare në kuadër të Projektligjit për plotësim-ndryshim të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon deputetët që ta miratojnë në parim dhe t'i japin mundësi komisionit që t'i bëjë ndryshimet e duhura gjatë procedurës së punës në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën. Në emër të Grupit, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në parim do ta mbështesë.

Kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami e ka kërkuar fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike. Në fakt, ne nuk pajtohemi me të gjitha ato çka janë propozuar, por kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit dhe gjithashtu do të angazhohemi që një pjesë e rekomandimeve që vijnë nga raporti për mbikëqyrjen e këtij ligji nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të inkorporohen sipas mundësive.

Unë do ta shfrytëzoj rastin që sot të bëj thirrje që faktikisht pas amendamentimit dhe derisa të vijmë në leximin e dytë të këtij ligji, ne do ta kemi Ligjin për menaxhimin e financave publike në katër dokumente. Unë besoj që kjo absolutisht nuk i shërben askujt. Të paktën nuk u shërben atyre që duan ta implementojnë, meqenëse e kemi një ligj, i cili po ndryshohet dhe po plotësohet për të tretën herë. Unë kisha propozuar që kur të kryhen amendamentet, të merren të gjitha këto katër dokumente, Administrata ta kryejë punën e vetë, t'i inkorporojë në një ligj dhe ta kemi Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe mbikëqyrjen e financave publike në një dokument, e jo në katër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kërkuar Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet në parim këtë projektligj dhe të gjitha vërejtjet teknike do t’i japim dhe do t’i shqyrtojmë në Komisionin Funkcional për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të mbështesë këtë projektligj, në të cilin çështja kryesore është rregullimi fiskal, do të thotë që deficitin të mos jetë më tepër se 2%. Mirëpo, Komisioni për Buxhet dhe anëtarët e tij, por edhe anëtarët e Grupit të Aleancës që janë nëpër komisione do të kontribuojnë që ky projektligj të jetë sa më i zbatueshëm dhe sa më praktik. Faleminderit!

KRYETARI : Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se pak kohë më përpara në këtë Kuvend, Komisioni për Buxhet dhe Financa bëri monitorimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, mund të themi se rekomandimet të cilat kanë dalë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa janë më të mira që do të kishte mundësi Ministria e Financave t’i marrë gjatë amendamentimit apo gjatë draftimit të ligjit.

Në parim, mund të themi se Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah projektligjin. Të gjitha çështjet të cilat nuk janë draftuar nga rekomandimet e komisionit, e ka qenë për lëvdata puna e Komisionit për Buxhet, të draftohen gjatë amendamentimit në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontić e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani članovi Vlade,

Poštovane kolegice i kolege,

Samostalna liberalna stranka, razmatrajući Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o menadžiranju javnih finansijama i odgovornostima zaključila da pomenute izmene u ovu važnu oblast dodatnu uređuju i povećavaju preciznost pojedinih postojećih odredbi.

Budžetska trošenja i fiskalna disciplina, prioritet su koji pred vladu Kosova postavljaju međunarodne finansijske institucije, ali i obični građani za interesovani da se budžetom raspolaže u skladu sa Zakonom.

Smatramo da je posebni napredak koje ove izmene treba da donesu su izmene člana 14. postojećeg zakona i jasno definisanje personalne odgovornosti i odnosa unutrašnje kontrole i revizije.

Smatramo da su predložene izmene i dopune Zakona dobar osnov za sprovođenje fiskalne politike, koji ima za cilj da se nađe optimalan odnos između postojećih resursa zaduživanja i srednjoročnog ekonomskog rasta.

Samostalna liberalna stranka podržati će ovaj Nacrt zakona.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “6+”, deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

“6+” Parlamentar Grubu Yasa Tasarısını incelemiştir, tasarıdaki tamlamalar yasanın pratikte daha kolay yürürlüğe girmesini sağlayacaktır. Bu doğrultuda “6+” Parlamentar Grubu bu Yasa Tasarısını desteklemektedir.

KRYETARI: Grupi “Zajednička Budućnost” a ka të lajmëruar? Nuk ka. Pa grup, fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Edhe unë mendoj se këto propozime kanë qenë të nevojshme dhe do ta përmirësojnë menaxhimin e financave publike. Janë disa çështje që, sipas mendimit tim, nuk janë përfshirë në mënyrë të duhur dhe eventalisht duhet të mendohet për një amendamentim ndërmjet dy seancave.

E para ka të bëjë me vendimet për angazhime të mëdha buxhetore në projekte të mëdha, që përfshijnë disa miliona, të cilët duhet të ekzistojnë me rregull në buxhet që ato vendime mund të aprovohen vetëm nëse ekziston projekti dhe studimi i fizibilitetit, i cili e arsyeton angazhimin e mjeteve aq të mëdha, siç janë për shembull autostradat, ose ndonjë projekt tjetër. Do të duhej të ishte shumë e qartë se nuk mund të merret vendimi për të hyrë në projekte të tilla para se të aprovohet studimi i fizibilitetit.

Çështja e dytë ka të bëjë me një shfrytëzim të destinuar. Unë e di se fondet nuk janë shumë. Ende nuk e kemi bërë një zgjidhje për të krijuar fonde të posaçme, si për shembull nga fondet që krijohen nga shitja e aseteve nëpërmjet privatizimit, por ne duhet ta kemi në Ligjin për financa publike, që ato mjete të privatizimit, mjete të cilat kanë të bëjnë me pasuritë natyrore, në qoftë se shiten, ato mjete duhet të përdoren vetëm për zhvillim, e kurrësi për konsum dhe likuiditet të përditshëm. Duhet të përdoren për krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për më shumë gjenerata.

Çështja e tretë që dëshiroj ta ngre, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme, ka të bëjë edhe me trajtimin që i jepet kornizës së shpenzimeve afatmesme.

Korniza e shpenzimeve afatmesme është një instrument shumë i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit Qeveria, por edhe Kuvendi, mund të realizojnë disa prioritete afatgjata në zhvillim. Deri tani, korniza e shpenzimeve ka qenë një dokument fakultativ. Para 2-3 vjetësh, ai ka ardhur formalisht në Kuvend që Qeveria t'i dëgjojë sugjerimet e Kuvendit. Tash as nuk vjen fare në Kuvend. Domethënë është një dokument i Qeverisë, të cilin ajo zakonisht nuk e konsideron me respektin e duhur, por për të realizuar për shembull ndryshime thelbësore dhe për arritur prioritete, ne kemi thënë arsimi, shëndetësia, ose një prioritet tjetër. Ne duhet të veprojmë disa vite me përpjekje buxhetore dhe angazhime buxhetore. Derisa korniza e shpenzimeve afatmesme nuk respektohet sa duhet dhe ndryshohet me vendime të përsheptuara, siç është zakon t'i quajmë vendime ad hoc, atëherë rëndësia e këtij dokumenti devalvohet.

Mendoj se edhe komisioni që i ka shqyrtuar ndryshimet e nevojshme, nuk e ka trajtuar mirë këtë problem.

Pra, mbeten këto tri çështje që janë esenciale, pa të cilat ne nuk e kemi një Ligj për menaxhimin e financave publike çfarë i duhet Kosovës dhe pa respektimin e këtyre çështjeve nuk jam i sigurt se do ta arrijmë suksesin e dëshiruar në menaxhimin e financave publike. Faleminderit!

KRYETARI: Zenun Pajaziti e ka fjalën. Nuk është. Prania me kartela është 82 deputetë, e kështu i kemi 60.

Të lajmëruar për fjalë nuk kemi, prandaj shkojmë në procedurën e votimit. Tash të pranishëm janë 64 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 50 vota për, 6 me ngritje dore, domethënë 56 për, asnjë abstenim, asnjë kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet numër 03/L-221 dhe numër 04/L-116.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Projektligji është propozuar nga deputetja Alma Lama, përkrahur nga deputetët nënshkrues.

Qeveria e Kosovës brenda afatit të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit e ka proceduar në Kuvend qëndrimin lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

E ftoj deputeten Alma Lama, në cilësinë e propozuesit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qëllimi kryesor i Ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë është të krijojë kushte të përshtatshme për punën e gazetarëve.

Misioni i medias është të punojë për interesin publik. Ky ligj i ndihmon mediet të punojnë pa frikë për interesin publik.

Ky ligj është i domosdoshëm për t'i mbrojtur burimet e gazetarisë.

Për ta garantuar lirinë e shprehjes.

Liria e shprehjes është esenciale për demokracinë.

Gazetaria e luan një rol vital demokratik në ekspozimin e keqpërdorimeve.

Ligji e krijon një ambient të lirisë më të madhe për ta informuar publikun për këto keqpërdorime.

Aktualisht, në legjislacionin e Kosovës gazetarët janë të pambrojtur.

Mungesa e mbrojtjes ka implikime serioze në aksesin e gazetarëve te burimet konfidenciale.

Ligji i mbron gazetarët nga rreziqet që u kanosen në rast se ata detyrohen t'i nxjerrin burimet.

Shumë gazetarë i përdorin burimet konfidenciale për tema shumë të rrezikshme që kanë të bëjnë me raste të rënda korruptive apo kriminale. Në rast se një gazetar do të konsiderohet një informator apo një spiun i autoriteteve ose një dëshmitar i ardhshëm në një proces gjyqësor, ata mund të bëhen target i njerëzve të inkriminuar.

Ky projektligj i ka dy shtylla kryesore: së pari garanton se askush nuk mund t'i detyrojë gazetarët ta nxjerrin burimin e tyre të informacionit, dhe së dyti askush nuk mund t'ua marrë gazetarëve materialet e tyre të punës, kasetat, fletoret e shënimeve, ta kontrollojë postën e tyre, të bastisë makinat, shtëpitë apo redaksitë e tyre e të tjera.

Projektligji mbron jo vetëm gazetarët, por të gjithë profesionistët e tjerë të medias, të cilët kanë informacion për burimet, si kameramanët, fotografët, montazherët, shoferët etj. Pra, tërë stafin që ka informacion për shkak të profesionit që ushtron.

Projektligji për mbrojtjen e burimeve e njeh të drejtën e heshtjes për gazetarët, kur ata thirren në procese gjyqësore për të dëshmuar në lidhje me informacionin që e kanë mbledhur me qëllim për t'ia servuar publikut.

Projektligji i mbron gazetarët edhe në raste të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kur disa të drejta të njeriut suspendohen.

Pothuaj secili shtet i Bashkimit Evropian i mbron burimet e gazetarëve me ligj, me një ligj të veçantë si ky që e kam propozuar unë, ose me dispozita të përfshira në ligje të tjera.

Në hartimin e këtij projektligji kam marrë parasysh rekomandimet më të fundit të Këshillit të Evropës, si rekomandimin numër 7 të Komitetit të Ministrave në vitin 2000 dhe rekomandimet e Asamblesë Parlamentare 195 të vitit 2011, e cila i fton të gjitha shtetet anëtare të miratojnë legjislacion për mbrojtjen e burimeve.

Nevoja për një ligj të tillë është më e madhe këtu në Kosovë, krahasuar me vende të tjera, të cilat janë anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo sepse qytetarët e Kosovës nuk mund ta paditin shtetin e tyre në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rast se shkelen të drejtat e tyre.

Njohja e burimeve është një e drejtë e cila u njihet gazetarëve në shumë vende, por edhe në ligjin ndërkombëtar.

Projektligji mbështetet në praktikat më të mira dhe më të avancuara të vendeve të ndryshme të Bashkimit Evropian sa i përket mbrojtjes së burimeve të gazetarisë. Po ashtu, mbështetet në rekomandimet e Federatës Evropiane të Gazetarëve, qoftë në përkufizime, qoftë në fushëveprim, qoftë dhe në kuptimin e termave.

Gjatë fazës së hartimit të projektligjit, kam zhvilluar dëgjime publike me grupet e interesit, si gazetarë dhe pronarë mediesh, si dhe anëtarë të shoqërisë civile. Më 1 qershor 2012 e kam bërë publik draftin e parë dhe kushdo që ka qenë i interesuar e ka pasur mundësinë t'i sjellë vërejtjet dhe komentet gjatë dy muajve, derisa e kam dorëzuar në Kuvend. Ndërsa më 14 nëntor 2012, me mbështetjen e UNDP-së, kam organizuar gjithashtu një dëgjim me grupet e interesit dhe deputetë të komisioneve të ndryshme në lidhje me përfshirjen e blogjeve në këtë projektligj, pra për t'u konsultuar me ta.

Pas këtij debati, por dhe shume konsultimeve të tjera që kam pasur me organizata ndërkombëtare, kam vendosur që edhe ato të përfshihen, pas leximit të parë.

Gjithashtu, kam bashkëpunuar me ekspertët e OSBE-se dhe po kështu drafti i është dërguar për komente edhe Këshillit të Evropës, Human Rights Watch, Komisionit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Përveç Këshillit të Evropës, nga organizatat e tjera kam pasur komente për draftin, por kam pasur komente edhe nga gazetarë të Kosovës dhe nga organizata joqeveritare. Disa komente kanë ardhur para

dorëzimit në Kuvend dhe ato janë përfshirë në këtë projektligj, ndërsa komente të tjera kanë ardhur pas dorëzimit të projektligjit në Kuvend.

Projektligji është dorëzuar në Kuvend më 24 korrik 2012, pra para shumë muajsh, dhe ka pasur ndryshime gjatë kësaj kohe në legjislacionin e Kosovës. Pas ndryshimeve, sot ka një zbrazëti ligjore në këtë fushë, dhe ky projektligj synon ta krijojë bazën e nevojshme ligjore.

Integrimi në Bashkimin Evropian kërkon respektimin e lirisë së medie dhe Kosova nuk mund të integrohet në BE pa e dhënë edhe një garanci të tillë për gazetarët. Nëse nuk e bën këtë sot, do të detyrohet ta bëjë nesër.

Gjithashtu ju bëj me dije se Kosova është kritikuar vazhdimisht në Raportin e Progresit në lidhje me lirinë e medie. Edhe organizata të tjera, si Freedom House, vazhdimisht e kanë renditur Kosovën në listën e vendeve që kanë problem me lirinë e medias.

Jam e bindur se miratimi i këtij projektligji, jo vetëm që do të jetë një plus shumë i madh për lirinë e medie, por do t'i ndihmojë Kosovës shumë që ta përmirësojë imazhin e saj të dëmtuar jashtë vendit.

Dua të sqaroj përpara jush gjithashtu se ligji nuk duhet të ngatërrohet në asnjë moment me Ligjin për shpifjen dhe fyerjen, i cili është miratuar në legjislaturën e kaluar.

Po ashtu, ky projektligj nuk ka kosto financiare.

Si për kohëzgjatësi, pikërisht dje presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Obama, i ka bërë thirrje Senatit dhe senatorëve që të miratojnë Ligjin për mbrojtjen e burimeve në nivel federal, një ligj i tillë pra i ngjashëm. Së paku duket se në këtë pikë jemi një hap përpara.

Përfundimisht, ky projektligj tenton të vendosë një gur të rëndësishëm në themelin e lirisë së medie.

Prandaj, unë ju ftoj të gjithëve që ta vlerësoni drejt dhe ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, pas paraqitjes së projektligjit, hap debat për diskutim në parim. Fjalën ia jap kryetarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetit Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29.4.2013, e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të

gazetarisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim - Të miratohet në parim Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

Vërejtjet, sugjerimet dhe amendamentet eventuale nga deputetët dhe grupet parlamentare do të merren për bazë gjatë fazës së amendamentimit të ligjit.

Në komision ka pasur debat, ndërkaq në fund është vendosur, me shumicë votash, që Projektligji të vijë në lexim të parë në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Qeverisë, më duket nuk e do fjalën askush. Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Meqë kam qenë edhe vetë pjesë e debatit që është zhvilluar për Projektligjin që vjen për herë të parë në Kuvendin e Kosovës për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, është mirë që ky projektligj ka ardhur në Kuvend. Ky projektligj thotë se gazetarët në Kosovë kanë garanci të plotë që punën e tyre ta kryejnë në mënyrë profesionale, të pavarur dhe të paanshme, meqë puna e gazetarëve është e mbrojtur edhe me nenet e Kodit Civil, si dhe me nenet e Kodit të Procedurës Penale.

Për më tepër, në Kodin e Procedurës Penale, në nenin 26, nënparagrafi 1.6, thuhet: “Lirohet nga detyrimi për të dëshmuar gazetari apo votuesi, i cili punon në media, apo një apo më shumë nga bashkëpunëtorët e tij, në pajtim me ligjin e zbatueshëm”.

Kjo dispozitë ligjore, e futur brenda Kodit të Procedurës Penale, e rregullon mbrojtjen e punës dhe veçanërisht të burimeve të gazetarisë.

Kur jemi te mediet dhe puna e gazetarëve, normat ligjore në Kosovë në aspektin e mbrojtjes së lirisë së medias janë në pajtim me standardet e larta të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të vendeve demokratike, por ajo që mbetet sfiduese është edhe zbatimi i këtyre normave dhe i legjislacionit që e rregullon çështjen e medieve.

Për më tepër, ne jemi dëshmitarë të debateve të shumta që janë organizuar edhe nga asociacioni i gazetarëve profesionistë të Kosovës dhe iniciuesja e ligjit dhe burimet mbrohen me ligj në shumicën e shteteve të Bashkimit Evropian pa përjashtim dhe gati në të gjitha vendet e rajonit, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, edhe Maqedoninë. Se shtetet duhet të ofrojnë mbrojtjet eksplicite dhe të qartë të të drejtave të gazetarit dhe t'i mbrojnë burimet e informacionit, kjo është e paraparë dhe sugjerohet edhe nga Këshilli i Evropës në rekomandimin për të drejtat e gazetarëve, që të mos i zbulojnë burimet e informacionit.

Natyrisht, këto burime duhet të zbulohen vetëm atëherë kur e cenojnë jetën e qytetarëve të Kosovës dhe si deputete e këtij Parlamenti dhe si pjesë e Grupit Parlamentar të PDK-

së, unë do ta votoj në parim, mirëpo gjatë procedurës së amendamentimit ne do ta ofrojmë edhe kontributin tonë.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë është në funksion të avancimit të demokracisë dhe mbrojtja e burimeve të gazetarisë është esenciale për lirinë e shprehjes. Kështu është e garantuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe e trajtuar në mënyrë të veçantë me të drejtën ndërkombëtare.

Kjo u jep kurajë gazetarëve që të mos rrëshqasin në autocensurë, si dhe burimit të informacionit për të prezantuar çështje që janë në interes të publikut.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta shohë me kujdes gjatë punës dhe do ta japë kontributin për ta pasuruar edhe më shumë ligjin dhe në këtë mënyrë e kalon në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, i propozuar nga deputetja Lama dhe i mbështetur nga Lëvizja “Vetëvendosje”, synon të japë garanci shtesë për punën e gazetarëve, një ambient ligjor, i cili nuk i mbron ata.

Ligji për mbrojtjen e burimeve ndonjëherë njihet edhe me emrin si Ligji i privilegjeve të gazetarëve, pasi u jep këtyre të fundit një status të veçantë. Në mënyrë që në media të jetë e lirë, që gazetarët ta bëjnë punën e tyre pa u frikësuar se gjykatat mund t’i detyrojnë t’i tregojnë burimet, është e nevojshme që ata të mbrohen me ligj.

Nëse e themi me fjalë të thjeshta, me këtë ligj, do të thotë se autoritetet, përfshirë edhe gjykatat, nuk mund ta detyrojnë një gazetar ta nxjerrë identitetin e burimit të informacionit. Kjo e drejtë bazohet në njohjen se pa një garanci të anonimitetit, shumë njerëz do të hezitonin të ofronin informacione, që ato të ndaheshin me publikun.

E drejta për informim të lirë dhe të paanshëm është një nga të drejtat themelore të njeriut, e sanksionuar edhe në Kushtetutën e Kosovës. Nuk mund të kemi informim të lirë e të pavarur në rast se kjo liri nuk do t’u sigurohet gazetarëve.

Ne si deputetë duhet të kujdesemi për ta krijuar atmosferën e lirisë në vendin tonë, e jo të frikësimit e të shantazhit, dhe janë ligjet ato që ndikojnë me forcën e tyre që kjo liri të garantohet, sepse nuk thuhet kot se liria mbrohet me ligj.

Pa pasur mbrojtje të burimeve të gazetarisë, siç e bën ky projektligj, me qindra informacione të rëndësishme nuk do t'i servoheshin publikut, nuk do ta gjenim kurrë ndoshta dritën e tyre. Po jua kujtoj rastin e famshëm të Water Gate, ku dy gazetarë të 'Washington Post' e bazuan gjithë historinë e tyre, e cila çoi deri në rrëzimin e presidentit pikërisht në një burim anonim. Në fakt, publiku e mori vesh se kush ishte ky burim anonim, por atë vetëm në vitin 2005, kur vetë burimi deshi të shfaqej në publik. Dy gazetarëve të famshëm asnjëherë nuk iu kërkua që ta nxjerrin këtë burim.

Në rast se do të ishte kërkuar nga autoritetet, ata do t'i kishin pasur vetëm dy rrugë: ose ta nxjerrin burimin dhe si pasojë të ndërprisnin shkrimet e tyre të përditshme, për çka nuk mund të merrnin më informacion, ose ta ruanin identitetin e burimit dhe të shkonin në burg dhe prapë publiku të mbetej pa informacion.

Një situatë të tillë ligjore e kemi në Kosovë. Gazetarët janë krejtësisht të pambrojtur. Çdo gjykatë mund t'i detyrojë ata t'i nxjerrin burimet, ose nëse refuzojnë - të shkojnë në burg. Sot, në shumë vende të botës, gazetarët po luftojnë që të pajisen me një ligj të tillë, i cili u jep mbrojtje shumë të gjerë. Në fakt, në shumicën e vendeve evropiane, parlamentet përkatëse i kanë miratuar provizionet pas një lobimi dhe presionesh të fuqishme që kanë bërë gazetarët për ta pasur këtë mbrojtje.

Jam më se i sigurt se gazetarët e vendeve të tjera tashmë do t'u kenë lakmi gazetarëve të Kosovës për mbrojtjen që u jep ky projektligj. Natyrisht, këtu e kam fjalën për ata gazetarë profesionistë, që bëjnë investigime të rëndësishme për publikun.

Ky projektligj përshkruan në mënyrë të detajuar të drejtat e gazetarëve, përmend po mënyrë kaq të detajuar se kush tjetër përfiton, pra të gjithë profesionistët e medias, e po kështu garanton se mjetet e tyre të punës nuk guxon t'i prekë askush.

Ata që e kuptojnë rëndësinë e lirisë së shprehjes, e kuptojnë edhe rëndësinë e projektligjit. Një nga institucionet më të rëndësishme publike i ka dhënë mbështetje këtij projektligji, siç është misioni i OSBE-së në Kosovë. Në deklaratën e tij, në prag të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, ambasadori i OSBE-së në Kosovë ka deklaruar se është i inkurajuar me miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë nga Komisioni Parlamentar i Kuvendit për Media.

Me miratimin e këtij ligji do të kontribuohet në masë të madhe edhe në zhvillimin e mëtejshëm të gazetarisë hulumtuese, ka deklaruar ai. Po ashtu, mbështetje për këtë projektligj tashmë kanë dëshmuar edhe pjesa më e madhe e përfaqësive diplomatike të vendeve perëndimore të akredituara në Kosovë.

Përfundimisht, ne si Lëvizje besojmë se ky projektligj është një kontribut shumë i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë dhe të gjithë duhet ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Qysh në fillim po them se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet plotësisht Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe në të njëjtin kohë më lejoni të them se kjo paraqet 3-4 elemente vërtet të rëndësishme që besoj se duhet t'i ndajmë së bashku.

Elementi i parë është se ky projektligj paraqet ose ofron një mundësi më shumë dhe gjithmonë kur është një mundësi vërtet është me rëndësi, sepse gazetarët në Kosovë kanë nevojë për mundësi të përcaktuara me ligj, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e burimeve të veta, në mënyrë që normalisht ato të përdoren në aspektin profesional.

Elementi i dytë është garancia. Pra, pos mundësisë për të cilën po flasim, po flasim edhe për një garanci ligjore që u ofron gazetarëve dhe këtu kryesisht kemi të bëjmë me gazetari hulumtuese, e jo gazetari protokollare, por kryesisht është një garanci e rëndësishme për raste specifike dhe të ndjeshme. Duhet ta bëjmë tepër të qartë.

Në raste të tilla ku mediet, gazetarët ose pronarët e medimeve të caktuara, ose përfaqësuesi e autorizuar, qofshin ata redaktorë, ose qofshin përfaqësues juridikë ose legalë, kemi të bëjmë vetëm me raste specifike. Është mirë që të paktën, unë si ish-gazetar, nuk e di ndonjë rast tepër të madh që na ndodh në Kosovë, e në të cilin gazetarët kanë qenë të detyruar t'i paraqesin burimet e veta.

E di që ka qenë një rast vërtet i rëndë menjëherë pas përfundimit të luftës. Ju kujtohet besoj të gjithëve me gazetën "Dita", e cila është detyruar edhe të mbyllet për shkak të asaj që mediumi nuk i ka paraqitur burimet e veta. Besoj se në aspektin profesional ka bërë punë profesionale, sepse ajo që i duhet medias dhe gazetarëve është që ta ruajnë dinjitetin e burimit të vet deri në momentin kur mund edhe të dënohet personalisht, por nëse ka elemente të ruajtjes së dinjitetit të burimit, ato nuk duhet, profesionalisht po flas, asnjëherë të hapen ose të jenë publike për njerëzit, ose për opinionin.

Elementi i tretë që ka rëndësi ta themi është se fatkeqësisht edhe më tutje në këtë diskursin tonë publik ka një keqkuptim jashtëzakonisht të madh ndërmjet asaj që është burimi i gazetarisë dhe asaj që është shpifje.

E kemi dëgjuar jashtëzakonisht shpesh, edhe këtu në Kuvendin e Kosovës, në këtë sallë, e kemi dëgjuar edhe në të gjitha mediet, në vlerësimet e ndryshme, se si po bëhet kjo. E vërteta është se këto dy tema nuk janë të ndërlikdhura. Shpifja është diçka krejt tjetër, e cila rregullohet ose sanksionohet, ta them më qartë, me ligje tjera, me Kodin penal dhe me të gjitha këto, ndërsa burim i gazetarisë, ose burim i artikullit, i kronikës, i produktit të gazetarit ose gazetares, është krejt diçka tjetër. Dhe, aty do të duhet dhe çdo herë duhet të matet e vërteta e produktit, e jo e vërteta e burimit. Jo e vërteta e asaj çka ka thënë një burim, ose disa burime anonime, por matet e vërteta e produktit, e produkti final në gazetari, ose qoftë artikull, qoftë reportazh, qoftë dokumentar, ose forma të ndryshme, zhanre të ndryshme të gazetarisë.

Dhe, këto janë elemente të cilat mundësojnë, sipas këtij projektligji, një garanci, por po ashtu edhe një qartësim për atë se çka realisht duhet të mbrohet si burim i gazetarisë dhe çka realisht duhet të sanksionohet si abuzim i gazetarëve ose i medimeve, qofshin me burime të gazetarisë, që i quajnë, ose qofshin me produktin, që ata e japin në opinion.

Duhet ta qartësojmë se megjithëse duket shumë gjeneralizim, besoj se është e vërtetë. Në situatën në të cilën jemi, në shumicën e sferave, nëse nuk mund t'i dallojmë më shumë se 2-3 sfera të jetës sonë, në kuptimin e rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të veta, janë përafërsisht të njëjta. E kemi të njëjtë përafërsisht, nuk po dua të gjeneralizoj komplet, por i kemi të njëjtë përafërsisht kapacitetet në politikë me kapacitete në shoqërinë civile, por edhe në media, e kjo normalisht që na bënë të jemi të qartë edhe të vetëdijshëm se mediet në Kosovë nuk e kanë arritur nivelin madje as nivelit rajonal dhe kjo nuk e nënkupton mundësinë që mediet të abuzojnë. Por, ajo çka është me rëndësi dhe çka po ndodh edhe sot, besoj se ne po afrojmë ose do të afrojmë me iniciativën e deputetes Lama, një bazë ligjore, një garanci ligjore për punën e tyre, për raste të ndjeshme, të cilat mund të ndodhin, sepse thashë se deri më tash ka ndodhur vetëm një rast i madh. Fatmirësisht nuk ka pasur raste të tjera të mëdha.

Ky nivel i zhvillimit ose i moszhvillimit normalisht se ka pasur shumë raste dhe vazhdon të ketë edhe këto ditët e fundit, edhe ditë të ardhshme do të ketë besoj pasaktësi në raportime, pasaktësi në kronika, abuzim me formulime me tituj të mëdhenj, me të gjitha këto, të cilat lehtë qartësohen se fare nuk janë të vërteta. Ama hiç.

Është çështje e mediumit, e gazetës, ose e gazetarëve, të cilët vazhdojnë në formë të tillë që ta tregojnë joprofessionalizmin e vet.

Unë e kam thënë shumë herë, besoj se është me rëndësi ta them edhe tash. Nuk është e domosdoshme të kemi media të pavarura. Është e domosdoshme të kemi s media profesionale. Edhe nëse është qartësisht e varur prej një subjekti, prej një subjekti ekonomik ose politik, ose kulturor, ose çka do, duhet të jetë profesionale. Le ta bëjë punën e vet profesionale, ajo është krejt çfarë ka nevojë.

Edhe një herë, se e zgjata shumë, ne e mbështetim projektligjin dhe besojmë se e jep një mundësi dhe një garanci shtesë, por në të njëjtën kohë u bën thirrje edhe një herë medimeve, gazetarëve, të jenë profesionalë dhe të jenë vetëm profesional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe ne e dimë që ky projektligj buron edhe si rekomandim i Këshillit të Evropës nëpërmjet rekomandimit 2007/2000, pika 7 të Komitetit të Ministrave dhe shumica e arsyeve, për të cilat ne e mbështetim këtë ligj, u cekën këtu nga kolegët tanë

deputetë. Kështu që unë do të flas shkurt dhe rekomandimet apo propozimet tona, të cilat i kemi përkritazi për këtë ligj, do t'i përcjellim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Sayın Milletvekilleri

Kosova Cumhuriyeti Anayasası sözkonusu basın ve gazeteciler olduğu zaman Anayasanın 40. maddesi ifade özgürlüğü, 141. maddesi bağımsız medya komisyonu ve 42. maddesi basın özgürlüğüyle bu hakları koruma altına almıştır. Basın özgürlüğü ve çoğulcuğu güvenceye bağlıdır Kosovada media ve gazetecilerimizin. Sansür yasaktır, Irk, ulus, etnik köken veya nefret esaslı şiddet ve düşmanlığın kısıktılmasının önlenmesi için zorunlu olduğu durumlar dışında, basın aracılığıyla bilgi veya yayın düşünceleri yaymayı kimse engelleyemez, Fakat bütün bu haklarımıza rağmen Kosova genelinde gazeteciliğin ve topluluk gazetecilerinin özellikle çeşitli topluluklara mensup gazetecilerimize ait fikir ve beklentiler mevcuttur. Bu çerçevede mevcut sorunlar çoğalmıştır, bu yüzden gazetecilerimizin haklarını ve beklentilerini kapsayan bu taslağı “6+” Parlamenter Grubu olarak destekliyor, önerilerimizi komisyonlarda sunacağız.

Teşekkürler.

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

I poslanička grupa Zajednička Budućnost podržaće u načelu usvajanje Zakona o zaštiti izvora novinarstva i daće svoj doprinos u radu funkcionalnih komisije i stalnih komisije. Hvala!

KRYETARI: Tani është fjala e deputetëve. Fillojmë me deputeten Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mendoj që është një iniciativë, e cila duhet përshëndetur, sepse e ka sjellë në Kuvend një ligj, i cili e krijon bazën juridike për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, bazë kjo e cila nuk ka ekzistuar deri më tani, me gjithë faktin që Kushtetuta e Republikës së Kosovës paraqet parime të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtës apo lirisë së medieeve dhe lirisë së shprehjes. Mirëpo, neni 55 i po kësaj Kushtetute parasheh edhe rrethanat në të cilat mund të kufizohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe meqenëse këtu paraqitet një gamë mjaft e gjerë e rrethanave, të cilat natyrisht do të interpretoheshin nga gjykatat, shumica e vendeve që janë anëtare e Këshillit të Evropës, por edhe të Bashkimit Evropian, e kanë praktikuar miratimin e ligjeve të veçanta, të cilat i mbrojnë burimet e gazetarisë.

Në Kosovë, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë të heshtur sa i përket kësaj çështjeje, pra nuk e rregullojnë mbrojtjen e burimeve, me gjithë faktin që ia ndalojnë gjykatës ta ftojë një gazetar në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo kjo është një çështje krejt tjetër, pra që nuk e rregullon fushën, të cilën po e rregullon tani ky ligj.

Është me rëndësi të theksohet fakti që meqenëse ne e kemi një obligim kushtetues sipas nenit 53, që të gjitha vendimet e institucioneve publike të jenë në përputhje të plotë me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, po ashtu të ndërmarrim veprime konkrete që ky obligim kushtetues të plotësohet. Dhe, mendoj që miratimi i këtij ligji është një veprim i tillë, i cili, përveç kësaj, është edhe në përputhje të plotë me dy rekomandimet e Këshillit të Evropës, që u përmendën.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka miratuar një sërë vendimesh, të cilat do të duhej të merren parasysh edhe gjatë amendamentimit të këtij ligji, në veçanti rastin “G...” kundër Mbretërisë së Bashkuar, “Tillak” kundër Belgjikës dhe “Telegraf” kundër Holandës, sepse, siç e thashë, për shkak të obligimit kushtetues, gjithsesi standardet juridike që janë paraparë në këto vendime, të përfshihen në këtë ligj, dhe në qoftë se ato merren parasysh, atëherë domosdoshmërisht që do të duhej të bëhen disa ndryshime, sidomos të fushëveprimit i projektligjit dhe të përkufizimit.

Është po ashtu inkurajuese që edhe më herët, por edhe sot, 18 ambasada që përfaqësojnë vende të ndryshme të Evropës e kanë përkrahur projektligjin duke treguar që ai vërtet është në përputhje me standardet më të mira evropiane.

Prandaj, edhe vetë e përkrah, siç e kam përkrahur bashkë me zonjën Lama që nga fillimi këtë projektligj dhe shpresojmë që sidomos në Komisioni për Integritet Evropian do të vazhdojmë ta japim kontributin tonë që ky ligj të ndryshohet edhe më tej në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane që i përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Liria e shprehjes dhe e mendimit të lirë në kuptimin e gjerë paraqet postulatën kryesore të të drejtave elementare të njeriut që janë sanksionuar në dokumente ndërkombëtare, po në kuptimin e ngushtë të nocionit liria e shprehjes dhe e mendimit të lirë pa dyshim se përfshin edhe të drejtën e publikimit, qoftë ky publikim korpus i punës intelektuale, apo transmetimit të ndonjë informacioni për të cilën autori i saj konsideron se është i vlefshëm për t’ia drejtuar publikut.

Për këtë është konceptuar me të drejtë se liria e shtypit është matës kryesor i shprehjes së lirë të qytetarëve.

Liria e shtypit është e pamundur të jetojë në simbiozë me shtypjen që u bëhet qytetarëve, por edhe anasjelltas.

Liria e shprehjes së qytetarëve nuk mund të ekzistojë në simbiozë me shtypjen që u bëhet medimeve.

Andaj, edhe nuk është e rastësishme që në paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, në nenin 19, theksohet se secili duhet të keta të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo

e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve të ideve të të gjitha llojeve.

Projektligji për mbrojtjen e burimeve të informacionit është një projektligj mjaft i nevojshëm, që në rend të parë u shërben gazetarëve profesionistë, por edhe qytetarëve, në përgjithësi.

Normalisht se për gazetarët nuk ka dilemë se ku është arsyeja e interesit nga rregullimi ligjor i këtij draftligji, por interesi i qytetarit qëndron në të drejtën e tij që të informohet pa ndërhyrje paraprake nga organet e dhunës.

Rëndësia e këtij ligji rritet sidomos pas heqjes së neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal i Kosovës. Kjo ngase në strukturën e Ligjit Penal nuk e kemi të konsoliduar as përgjegjësinë penale për posedimin e informacionit dhe burimit të tij, e as garantimin për mbrojtjen e poseduesit të informacionit.

Çështja që ndërlidhet me këtë është se vërtet nenet 37, 38 dhe 39 ishin denigruese për gazetarët, por mungesa e këtyre neneve definitivisht nuk mjafton në mbrojtjen e shtypit të lirë.

Pra, nuk është e kotë që në teorinë juridike, normacioni pozitivisht përqendrohet në norma që janë në fuqi, e jo mbi bazën e inekzistencës juridike. Pra, gazetarët nuk meritojnë të mbrohen me heshtjen juridike, por kjo mbrojtje duhet të jetë e konceptuar mbi formalitetin ligjor dhe kushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë është punuar nga deputetët, e ne si deputetë, mirëpo edhe gazetarët si gazetarë të mirëfilltë jemi në gjendje t'i mbrojmë ndoshta edhe me infrastrukturë ligjore, si në këtë rast ta përkrahim në parim këtë projektligj. Mirëpo, nga këtu, nga kjo bankë e Kuvendit të Kosovës, kërkoj që edhe gazetarët në mënyrën më transparente objektive t'i pasqyrojnë ngjarjet, për arsye se puna e tyre pa ne dhe ne pa gazetarë nuk mund të zhvillohemi.

I japim përkrahje projektligjit dhe besojmë që gjatë draftimit do të ketë edhe disa ndryshime, mirëpo edhe një herë e theksoj që gazetarët të jenë objektivë në çdo ngjarje që ndodh brenda Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Lidhur me draftligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, unë do të diskutoja dhe do t'i analizoja vetëm dispozitat e nenit 5 të tij.

Konkretisht, sipas paragrafit të parë të këtij neni, gazetarët dhe profesionistët tjerë të gazetarisë janë të obliguar që ta zbulojnë identitetin e burimit të informacionit vetëm në rastet kur zbulimi i burimit të tillë është i nevojshëm për ta parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë të vdekjes të një apo më shumë personave.

Vërtet në situata kur mund të parandalohet kërcënimi serioz ose vepra penale me pasojë të vdekjes të një apo më shumë personave, unë pajtohem që gazetari duhet pasur obligim ligjor për ta zbuluar burimin e informatës së tij. Por, mendoj se ne si ligjvënës nuk duhet të ndalemi dhe të kufizohemi vetëm në situatat kur cenohet jeta dhe trupi i personit. Por, duhet shikuar mundësinë që një obligim i tillë për gazetarin të jetë edhe në rastet kur cenohet dhe rrezikohet siguria dhe funksionimi i shtetit dhe e organeve relevante shtetërore, pastaj kur rrezikohen objektet e rëndësishme ekonomike, pastaj siguria dhe shëndeti publik e të tjera.

Për të qenë më i qartë, unë do të theksoj disa situata hipotetike që mund të ndodhin në praktikë, e që sipas dispozitave të propozuara në nenin 5, gazetari nuk do të ishte i obliguar ta zbulojë burimin e informatës, e pastaj bashkërisht të vlerësojmë nëse a duhet apo jo që t'i shtojmë edhe raste të tjera obligative për zbulimin e burimit të informacionit.

Kështu po e marr shembull, nëse gazetari e ka siguruar një informatë, sipas së cilës një grup do të ngrejë në ajër shtyllën e një largpërçuesi, apo objektin në një trafostacioni elektrik, apo pendën e një liqeni, nga i cili veprim nuk do të rrezikohej jeta e asnjë personi, por do të mbetej pa rrymë apo pa ujë për një kohë të gjatë një lokalitet i caktuar, sipas dispozitave të këtij neni kështu, siç është propozuar, gazetari nuk ka obligim ta zbulojë burimin e informatës, sepse me zbulimin e tij nuk do të parandalohet vdekja e askujt, por është e mundur që me zbulimin e burimit do ta zbulonim kryerësin e veprimit shkatërrues dhe do ta parandalonim dëmtimin e pendës së liqenit dhe dëmtimin e largpërçuesit.

Shembulli tjetër hipotetik, nëse gazetari e ka informatën se persona të pacaktuar janë duke i dhënë informata të rëndësishme për sigurinë dhe ekonominë e vendit tonë ndonjë shërbimi të huaj sekret, kurse disponimi i informatave të tilla nuk e rrezikon jetën e asnjë personi, por sigurinë e ndonjë objekti strategjik apo biznesi të rëndësishëm ekonomik për vendin tonë, sërish sipas ligjit të propozuar, gazetari nuk ka obligim ta zbulojë burimin e informatës dhe kështu të mos e parandalojë rrezikimin dhe dëmtimin e objekteve të tilla. Andaj, duke pasur parasysh situata të tilla të mundshme, që mund të paraqiten në praktikë, propozoj që neni 5 të analizohet dhe të njëjtit t'i shtohen edhe raste të tjera, kur gazetari do të obligohet ta zbulonte burimin e tij të informatave. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të tjerë të paraqitur për fjalë. Atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Prania fizike 63, elektronike 83 deputetë. Votojmë tash!

Me 55 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim, me ngritje dore 1, 2, 3. Nuk ka më.

Ju njoftoj të nderuar deputetë me një, ta quaj vendim të Gjykatës Kushtetuese: Deputetët që janë të pranishëm janë të obliguar të votojnë, “për” ose “kundër”.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të padiskutueshme, për deputetët janë të obligueshme. Nëse deputetët thirren shumë në mbrojtjen e Kushtetutës dhe Gjykatës Kushtetuese i garantohet me Kushtetutë e drejta e interpretimit, atëherë votimi i deputetëve të pranishëm është obligativ.

Shkojmë edhe një herë në votim për praninë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! 65 deputetë janë të pranishëm. E votojmë tash ligjin.

Me 62 vota për, 1 kundër, 3 abstenime, miratohet ligji, plus dy vota për, me gjithsej 64 vota .

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin rrugor

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për transportin rrugor dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e vet të radhës e ka miratuar këtë projektligj. Dëshiroj të jap disa informata, të cilat mendoj që janë relevante për aprovimin e sotëm. Pra, komisioni i rekomandon Kuvendit t'i aprovojë. Është një numër i madh i amendamenteve. Ndoshta më shumë se zakonisht që bëhen gjatë trajtimit të projektligjeve. Shumica dërmuese e këtyre janë gjuhësore ose rregullim në tekstin e neneve-amendamenteve përkatëse. Në dy amendamente e kemi një mosaprovim nga Komisioni për Legjislacion, amendamenti 4 dhe amendamenti 44. Në të dyja këto raste, komisioni ynë i ka aprovuar, pavarësisht Komisionit për Legjislacion, në leximin e dytë kemi menduar që duhet të dalin në votim edhe amendamentet tona.

I pari ka të bëjë me atë që është një tekst, pra amendamenti 4, që nuk është kompetencë jona, është më shumë e Ministrisë, dhe kemi menduar që duhet të mbetet amendamenti ashtu, dhe një sqarim para se të shkojmë në votim. Te amendamenti 44, meqenëse ne deputetët në komision e kemi marrë një kërkesë nga një shoqëri civile, nga një biznes ose të qytetarëve që dëshirojnë të bëjnë biznes - taxi me motor ose skuterë - është fjala për transportin, nenin 33, transporti taxi mund të kryhet vetëm me automjet 4 plus një ulëse dhe i cili i ka së paku 4 dyer. Ne në komision bashkërisht jemi dakorduar t'i shtohet dhe për motoçikleta 1+1 ulëse, por vetëm brenda qytetit dhe mendoj që kjo pak a shumë është një risi. Ka në pak vende, por komisioni ynë e ka aprovuar. Mendojmë që kjo duhet të dalë në votim. Pra, i kemi amendamentet 4 dhe 44, të cilët nuk e kanë mbështetjen e

Komisionit për Legjislacion dhe ne mendojmë se si të tilla duhen të hidhen në votim. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! Por, shiko e keni lënë çështjen e biçikletave, se në Evropë ka shumë taksi me biçikletë, kështu që nuk është e thënë veç me mjetet e motorizuara, e keni pasur mundësinë t'i lini edhe pajtonet për turizëm - 'pajton taksi', siç kanë qenë gjithmonë. Arben, je lajmëruar tani, apo në emër të Grupit? Më mirë flet te amendamenti përkatës. Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara. Ligji ka mjaft amendamente, 126 sosh. Në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në amendamentin 5 në fakt Komisioni për Legjislacion ka vërejtje, e jo në amendamentin 4.

KRYESUESI: Ta sqarojmë, cila pikë?

ARBEN GASHI: Komisioni ka konstatuar se amendamenti 5 është i panevojshëm dhe si i tillë nuk ka nevojë të jetë në këtë ligj, dhe kur të vijmë te amendamenti 43 i kemi disa vërejtje.

KRYESUESI: A është neni 1.13 apo 1.25 sipas teje, për shkak të procedurës.

ARBEN GASHI: Për shkak procedurës dhe sipas dokumentit zyrtar që është dërguar, është amendamenti 5, pika 2 e rekomandimit.

KRYESUESI: Po, neni 3, nënparagrafi 1.25, pas fjalës "komunë" shtohet fjala: "qyteti".

ARBEN GASHI: Është e njëjta gjë, është komuna - qyteti.

KRYESUESI: A e ke për këtë?

ARBEN GASHI: Po për këtë.

KRYESUESI: Atëherë e miratojmë amendamentin 4. Ky është neni 3, nënparagrafi 1.13, pas lidhës i shtohet teksti ‘më shumë’, por jo më tepër se 4 operatorë. Ky nuk është.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

E miratojmë me elektronikë, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Kuptohet ata që e mbështetin Komisionin për Legjislacion, që është praktikë gjithmonë ose ka qenë praktikë e Parlamentit për shkak të shikimit të ligjeve brenda në Komision. E votojmë me elektronikë amendamentin 5. Regjia, votojmë tash!

Miratohet e kundërta e Komisionit për Legjislacion. Unë mendoj që është gabim, por sidoqoftë kështu e votuat.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion, fjalën e ka kryetari i komisionit, Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar dhe ka vërejtje lidhur me amendamentin 42, pjesa e fundit, ku thuhet: neni 33, paragrafi 1 ndryshohet si vijon: Transporti taxi lejohet për automjetin me 5 (4+1 ulëse), i cili ka së paku 4 dyer, kurse për motoçikleta 1+1 ulëse, por vetëm brenda qytetit. Ky amendament, sipas vërejtjeve të komisionit, ka dalë jashtë objektit të ligjit dhe nuk është menduar mirë, nuk është studiuar mirë, sepse ka edhe forma të tjera të transportit, nëse është menduar të zgjerohet transporti alternativ ose transporti turistik brenda qytetit. Nuk mund të kufizohet vetëm në mjetet e transportit

1+1, sepse ka plot forma alternative, të cilat duhet të rregullohen dhe është jashtë objektivit të ligjit dhe qëllimi i ligjit nga propozuesi nuk ka qenë që të rregullohet kjo fushë. Prandaj, komisioni ka konstatuar se është jashtë objektivit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti nënkryetar!

Unë nuk po e përsëris atë çka e tha kryetari i komisionit, por më lejoni që edhe në pjesën e parë të ligjit me të vërtetë unë e kuptoj dhe shumica tash po e kuptojnë mënyrën e lobimit të grupeve të interesave të ndryshme, që ka të bëjë me kategoritë biznesore brenda ligjeve, por kjo nuk do të ishte e drejtë nëse ka kufizim të konkurrencës apo të tregut të lirë. Edhe vetë kufizimi 4+1 tregon që këtu e kemi një kufizim të auto-taksive apo dhënies së licencave për taksi dhe unë besoj dhe shpresoj që edhe deputetët duhet ta shikojnë me kujdes, sepse nuk duhet të ketë një kufizim të tillë, pa marrë parasysh ata që tash veç posedojnë me këto taksi, se mund të jetë edhe kombi taksi, ashtu siç është në gjithë botën, edhe ju i keni, ndërsa këtu u ndalohej më shumë se 5 ulëse, ose 4+1 ulëse. Prandaj, kjo është në kundërshtim edhe me ekonominë e tregut të lirë dhe kjo duhet të vlerësohet nga ekspertët brenda ministrisë të caktuar, e jo të kufizohet detyrimisht me ligj. Pjesa tjetër, ne besojmë se duhet të kemi kujdes, sepse edhe vetë infrastruktura rrugore nuk lejon që të kemi edhe lloje të taksive të ndryshme nga ato që i posedojmë dhe sipas ligjeve që janë në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka kërkuar fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk bëhet falë as për një shërbim alternativ, as turistik. Mendoj që ligjet tjera veç e plotësojnë këtë fushë. Është vetëm për punën e transportit dhe e rregullon edhe taksinë. Edhe amendamentet tjera që sot po i kalojmë kështu, në komision i sqarojnë shumë mirë të gjitha format e taksimit, por ajo që Komisioni për Legjislacion nuk është pajtuar, është fjala vetëm për taksitë motoçikleta 1+1 përbrenda qytetit. Unë isha shumë isha shumë i qartë, mendoj që e sqarova në fillim, ka pasur kërkesa të tilla dhe ne si komision mund të ju them se kemi qenë unik, të gjithë anëtarët e Komisionit e kemi dhënë atë mundësi, përderisa nuk ka ndonjë ligj tjetër që i përcakton format tjera të ndryshme, qoftë alternative, qoftë turistike, derisa në vendin tonë ose në kryeqytet ose në qytetet e mëdha ka kërkesa të tilla, pse të mos e lejojmë me këtë ligj, i cili është një moment shumë i mirë, tash për tash. Nëse kjo nuk do të ecën ose do të ketë pengesa, ne me ligje tjeran nëse ka propozime tjera, mund t'i trajtojmë. Kjo ka qenë arsyeja pse komisioni ynë unanimisht e ka përkrahur këtë, e ka zhvilluar, e ka adaptuar këtë amendament në të mirë të futjes në punë edhe të këtij lloj taksimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi edhe një herë.

ARBEN GASHI: Vetëm një sqarim shtesë, i nderuar kryesues,

Problemi është se amendamenti është jashtë fushës së veprimit të ligjit, ka dalë jashtë ligjit, e para, dhe e dyta këtu vetë kryetari i komisionit e tha që ka pasur kompani që kanë shkuar dhe kanë lobuar dhe atë mbi bazën e interesit individual të kompanisë e kanë futur

në ligj. Mendoj se është konflikt interesi dhe nuk mund të bëhet kështu. Ligji nuk bëhet pse vjen një kompani në procesin kur ne jemi duke e hartuar ligjin dhe ne e futim në amendament të shohim se si do të akomodohet një kompani brenda ligjit. Kjo logjikisht është gabim. Unë nuk po them që kanë pasur ndonjë interes personal anëtarët e komisionit, por logjika është e gabuar, sepse propozuesi i ligjit nuk e ka pasur këtë qëllim dhe vetë fakti që një ligj kaq i vogël i ka 126 amendamente, diçka nuk është në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju po luani pingpong, por ok. Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Personalisht dëshiroj të sqaroj se unë nuk e kam takuar askënd personalisht. Unë e di që ka ardhur një kërkesë me shkrim dhe e di që ka pasur kërkesa për t'i takuar të gjithë anëtarët, e kjo nuk është ilegjitime, është legale. Është mirë që deputetët t'i takojnë të gjithë ata që duan të bëjnë biznese të ndryshme. Komisioni ynë është i dedikuar për këtë punë, është i dedikuar t'i bëjë ligjet sa më të mira, t'u japë mundësi sa më të mirë të gjithë atyre që duan. Nuk kisha dashur të paragjykoj tash interesa të ngushta. E para e punës, ky është një biznes që tek mund të fillojë. Janë biznese shumë të vogla dhe mund t'u jepet dhënë rast njerëzve me ide të tilla kreative të futet në tregun tonë edhe diçka e tillë. Unë mendoj që të gjithë deputetët pa dallim partiak e kanë dhënë votën e tyre për këtë amendament. Nuk besoj se ka të bëjë, nuk kisha dashur të paragjykoj për asnjë deputet të ndonjë partie që ka pasur ndonjë interes të veçantë në këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Unë prapë po befasohem me komisionin, kur aty unanimitet të gjithë anëtarët, përfshirë edhe të Lidhjes Demokratike, edhe të opozitës, e bëjnë votimin, ndërsa Komisioni i Ligjeve nuk jep asnjë arsyeshmëri logjike. Më e keqja është këtu që thuhet sikur për Ligjin e naftës, se takimi i grupeve të interesit, që na jep të drejtë kur thashë që për shkak të interesave personale, ndoshta po ikin edhe tash në këtë çështje. Nëse ne e miratojmë një ligj të tillë, kjo do ta rrisë një kulturë, siç është arritur në shtetet tjera.

Nëse i cenon bizneset e dikujt tjetër kjo formë e aktivitetit, atëherë duhet treguar se po i cenon në bazë të konkurrencës që po shkaktohet. Prandaj, unë nuk e shoh si të dëmshme këtë, përkundrazi në këtë rrëmujë urbanistike, jo me motoçikleta, por veç me biçikleta duhet ardhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që ne duhet maksimalisht ta liberalizojmë edhe tregun e taksive dhe të transportit. Në qoftë se nuk dimë, i kemi parë me sy të gjithë kur kemi lëvizur jashtë vendit, prandaj çdo diskutim është i tepërt. Unë nuk jam për shërbime preferenciale të taksive as në qytetin e Prishtinës, i cili e ka një luftë të madhe Komuna - taksi, ose Komuna e Lipjanit me taksitë e Aeroportit. Kështu që të gjithë ashtu që duan të

punojnë, duhet të punojnë dhe t'i paguajnë tatimet. Faleminderit! Në sallë janë 63 deputetë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 42, pa përkrahjen e Komisionit e Komisionit për Legjislacion

Konstatohet që me 38 vota për, 9 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Ju lutem mos dilni nga salla. Zoti Bajrami, ju lus. Nuk kemi kuorum, në qoftë se dilni për kafe, prandaj ju lus mos dilni. Nuk ka kuptim. Kemi kohë kur të flasim me njëri-tjetrin. Kam përshtypje që keni votuar kundër, veç për inat të Komisionit, e jo që keni qenë kundër amendamentit.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 60

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 61

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 62

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 63

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 64

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 65

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 66

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 67

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 68

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 69

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 70

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 71

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 72

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 73

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 74

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 75

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 76

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 77

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 78

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 79

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 80

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 81

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 82

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 83

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 84

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 85

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 86

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 87

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 88

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 89

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 90

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 91

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 92

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 93

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 94

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 95

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 96

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 97

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 98

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 99

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 100

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 101

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 102

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 103

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 104

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 105

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 106

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 107

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 108

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 109

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 110

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 111

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 112

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 113

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 114

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 115

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 116

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 117

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 118

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 119

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 120

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 121

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 122

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 123

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 124

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 125

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 126

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë të pranishëm 66 deputetë. E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe ju të nderuar deputetë të përgatiteni për votim. Votojmë tash!

A ka pa kartelë? 2 dy pa kartelë. Me 59 vota për, 3 abstenime, një kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-179 për transportin rrugor.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka, që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Detyrën ia paskan caktuar zonjës Time Kadrijaj. Urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2013, e diskutoi raportin përfundimtar për Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë bashkë me rekomandimet e komisioneve kryesore. Andaj i fton të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Të paraqitur të tjerë nuk ka. Në këtë projektligj janë 20 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. Ju lus të mos e lëshoni sallën!

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Ju lutem votoni, kush nuk ka votuar që të ketë vota të mjaftueshme. Pa kartelë 2. Janë 56 vota me kartelë, 2 pa kartelë 58, një kundër, gjithsej bëjnë 59 vota. Dy veta nuk kanë votuar. Në rregull! Ju lutem, votoni edhe një herë për praninë.

Votojmë tash! Mos harroni të votoni, që të mos kemi nevojë pastaj ta përsëritim kështu. Nuk e di pse na u desh ta bëjmë këtë. Vërtet nuk e dimë pse e futëm këtë. Edhe një herë votojmë për prani. Votojmë tash! Ju lutem, votoni!

Me 55 + 2 = 57 vota, erdhën, edhe dy u shtuan. Në rregull! Atëherë edhe njëherë e lus regjinë dhe ju të nderuar kolegë që të përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 61 vota me kartelë + 2 janë pa kartelë, me 63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë Faleminderit!

Pika e nëntë e rendit të ditës është shtyrë, ndërkaq në rend është pika 10:

10. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Në pajtim me Ligjin dhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës e ka përgatitur dhe parashtruar në Kuvend raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministren Mimoza Kusari-Lila, që ta paraqesë raportin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe Ligjin nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03-1-221, kam kënaqësinë e veçantë të paraqes para jush raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2012.

Ky raport e prezanton performansën e pakontestueshme të institucioneve të republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë publike. Në dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës e aprovoi Ligin nr. 04/L-079 për ndarjet buxhetore të vitit 212. Plani vjetor i pranimeve për vitin 2012 ka qenë 1 596 701 euro. Plani vjetor i pagesave ka qenë 1 585 744 euro, duke i përfshirë të hyrat vetjake, të bartura nga viti 2011, të cilat nuk janë planifikuar në Ligjin për ndarjet buxhetore.

Veçoritë kualitative të këtij raporti janë:

1. Ngritja substanciale në të hyra;

2. Tejkalmi i planit për të hyrat në disa kategori;
3. Ngritja kualitative në kategoritë e investimeve kapitale.

Në vazhdim, më lejoni ta paraqes një përmbledhje të raportit për të pasqyruar të dhënat në formën analitike dhe krahasuese për periudhën në fjalë.

Të hyrat:

Nga të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2012, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë 1 537 955 000 euro dhe paraqesin 96,3% të planit të përgjithshëm vjetor. Kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor, ndërsa kemi rritje prej 18% krahasuar me vitin paraprak, përkatësisht vitin 2011.

Të hyrat e mbledhura në kufi arrijnë në 55% të të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 844 861 000 euro, ose 96,6% të planit në vitin 2012. Krahasuar me vitin paraprak, e kemi një rritje prej 2,1% për këtë kategori.

Të hyrat e brendshme, të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës arrijnë në 18,4% të të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 283 915 000 euro, ose 98,6% të planit vjetor. Krahasuar me vitin paraprak, kemi rritje për 8,7% për këtë kategori. Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë me 3,8% në shumë prej 59 448 000 euro, në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 6,9%. Të hyrat vetjake të nivelit qendror, në totalin e përgjithshëm të të hyrave, marrin pjesë me 2,9% dhe janë në shumën prej 44 835 000 euro, ndërsa krahasuar me vitin paraprak ka një ulje prej 25,2%. Të hyrat jotatimore qeveritare paraqesin 2,6% të të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 41 145 000 euro.

Të hyrat e arkëtuara nga dividendat janë në shumën prej 45 000 000 euro, nga të cilat e tërë shuma vjen nga PTK-ja. Të hyrat e dedikuara të AKP-së janë në shumë prej 16 248 000 euro. Financimi i njëhershëm i AKP-së është në shumën prej 28 934 000 euro. Kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike është në shumën prej 4 000 000 euro. Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë janë në shumën prej 73 313 000 euro. Huazimet nga institucionet financiare ndërkombëtare gjatë vitit 2012 kanë qenë 93 677 000 euro. Grandet për përkrahje të Buxhetit nga Banka Botërore janë në shumën prej 37 417 000 euro.

Gjatë vitit 2012, kthimet nga të hyrat kanë qenë 2 740 000 euro nga Doganat e Kosovës dhe 32 763 000 nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Shpenzimet:

Shpenzimet gjatë vitit 2012, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë 1 466 457 000 euro dhe paraqesin 92% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahasuar me vitin paraprak, shihet një rritje kualitative vjetore e shpenzimeve prej 5,7%, kryesisht në kategorinë mallra dhe shërbime, që janë 8,2%, dhe në kategorinë e subvencioneve dhe transferove që janë 9,4% më të larta se në vitin paraprak. Shpenzimet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve janë 407 760 000 euro, ose 28% të shpenzimeve të përgjithshme krahasuar me planin vjetor për këtë kategori. Ato

janë realizuar në 98%. Ndërsa, krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 kemi një rritje prej 5,9%. Shpenzimet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë 169 000 362 euro, ose 12% të shpenzimeve të përgjithshme në realizim 88% të planit vjetor. Ndërsa krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 kemi një rritje prej 8,2%.

Shpenzimet nga kategoria e shërbimeve komunale janë në shumën prej 21 558 000, apo 1,4% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore, ndërsa realizimi ndaj planit është 92%. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 e kemi një rritje prej 5,8%.

Subvencionet dhe transferet janë 280 120 000 euro, ose 19% e shpenzimeve të përgjithshme, me realizim vjetor të planit me 96%, ndërsa krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 kemi një rritje prej 9,4%. Shpenzimet kapitale janë në shumën prej 550 245 000 euro, ose 38% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore.

Realizimi vjetor krahasuar me planin për këtë kategori është 88%, ndërsa krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 kemi një rritje prej 4,2%. Nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë bërë edhe disa pagesa të tjera siç janë: pagesa në emër të borxhit të jashtëm të Republikës së Kosovës në shumën prej 21 416 000 euro.

Nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2012 janë bërë pagesa në emër të kredisë dhënë KEK-ut, në shumën prej 15 000 000 euro, si dhe nga Buxheti i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012, janë ndarë mjete financiare në vlerë prej 1 050 000 euro për anëtarësim në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim të BERZH-it.

Grandet e përcaktuara të donatorëve:

Fondi i përgjithshëm i grandeve të përcaktuara të donatorëve për vitin 2012, duke përfshirë edhe bartjet nga viti 2011, është në shumën prej 23 238 000 euro. Nga ky fond, gjatë vitit 2012 janë shpenzuar 14 919 000 euro, si dhe 18 000 euro kthime të donacioneve. Gjendja e fondeve të pashpenzuara nga grandet e përcaktuara të donatorëve më 31 dhjetor 2012 është 8 301 000 euro, të cilat fonde do të barten në vitin fiskal.

Gjendja e fondeve më 31 dhjetor 2012 është 278 171 000 euro. Nga kjo gjendje, rrjedhin detyrimet si në vijim:

- fondi i donatorëve, 8 300 000 euro;
- të hyra vetjake, 33 832 000 euro;
- të hyrat e dedikuara të AKP-së, 10 676 000 euro;
- fondet tjera në mirëbesim, 9 215 000 euro.

Nga kjo shihet se gjendja e fondeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2012 është në shumën prej 216 147 000 euro.

Në fund, më lejoni të them se raporti është një tregues lehtësisht i matshëm për suksesin e institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese, si dhe një dëshmi për potencialin e tyre në rrugëtimin e sforcimit të shtetit të Kosovës dhe ngritjes së

mirëqenieje të qytetarëve. Faleminderit për bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe mbështetjen e sinqertë në periudhat e deritashme. Kam besimin e plotë gjithashtu se një mbështetje e tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja zëvendëskryeministre! Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Zëvendëskryeministre,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 është shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa më 26.4. 2013.

Komisioni ka vlerësuar se raporti i plotëson kriteret për raportim sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe është i bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për raportim në sektorin publik. Janë pasqyruar të hyrat nga niveli qendror e komunal, të hyrat nga donatorët, huamarrjet, si dhe pranimet tjera. Janë të përfshira po ashtu edhe të gjitha shpenzimet në nivelin qendror lokal dhe të institucioneve të pavarura. Është bërë klasifikimi i shpenzimeve sipas karakterit funksional dhe ekonomik, janë pasqyruar të dhënat për faturat e papaguara, të dhënat nga fondi rezervë dhe të dhënat tjera të organizatave buxhetore. Të dhënat janë të pasqyruara dhe të krahasuara me vitin 2011 dhe 2010. Si të tillë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, me shumicë votash, e ka miratuar raportin.

Nëse analizojmë me kujdes raportin, vërejmë se është një performansë e mirë e institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese, si dhe një dëshmi për angazhimin në drejtim të stabilitetit makroekonomik dhe ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë. Rritja ekonomike për vitin 2012 është vlerësuar se ka qenë 3,9%. Kosova ka pasur nevojë për një rritje ekonomike edhe më të madhe, por krahasuar me vendet e rajonit kjo është rritja më e madhe ekonomike në këtë pjesë të regjionit tonë. Vërehet se ka pasur një performansë të mirë të të hyrave që kanë mundësuar që Kosova t'i kryejë obligimet e veta dhe në fund të vitit e ka pasur një bilanc bankar pozitiv prej 278 000 000 eurosh.

Si rezultat i politikave adekuate makrofiskale dhe disiplinës financiare, niveli i deficitit ka qenë brenda kufijve, kurse borxhi publik 7,8% të bruto- produktit vendor, që është më i ulëti krahasuar me vendet tjera të regjionit. Në raport vërehet se ka rritje të të hyrave krahasuar me vitin e kaluar, është tejkaluar plani për të hyra për shumë kategori dhe ka pasur ngritje në kategorinë e investimeve kapitale, ku qytetarët përfitojnë më së shumti. Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2012 janë brenda realizimit të planit, domethënë janë realizuar 96,3% të planit të përgjithshëm vjetor. Kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit, ndërsa kemi një rritje prej 18% krahasuar me vitin paraprak, pra me vitin 2011.

Nëse marrim dhe analizojmë të hyrat të cilat janë realizuar nga Dogana dhe të hyrat të cilat janë realizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, vërejmë se gradualisht po vjen duke rënë mbledhja e të hyrave nga kufiri dhe duke u rritur mbledhja e të hyra nga Administrata Tatimore e Kosovës, domethënë nga të hyrat e brendshme, gjë që në vazhdimësi është kërkuar edhe nga Parlamenti dhe janë bërë përpjekje në këtë drejtim.

Të hyrat e mbledhura në kufi arrijnë në 55% të të hyrave të përgjithshme, që do të thotë se janë realizuar diku 96,6% të planit për vitin 2012 dhe ka pasur një rritje prej 2,1%, krahasuar me vitin 2011. Të hyrat e brendshme të mbledhura nga Administrata Tatimore po ashtu janë realizuar 98,6% të planit vjetor, kurse krahasuar me vitin paraprak ka një rritje prej 8,7% për këtë kategori, çka do të thotë se edhe pa u ngritur tatimet në fushat e ndryshme, për çështje të ndryshme, ka arritur që në sajë të një performanse më të mirë të Administratës Tatimore të ketë ngritje të të hyrave. Ajo që vlen të theksohet është që edhe të hyrat në nivelin komunal janë rritur krahasuar me vitin e kaluar për 6,9%.

Shpenzimet gjatë vitit 2012 po ashtu e kanë pasur një realizim prej 92% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahasuar me vitin paraprak, kemi diku një rritje prej 5,7%, rritje kjo që kryesisht ka qenë për mallra dhe shërbime dhe në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Raportin të cilin e kemi na jep të dhëna të detajuara për këto shpenzime, kurse në raport po ashtu janë paraqitur edhe pagesat që janë bërë në emër të borxhit të jashtëm dhe pagesat në emër të kredisë për KEK-un dhe njëkohësisht janë paraqitur edhe të dhënat për mjetet e ndara financiare për anëtarësim në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, me shumicë vota ka vlerësuar se raporti i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përmban strukturën e përgjithshme të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve. Të dhënat janë paraqitur në përqindje sipas kërkesës së komisionit, kështu që komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë raportin vjetor financiar për vitin 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës është një raport i përgatitur në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për raportin në sektorin publik.

Raporti në fjalë ofron të dhëna të mjaftueshme që dëshmojnë se institucionet e Kosovës për çdo ditë po arrijnë rritje të performansës në grumbullimi e të hyrave të përgjithshme vjetore. Meqenëse u cekën të gjitha shifrat, nuk t'i përsëris të gjitha, por do të ndalem në atë se gjatë vitit 2012 të hyrat e grumbulluara në raport janë në vlerë prej 1 537 955 000 euro, që paraqesin 96,3% të të hyrave të planifikuara për vitin 2012, që krahasuar me vitin 2011 kemi një rritje të të hyrave të përgjithshme vjetore prej 18%, ku rritjen më të madhe edhe këtë vit e kemi në Dogana, sidomos e kemi rritjen më të lartë ndoshta të Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe shihet një rritje simbolike e lehtë të të hyrat vetjake nëpër komuna.

Sa u përket pagesave të realizuara gjatë vitit 2012, në bazë të të dhënave që na i ofron ky raport financiar, arrijnë vlerën prej 1 466 457 000 euro, apo shprehur në përqindje 92% të planit të përgjithshëm vjetor, dhe nëse e krahasojmë me vitin 2011 kemi një rritje prej 5,7% të shpenzimeve, të cilat të ndara sipas kategorive shihet se e kemi një rritje të pagave dhe mëditje në vlerë prej 20 942 000 euro, krahasuar me vitin paraprak. Mallra dhe shërbime po ashtu kemi një rritje prej 10 891 000 dhe subvencionet dhe transferet në shumë prej 23 841 000 euro, gjithmonë duke bërë krahasime me vitin paraprak.

Ndërsa sa u përket shpenzimeve kapitale, gjatë vitit 2012, nga buxheti dhe nga donatorët kanë qenë në vlerë prej 554 813 000 euro, që krahasuar me vitin 2011 kanë qenë më të larta për 23 521 000 euro, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të dhënat e këtij raporti janë treguesit më të mirë për suksesin e institucioneve të Republikës së Kosovës për vitin 2012. Po ashtu, këto të dhëna janë një dëshmi e fortë se institucionet tona po arrijnë t'i realizojnë prioritetet e shtet-ndërtimit dhe një infrastrukturë të qëndrueshme për një zhvillim ekonomik, duke pasur gjithmonë synim ngritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë. Dhe, në fund, Grupi Parlamentar i partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë raport financiar për vitin 2012 dhe besojmë se ai i pasqyron në mënyrë të saktë dhe të drejtë të gjitha transaksionet financiare dhe institucioneve të Kosovës nga Buxheti i Republikës së Kosovës, fondet në mirëbesim, grantet e donatorëve dhe huamarrjet për vitin 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se raporti financiar për vitin 2012 karakterizohet me jotransparencë absolute. Raporti nuk ka të dhëna të shpenzimit për projektet kapitale, që përfshijnë 38% të Buxhetit të Kosovës. Mungojnë komplet të dhënat për tabelën 3.2 të Buxhetit lidhur me projektet kapitale.

Qeveria ka dështuar ta realizojë planin e të hyrave që e ka paraparë dhe gjatë vitit 2012 kemi pasur shkurtime të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në shumë prej 28 000 000 euro, kemi pasur shkurtime të investimeve kapitale në shumë prej 60 000 000 euro dhe e kemi përmbyllur vitin 2012 me 40 000 000 euro fatura të papaguara.

Të hyrat:

Njësoj si edhe viteve të tjera, 1/3 e Buxhetit të Kosovës mbledhet në Dogana në emër të TVSH-së dhe kjo është tepër shqetësuese, sepse janë tërhequr 418 000 000 euro nga qarkullimi në kufi të Kosovës. Nëse shihet trendi i të hyrave, konfirmohet se në Kosovë ka krizë ekonomike. Të hyrat nga doganat dhe ATK-ja janë 27 000 000 euro më të vogla se ato të planifikuara në buxhetin e vitit 2012. Huamarrja e brendshme dhe ajo e jashtme është rritur për 33 herë, nga 5 000 000 euro në 167 000 000 euro. Nuk është e vërtetë që janë rritur të hyrat për 18%. Janë rritur pranimet për 18%, por kjo është bërë në emër të borxhit. Është rritur huamarrja e brendshme dhe është rritur huamarrja e jashtme dhe Qeveria duhet të jetë në gjendje t'i tregojë popullit se për çka ajo po merr borxh. Po merr borxh për të blerë vetura, për të paguar bileta aeroplani të fluturimeve të klasës së parë dhe hotele gjithashtu të klasës së parë.

Pranimet tjera, ku përfshihet edhe devida, kanë rënë për 23% në krahasim me një vit më parë. Derisa në vitin 2011, këto të hyra ishin 106 000 000 euro, në 2012 kanë rënë në 86 000 000 euro. Vetëm devida e PTK-së në tre vetët e fundit është përgjysmuar dhe, siç po duket, si rezultat i saj kemi shitjen e PTK-së për 242 000 000 euro. Në vitin 2012, në emër të TVSH-së në Dogana janë mbledhur 418 000 000 euro. Megjithatë, duhet theksuar se këtu kemi gjysmë milion më pak në krahasim me një vit më herët dhe kjo është një indikator që tregon që nuk kemi pasur progres, por kemi pasur rënie të aktivitetit ekonomik. Kur jemi të shpenzimet, duhet të tregojmë se Qeveria është kujdesur që të ketë rritje të shpenzimeve në disa kategori, ku përfiton vetëm një grup i caktuar i njerëzve që punon për Qeverinë dhe institucionet e saj. Për shkak të punësimeve të 900 personave, fondi i pagave është rritur me 5,3%, në krahasim me vitin 2011.

Në Ligjin e rishikuar të Buxhetit për vitin 2012, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë paraparë të jenë 204 000 000 euro, por në fakt janë shpenzuar vetëm 172 000 000 euro, apo 28 000 000 euro më pak. Me gjithë këto shkurtime për 28 000 000 euro, ne kemi pasur ngritje të këtyre kategorive të shpenzimeve. Janë rritur shpenzimet e udhëtimit për 27%, janë rritur shpenzimet e telekomunikimit për 12%, janë rritur shpenzimet kontraktuese për 19%, shpenzimet për mobile dhe pajisje për zyrë mbeten të njëjta nga viti në vit, thua se Qeveria çdo janar fillon nga zeroja dhe kjo është komplet e papranueshme. Kemi rritje të derivateve dhe lëndëve djegëse për 13%. Dhe jo transparenca qëndron në atë se kategoria e derivateve përfshin edhe derivatet për vetura dhe derivatet si lëndë djegëse, që në fakt nuk tregon se sa është shpenzuar për derivatet e veturave.

Si rezultat i keqmenaxhimit të ndërmarrjeve publike ato po vazhdojnë prapë të gllabërojnë një pjesë të buxhetit. Në buxhet ishin planifikuar që si subvencione ndërmarrjeve publike t'u jepen 52 000 000, mirëpo u janë dhënë vetëm 34 000 000.

Shpenzimet kapitale në buxhetin e rishikuar të Kosovës, të vitit 2012, kanë qenë 614 000 000. Janë shpenzuar vetëm 554 000 000 apo 60 000 000 më pak dhe ne në fakt nuk e dimë se cilat janë ato projekte që kanë pasur ngecje.

Qeveria nuk kursen fare kur është fjala te blerja e veturave të reja. Ky buxhet është rritur me mbi 100% nga 4,6 milionë, kemi një rritje në 9,4 milionë për blerje të veturave të reja në krahasim me një vit më herët.

Mandej, raporti i faturave të papaguara të organizatave buxhetore tregon se është mbyllur viti me rreth 40 000 000 fatura të papaguara. Ky është një mashtrim që u bëhet bizneseve dhe ndikon negativisht në aktivitetin e tyre biznesor, ndërkohë që neve borxhet na barten nga viti në vit.

Nëse merren parasysh këto obligime, 40 000 000 fatura të papaguara, shkurtim i investimeve kapitale në shumë prej 60 000 000, shkurtim në mallra dhe shërbime në shumën prej 28 000 000, ne e kemi përmbyllur vitin me një buxhet i cili është për 128 000 000 më pak se buxheti i aprovuar në këtë Kuvend për vitin 2012.

Është shumë interesante të ceket se çka ka ndodhur me të hyrat vetjake të komunave. Derisa ne përgatitemi për zgjedhjet lokale dhe të gjitha komunat e kanë parasysh këtë, u tha këtu edhe nga përfaqësuesja e Qeverisë dhe gjithashtu e partisë në pushtet, se kemi pasur një ngritje të të hyrave vetjake të komunave, mirëpo duhet të theksohet qartë se cilat komuna kanë pasur ngritje dhe cilat komuna nuk e kanë ngacmuar elektoratin e vet.

Ja, për shembull, çka ka ndodhur, Skenderaj ka realizuar të hyra 641 000 euro më pak se në vitin 2011, Vushtrria 83 000 euro më pak se vitin 2011, Mitrovica 290.000 euro më pak se vitin 2011, Rahoveci, 87 000 euro më pak se vitin 2011, Lipjani 459 000 euro më pak se vitin 2011, Shtime, më pak 75 000 000, si dhe Prizreni, 659 000 000 më pak se vitin 2011.

Janë disa komuna që e kanë ngritur performancën dhe pavarësisht se edhe tek ato komuna do të ketë zgjedhje lokale, ato kanë rritur të hyrat vetjake dhe këto janë: Prishtina, me 4,3 milionë, komuna e Suharekës, me 1.2 milionë, komuna e Fushë-Kosovës, me 213 000 euro, komuna e Graçanicës, me 264 000 euro, komuna e Drenasit, me 31 000 euro, komuna e Podujevës, me 93 000 euro më shumë se një vit më herët.

Ju lutem shumë, unë e di se përgjigjet do të sillen rreth Prishtinës. Unë kisha pasur vetëm një kërkesë që partia në pushtet, Qeveria me të gjitha ato departamente dhe qeverinë nën hije, të presin derisa të dalë raporti i auditorit të Prishtinës dhe raportet e auditorit të komunave tjera dhe mandej ne bisedojmë.

Është biseduar shumë gjithashtu edhe për suficitin buxhetor të Prishtinës dhe ne ju tregojmë sot se në të dhënat e fundit të gjitha mjetet buxhetore janë të zotuar. Të pa zotuar në Prishtinë janë vetëm 1,5 milion euro.

Në përfundim, ne konsiderojmë se buxheti i vitit 2012 ka qenë një buxhet i keq. Shpenzimi i këtyre mjeteve është bërë në mënyrë edhe më të keqe se sa planifikimi i tyre. Ky buxhet nuk ka reflektuar nevojat e qytetarëve, nuk ka adresuar sfidat për zhvillim ekonomik. Ky buxhet nuk është përpiluar, bazuar në strategji të qartë zhvillimore, prandaj edhe efektet ekonomike nga shpenzimi i tij janë zero.

U tha nga zëvendëskryeministrja Kusari se ky raport i buxhetit shpreh performancën e pakontestueshme të Qeverisë. Cila është performanca? Në këtë raport financiar të buxhetit të Kosovës, ne kemi edhe 1,4 milion te Natali Velijaj, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ne kemi qindra miliona të manipuluar të Ministrisë së Infrastrukturës, ne kemi edhe shumë miliona të keqpërdorur nga Ministria e Arsimit.

Të gjitha janë këto dhe na prezantohen nga Qeveria si para, si taksa të qytetarëve të Kosovës që janë shpenzuar për të mirën e tyre, por në fakt nuk janë shpenzuar për të mirën e tyre.

Ne jemi kundër sikurse që kemi qenë edhe kundër buxhetit të vitit 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, zonja Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket raportit vjetor të buxhetit për vitin 2012, edhe ne jemi kundër këtij miratimi të raportit të buxhetit për vitin 2012, për shkak se këtu u përmendën që kemi rritje të hyrave dhe gjithashtu u tha që janë zvogëluar të hyrat nga doganat dhe janë rritur të hyrat nga tatimi i brendshëm. Mirëpo duhet ta konstatojmë një gjë se kjo nuk mund të ndodhë dhe nuk mund të bëjmë një ndryshim radikal të këtyre të hyrave pa e pasur një zhvillim ekonomik, për shkak se të hyrat që mblidhen nga doganat, janë në një farë mënyre krejt çka po bëjmë ne është, të hyrat që po mblidhen nga Doganat krejt ato, domethënë janë të hyra që mblidhen nga Dogana, janë ato të hyra të cilat nuk sjellin zhvillim ekonomik për shkak se bëhet vetëm një qarkullim i parave nga brenda – jashtë, për shkak se të gjitha ato, domethënë në të njëjtën kohë ne kemi edhe shumë prodhime të mallrave të huaja, domethënë që i blejmë këtu dhe bëjmë një qarkullim të mallrave, dhe nuk kemi zhvillim ekonomik.

Dëshmi e fortë e kësaj është se të hyrat nga tatimi në korporata janë shumë të vogla për shkak se në vitin 2012, domethënë kemi të hyrat nga tatimi në korporata vetëm 62 681 000 euro, kjo i bie që një e hyrë kaq e vogël nga tatimi në korporata do të thotë se na prodhojmë shumë pak dhe nëse ne prodhojmë shumë pak, prodhimi shumë i vogël sjell shumë pak punësim, domethënë, sepse prodhimi është ai që sjell punësimin. Nëse ne kemi shumë pak prodhim, kjo i bie që ne kemi shumë pak punësim. Dëshmi e kësaj janë edhe të hyrat nga tatimi në të ardhura personale të cilat janë vetëm 60 089 000 euro.

Pra, kjo i bie që nëse shteti ka mbledhur kaq pak të hyra nga tatimi në korporata, atëherë ne si shtet prodhojmë shumë pak. Njëjtë, nëse kemi kaq pak të hyra nga tatimi në të ardhurat personale, i bie që si shtet ne kemi punësuar shumë pak qytetarë dhe papunësia çdo ditë e më shumë është në rritje.

Kur jemi tekshpenzimi, domethënë kemi rritje të shpenzimeve dhe ato shpenzime po i përmend vetëm disa për shkak se shumica veç mu përsëritën edhe dy-tri herë këtu, tek shpenzimet nga kategoria për mallra dhe shërbime kemi një rritje prej 8,2% si dhe nga kategoria e shpenzimeve kapitale kemi një rritje prej 4,2%, te kategoria për shërbime komunale kemi një rritje prej 5,8%.

Nëse ndalemi te kategoria e shpenzimeve kapitale, përkundër faktit që ka një rritje të shpenzimeve te kjo kategori, në këtë raport të buxhetit nuk kemi të detajizuara të gjitha shpenzimet në mënyrë të hollësishme se si kanë ndodhur. Domethënë e kemi një shifër në mënyrë të përgjithshme të shpenzimeve kapitale, por nuk e kemi në mënyrë të detajuar.

Është dashur që në këtë raport të buxhetit për vitin 2012 të kemi në mënyrë më të hollësishme të gjitha shpenzimet, sepse janë paratë e qytetarëve, janë paratë e taksapaguesve dhe të paktën ishte dashur që ky raport i buxheti të jetë më transparent dhe shpenzimet t'i kemi në mënyrë më të hollësishme në këtë raport të buxhetit.

Përfundimisht, e thashë edhe në fillim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta mbështetë këtë raport, e para për shkak të mënyrës se si po ndërtohet buxheti dhe e thamë që kjo nuk sjell zhvillim ekonomik dhe e kundërshtojmë, edhe për arsyen tjetër për shkak se nuk sjell informata të mjaftueshme për atë se si shpenzohen paratë e taksapaguesve dhe qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Neziraj e ka fjalën

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti anëtar i Kryesisë!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do të ndalem shumë shkurt në disa të dhëna, mirëpo të dhënat detale për të hyrat i ceku zëvendëskryeministrja, ndërsa për shpenzime shumë mirë i elaboroi deputetja e LDK-së, kështu që unë do të ndalem në disa pika tjera.

Unë besoj se Qeveria e Kosovës ka mund të bëjë më shumë që të harxhojë më pak në paga dhe mëditje, të harxhojë më pak për telekomunikim, të harxhojë më pak për mobile, të harxhojë më pak në përfaqësim, do të thotë në shpenzimet e reprezentacionit dhe të bëjë më shumë në investime kapitale, aty ku mund të përfitojë qytetari i Kosovës.

Unë shpresoj që të hyrat, ka rritje, është mirë që ka rritje, por shpresoj se ekonomia e Kosovës duhet t'i ketë të mbledhura të hyrat e brendshme, do të thotë nga Administrata Tatimore, më tepër se sa nga Doganat, për arsye se nëse synojmë Bashkimin Evropian, nëse synojmë në një ekonomi të hapur të tregut, shpresoj që të hyrat doganore duhen që të jenë në një numër sa më të vogël dhe të zvogëlohen dhe të rriten të hyrat nga tatimet.

Unë shpresoj një diçka që po na përcillet për çdo vite, janë edhe shpenzimet e mëdha të shumë agjencive për qira. Shpresoj se Qeveria e Kosovës duhet që ketë të menaxhojë më mirë dhe besoj që ka hapësirë të mjaftueshme që disa agjenci që kanë një qira bukur të

madhe të akomodohen diku tjetër me qëllim që ato para të qirasë të shfrytëzohen për diçka më pozitive, për investime që do të jenë më fitimprurëse për qytetarët e Kosovës.

Gjithashtu, një diçka që është shqetësuese, është se shumica e parave të buxhetit të Kosovës në një përqindje të madhe janë për paga dhe mëditje, edhe pse këto paga dhe mëditje janë më të voglat në rajon, ne nga buxheti i Kosovës përqindjen më të madhe e harxhojmë për paga e mëditje, që duhet në të ardhmen të mendojmë edhe për këto gjëra.

Unë shpresoj që këto para në vitin 2012 janë harxhuar, por shpresojmë që në 2013 të harxhohen më me nikoqirllëk dhe në ato vende ku mund të kursehet, duhet të kursehet, për arsye se Kosova ka nevojë për një zhvillim më të hovshëm ekonomik, se Kosova ka nevojë shumë më tepër për investime ekonomike, për arsye që të hapen vende të reja të punës dhe ato vende të reja të punës të sjellin të hyra më të mëdha buxhetore dhe sidomos në lëmin prodhuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012 dhe në fillim të miratimit të projektbuxhetit, Koalicioni për Kosovë të Re ka thënë se ky është buxhet i mundësive, nuk është buxhet që mund të presim diç më të madhe për arsye se dihet si janë të hyrat në dogana dhe të hyrat në Administratën Tatimore.

Në rast se i shohim pasqyrat e pranimit, të cilat janë bërë në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave, atëherë mund të themi se të hyrat në dogana janë në rritje dhe të hyrat në Administratën Tatimore janë të rritura, mirëpo prapëseprapë në rast se i shohim të hyrat në Administratën Tatimore, duhet të kemi kujdes se nuk janë këto të hyra reale që duhet të hyjnë, për arsye se Administrata Tatimore mund të ketë të hyra më të mëdha kur dimë mjaft mirë cilat biznese i kemi dhe jo të qesim në buxhetin e Kosovës të hyrat vetëm nga ato biznese të cilat mund të tatimohen.

Unë do të hyjë edhe në disa çështje tjera këtu, ku shihet plani buxhetor dhe i shohim të hyrat nga dogana, të hyrat nga Administrata Tatimore, të hyrat nga deidentat, mirëpo në përgjithësi mund të themi se këto të hyra prapëseprapë, të cilat janë derdhur në buxhet të Kosovës dhe të cilat janë shpenzuar, shpresoj që në Projektbuxhetin e vitit 2013 të ketë një planifikim tjetër dhe Kosova të ketë një rritje ekonomike tjetër, jo çfarë është kjo këtu njëherë përnjëherë, ndërsa te çështja e pagesave ku kemi pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, këtu kemi edhe rritje të shpenzimet komunale, të kemi një sugjerim, subvencione dhe transfere prapë ka rritje, shpenzimet kapitale dihet se i kemi dhënë në miratim.

Në përgjithësi mund të themi se pasqyrat janë dhënë ashtu siç janë dhënë dhe tregojnë gjendjen faktike çfarë është. Është një e mirë këtu që në këto pasqyra janë dhënë edhe të hyrat nga licenca. Unë besoj se ky raport është nxjerr mjaft mirë kur dihet se katër muaj

jemi pa ministrin e Financave, ku shihet se edhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka të hyra, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit ka të hyra nga licencat, Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve dhe shpresoj që ministri i cili do të emërohet tash do të jetë në gjendje që në Projektbuxhetin e 2013 të pasqyrojë në linjë buxhetore të hyrat nga licenca.

Në përgjithësi mund të themi se është pasqyruar një gjendje faktike çfarë është, mirëpo prapëseprapë duhet të kemi kujdes në çështjen e menaxhimit të parasë publike për arsye se nuk janë para tona dhe të bëjmë një planifikim më të mirëfilltë, mirëpo kur dihet se këto projekte vazhdojnë edhe nga qeverisja e mëparshme e cila ka qenë nga koalicioni i mëparshëm PDK – LDK, shpresojmë që projektet e 2013 do të jenë projekte të reja dhe në favor të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, zonja Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani članovi Vlade,

Koleginice i kolege,

Izveštaj budžeta za 2012 godinu najbolja je prilika da se sagleda da li se i kako sprovodi politika Vlade.

Gledajući strukturu budžetskih davanja, može se primetiti da su najveća davanja u oblasti na kojoj Vlada stavlja poseban akcenat razvoj i infrastrukture sa jedne strane i socijalna davanja sa druge strane.

Budžet Kosova je po svom karakteru razvojni, pre svega u infrastrukturnom smislu, uz neophodnost socijalne podrške građanima usled teških uslova života na Kosovu.

Realizacija budžeta pokazuje da je ovo opredeljenje Vlade i ostvareno. Ima puno podataka iz izveštaja budžeta za 2012. godinu na koje treba obratiti pažnju. Budžet je u najvećem delu realizovan prema usvojenim budžetskim linijama odnosno rebalansu koji je Skupština usvojila. Prihod od carina je stabilan u odnosu na prošlu godinu, sa blagom tendencijom rasta. Slična je i situacija sa poreskim prihodima.

Jasno je međutim da je povećanje ovih prihoda moguće jedino uz sistemsko smanjivanje sive zone poslovanja za šta postoje zakonski preduslovi.

Sopstveni prihodi opština se povećavaju i imaju višegodišnji trend rasta. Ovo se posebno odnosi na opštine sa Srpskom većinom čije dodatno uvećanje zahteva završetak procesa decentralizacije i preuzimanje dodatnih ovlašćenja.

Od ukupnog prihoda opština grad Priština učestvuje sa 39%, što pokazuje previsok stepen centralizacije privrede i stanovništva, što je protivno procesima ravnomernog regionalnog razvoja.

Poseban problem je visok nivo troškova javne administracije i njeno uvećanje koje je moguće rešiti samo sveobuhvatnom reformom.

Ukupan budžet Kosova od 1,5 milijardi evra, svakako je nedovoljan da pokrije sve potrebe kosovskog društva.

Učešće privrede od carine u iznosu od 55% pokazuje da je neophodno podići nivo privrede, pre svega stranim investicijama kako bi se pored efekta zapošljavanja povećao i nivo naplate poreza od velikih kompanija.

Samostalna liberalna stranka glasaće za ovaj izveštaj od 2012. godine o budžetu.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Gjatë shqyrtimit të buxhetit për vitin e kaluar fiskal kemi tërhequr vërejtjen për disa anomali dhe diskrepanca buxhetore të cilat tashmë janë pasqyruar edhe në këtë raport të shpenzimeve të Qeverisë.

Ne kemi theksuar se buxheti i vitit 2012 nuk do të jetë zhvillimor, do të shtypë biznesin dhe si i tillë do të mbyllë shpresën e qytetarëve të Kosovës.

Në këtë periudhë raportuese janë mbyllur diku 1.108 biznese, papunësia ka arritur shkallën 48%, zhvillimi ekonomik ka ngecur në 3,2%.

Nuk mund të presim diçka më të mirë kur nga buxheti i tërësishëm prej 41% janë kategori e pagave, mëditje, transfere e subvencione, kurse nga investimet kapitale, diku 60% e mjeteve financiare janë vetëm për një projekt, kur nga të hyrat e tërësishme buxhetore, 61,5% i takojnë të hyrave të jashtme, gjegjësisht doganave.

Krahasuar me raportet e tjera, ky raport financiar i buxhetit përveç se është punuar dobët, është mjaft i vështirë për t'u kuptuar nga ata që nuk janë profesionistë. Nuk pasqyron përputhje me të dhënat e paraqitura në Ligjin e buxhetit për vitin 2012 dhe si i tillë paraqet konfuzitet dhe është i pazbërthyes në shumë tregues buxhetor.

Po ashtu, raporti përmban një diskrepancë në mes buxhetit fillestar dhe atij të rishikuar dhe shtrohet pyetja se sa dhe si janë shpenzuar këto para publike në mënyrë ligjore apo jo?

Kjo politikë ekspansioniste e shpenzimeve të Qeverisë kanë mbulesa afatshkurtra të cilat financojnë deficitin buxhetor me huamarrje, përmes shitjes së pasurive dhe përkrahjes nga donatorët.

Ndonëse janë të paqëndrueshme për këtë Qeveri janë të domosdoshme, sepse të hyrat buxhetore në masën mbi 844 000 000 ose diku 70% janë të hyra kryesore si rezultat i varësisë ekonomike të Kosovës nga importet.

Pra, janë rezultat i një bilanci tejet negativ tregtar me një suficit prej 89.2% ose shprehur në vlerë absolute importet janë 2,5 miliardë në krahasim me 269,3 000 000 eksporte me një mbulueshmëri vetëm 10,8%.

Nga ky raport shohim se për kategorinë paga dhe mëditjet janë dhënë mbi 409 000 000 e 245 000 euro apo 27,9% e shpenzimeve buxhetore, që është 8,71% e bruto produktit vendor.

Vlen të theksohen po ashtu 4 806 pozita pune të perealizuara, por të parapara me buxhet, prej të cilave 1 749 pozita pune në nivelin qendror dhe 3 057 në nivelin lokal.

Pa të gjitha këto mosrealizime ose pozita të dështuara, mbi 109 mijë e 491 persona kanë marrë pagë prej Buxhetit të Kosovës në një vlerë mesatare prej 311 047 euro në muaj.

Duke pasur parasysh ngritjen e çmimeve të konsumit të rritur mesatarisht 9,2%, vlera nominale e pagës është zvogëluar për aq. Pra, inflacioni për vitin 2012 ishte 2,5%. Në bazë të analizave për kategorinë mallra dhe shërbime janë paguar mbi 172 000 000 euro. Qeveria ka shpenzuar më shumë mjete se sa vitin paraprak për 6,71%, përkundër deklarimit se do t'i ulin shpenzimet në këtë kategori.

Më detajisht, po ashtu vërejmë se mjetet për udhëtimet zyrtare kapin shumën prej 10 450 000 euro ose më shumë se 2,5 milionë nga viti paraprak. Për dreka dhe darka janë shpenzuar mbi 3 milionë e 321 000 euro apo 1 milionë euro më tepër se sa vitin paraprak. Po ashtu, për qira janë shpenzuar 6 891 000 euro, krahas premtimit se do të ulen shpenzimet, duke bërë akomodimin e institucioneve në objekte publike.

Po ashtu janë të theksuara shpenzimet për telefona në një shumë mbi 4 484 000 euro përkundër edhe vetë rënies së çmimeve në një mënyrë telefonike.

Vlerësojmë në tërësi se shpenzimet e Qeverisë po ashtu në aspektin e mbrojtjes sociale janë modeste, duke përfshirë pensionet bazë, pensione për persona me aftësi të kufizuara, pensionet e TMK-së, punëtorëve e “Trepçës” dhe pagesat tjera për kategori të dala nga lufta.

Të gjitha këto destinime janë dukshëm nën shpenzimet e vendeve të rajonit. Tek ne janë vetëm 13,41% të shpenzimeve të përgjithshme ose 4,18% e bruto produktit vendor.

Duke u bazuar edhe në këto të dhëna, kërkesa e vazhdueshme e LDK-së mbetet që këto kategori që i përmenda të marrin pagesa dhe të jenë kategori buxhetore duke iu mundësuar një trajtim më të merituar dhe të dinjitetshëm.

Po ashtu, edhe më lart e thashë se vetëm për një projekt kapital mbi 60% të mjeteve për investime kapitale parashihen. Është fjala për autostradën, i cili po realizohet dhe kap shumën prej 980 000 000 eurove. Pritshmëria është se do të ketë tejkalim për shkak të shpronësimit të manipuluar në skajshmëri nga një projeksion fillestare prej 50 000 000 eurove.

Tani shpronësimi ka arritur shumën 180 000 000 euro dhe fatkeqësisht nuk ka transparencë të shpenzimeve për këto shpronësime, për shkaqe të pengesave, sigurisht subjektive të atyre që dëshirojnë këto t'i mbajnë të fshehura.

Po ashtu, dyfishimi i shumës për blerjen e veturave për nevoja të Administratës Publike, nga 4 641 000 eurove sa është shpenzuar në vitin 2011, në 9 433 000 euro në vitin 2012, është një rritje prej 49,2%.

Përkundër premtimit se nuk do t'u jepen para ndërmarrjeve publike, Qeveria prapëseprapë vazhdon t'i subvencionojë në investime kapitale dhe në këtë mënyrë vazhdon të keqmenaxhojë me paranë publike.

Duke mos dashur të bëj vlerësime të ndara të ministrive për projektet e planifikuara, por të parealizuara, ka disa ministri ose nga ministrinë të cilat kanë tejkaluar buxhetin, por kjo punë le të mbetet detyrë e auditorit gjeneral.

Po përsëris edhe diçka, shumë shkurt, rreth të hyrave vetjake, që i tha disa të dhëna edhe zonja Bajrami.

Komunat që kanë pasur rënie krahasuar me vitin paraprak, po i them vetëm në përqindje, janë: Lipjani minus 29%; Shtimje, minus 21%; Dragash, minus 7, Prizren minus 13; Rahovec, minus 8, Deçan, minus 19, Istog, minus 5.4; Mitrovicë, minus 15; Skenderaj, minus 52%; Vushtri, minus 6; Gjilan, minus 9; Kaçanik, minus 16; Kamenicë, minus 7%; Ferizaj minus 7; Viti, minus 14 dhe Hani i Elezit, minus 23.76.

Ndërsa rritje impulsive të hyrave vetjake ka komuna e Prishtinës me një rritje prej 23.13% krahasuar me vitin paraprak, duke realizuar kështu të hyra 40% të gjitha të hyrave vetjake të komunave të Kosovës. Pra, pesë herë më shumë se Prizreni apo 23% më shumë se Prizreni, Gjakova, Peja, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaj së bashku. Po ashtu, më lejoni të them se vetëm shuma prej 1 milion e 408 mijë euro është shumë e tejkaluar nga ajo që i ka paraparë për të hyrat vetjake, gjegjësisht të planifikuara dhe vetëm 1 milion e 900 000 janë mjete të pa kontraktuara që janë vetëm 3% e buxhetit komunal.

Këto të dhëna i thashë nga fakti se ka pasur përpjekje për të manipuluar dhe për të sulmuar komunën e Prishtinës, dhe edhe një herë po e përsëris, jo vetëm për Prishtinën, por konsiderojmë për çdo komunë dhe ministri më mirë është të ruhen paratë se sa të keqpërdoren procedurat dhe të shkelen procedurat. Dhe ne jemi të bindur nga fakti se vetëm vitin 2012, komuna e Prishtinës i ka pasur mbi 21 326 789 euro të hyra vetjake, tregon se sa ka qenë efikase në inkasimin e të hyrave vetjake komuna dhe këto mjete, për njohuri edhe të qytetarëve, ruhen edhe nëse nuk shpenzohen, ndërkaq, të gjitha mjetet tjera të granteve qeveritare edhe jonë të zotuar edhe janë të realizuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, nënkryetar, zoti Haliti!

Meqenëse shumë detale dhe shumë shifra u dhanë këtu nga deputetët tjerë, unë për hir të kohës dhe respektin e deputetëve që të mos ua marrë kohën, me të njëjtat të dhëna t'i përsëris, unë do ta dorëzoj me shkrim fjalimin tim. Faleminderit!

Diskutimi i dorëzuar me shkrim

I nderuar nënkryetar zoti Haliti!

I nderuar kryeministër e ministra,

Të nderuar deputetë,

Nëse vërehet në vija të përgjithshme, duket se buxheti i Kosovës për vitin 2012 ka shkuar mirë, meqenëse del që ka pasur mjaft para për financimin e nevojave të shtetit, kurse në fund kanë mbetur 278 000 000 euro ose 75 000 000 euro më shumë se në vitin 2011.

Mirëpo, këto shifra mashtrojnë, meqenëse në brendi tabelat buxhetore fshehin rreziqet me të cilat përballet buxheti, të cilat kanë mundësi që në të ardhmen të shpërthejnë me krizë.

1. Të hyrat e përgjithshme në buxhet janë 1,5 miliardë euro, ndërsa të dalat - pagesat 1,4 miliard euro. Do të thotë se bilanci primar mbetet në suficit për 100 000 000 euro. Madje, ky bilanc është dukshëm më i mirë se në vitin 2011.
2. Mirëpo, kur kemi parasysh vetëm këtë mbetje, ajo nuk është e mjaftueshme për stabilitet buxhetor. Pra, për të krijuar këtë stabilitet, përkatësisht për të arritur shumën e parasë në fund të vitit, Qeveria e Kosovës është dashur të futet në borxhe nga brenda ashtu edhe nga jashtë ajo ka marrë hua afër 167 000 000 euro dhe kjo ka ndikuar në mënyrë direkte për rritjen e rezervës buxhetore.
3. Hyrja në borxh po shkon me një shpejtësi shumë të madhe dhe nëse vazhdon kështu ka rrezik që një ditë borxhi i përgjithshëm të rrezikojë jo vetëm qëndrueshmërinë e buxhetit, por edhe të gjitha zhvillimet e tjera në vend. Për krahasim po përmend se në vitin 2011 janë marrë hua vetëm 5 000 000 euro, ndërsa në vitin 2010 - 22 milionë euro.
4. Nga e tërë kjo del qartë se burimet reale për financimin e buxhetit të vendit- është fjala për tatimet dhe taksat në kufi dhe ato brenda, nuk janë të mjaftueshme për të ruajtur stabilitetin buxhetor, prandaj kjo është krijuar duke hyrë në borxhe, të cilat duhet të kthehen me kamatë. Ndërkaq, në të ardhmen kjo mund të reflektojë keq për stabilitetin, pa marrë parasysh se ligji i mundëson Qeverisë të hyjë në borxh deri në 40% të GDP-së.

Kur është fjala për hyrjet në buxhet atëherë këtu mbeten rezervat për kapacitetin, përkatësisht efikasitetin e Doganës së Kosovës dhe të Administratës Tatimore të Kosovës.

Dogana vjet ka vjel 844 000 000 euro ose 2% më shumë se një vit më parë. Del se rritja është gati e barabartë me shkallën e rritjes së përgjithshme ekonomike të vendit. Ndërkaq, të hyrat nga tatimet e brendshme janë rritur më shumë se 8%.

Mirëpo, kjo tregon për rritjen e efikasitetit të tyre, por më shumë për një punë rutinore - përkatësisht taksat dhe tatimet janë ngarkuar mbi mallrat që janë paraqitur në vendkalimet kufitare apo nga bizneset, që edhe në të kaluarën kanë qenë korrekte në pagesa. Do të thotë se nuk është bërë asnjë përpjekje drejt zvogëlimit të informalitetit, përkatësisht të kontrabandës. Ndërkaq, sipas disa studimeve, ajo është mjaft e lartë dhe kap gjati 40% të GDP-së.

Pra, në këtë aspekt ka dështuar Dogana dhe Administrata Tatimore. Ato nuk kanë bërë ndonjë punë të madhe në përpjekjet për të mbyllur burimet e informalitetit dhe të kontrabandës.

Njëkohësisht sipas tabelave të prezantuara vërehet se paraja publike ende shpenzohet e pa dhimb je, përkatësisht pa nikoqirllëk. Po përmend vetëm disa kategori të shpenzimeve:

1. Për shpenzime të udhëtimit janë 25% më të larta se para një viti.
2. Shërbimet e kontraktuara u rritën 20%, ndërkaq, këtu kemi të bëjmë kryesisht me kontratat për arsimim dhe për trajnime. Unë e kuptoj se njerëzit duhet të aftësohen dhe të trajnohen në përputhje me kërkesat e reja, por Qeveria, përkatësisht agjencitë qeveritare duhet të jenë më të kujdesshme që me rastin e rekrutimit të stafit të gjejnë profile të afta për punën që u besohet e jo që aftësimi i tyre të nisë në momentin kur krijohet marrëdhënia e punë, apo që ministrat me parat e buxhetit mos t'i paguajnë kurset për gjuhë të huaja, por këtë ta bëjnë nga paratë e veta.
3. Për derivate dhe lëndë djegëse janë shpenzuar 26 000 000 euro ose 3 000 000 euro më shumë. Nëse kemi parasysh çmimin mesatar të derivateve, del se janë shpenzuar 3 000 000 litra më shumë. Kjo është tepër dhe ndodh vetëm për shkak të mungesës së kontrollit për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve. Se këtu nuk ka kontroll fare, tregojnë disa raste kur veturat e agjencive qeveritare janë sulmuar nëpër parkingje të ndryshme të qyteteve të Kosovës. Do të thotë se në këtë segment nuk ka fare kontroll. Unë nuk them se nëse kursejmë 3 000 000 euro do të bënim mrekulli, por Qeveria para tatimpaguesve duhet të jetë më e përgjegjshme dhe të dëshmojë përgjegjësi për mënyrën se si e shpenzon paranë që ata ia besojnë.

Kur kemi të bëjmë me të hyrat vetjake të komunave, duhet të bëjmë një dallim. Është e vërtetë se ato janë rritur rreth 7,3%, mirëpo në këto zhvillime kryesisht ka ndikuar komuna e Prishtinës, e cila ka arkëtuar mbi 23 000 000 euro apo 27% më shumë se para një viti. Po ashtu, kjo komunë në totalin e të hyrave që kanë realizuar 38 komuna, merr pjesë me gati 40%.

Nga ana tjetër kemi komuna që kanë dështuar tërësisht në vjeljen e të hyrave për të cilat kanë përgjegjësi. Ta zëmë Prizreni ka arkëtuar 13% më pak se në vitin 2011, Skenderaj 53%, Ferizaj 8%, Gjilani 10%, etj. Pra, kanë dështuar komunat që janë më të favorizuara

për financim. Ato duke u mbështetur në këto favore që kanë nga buxheti qendror, nuk kanë pasur pse të brengosen për shumën e të hyrave që vet i realizojnë.

Unë insistoј që edhe ato duhet të vjelin sa edhe komuna e Prishtinës, por aq sa kanë kapacitet, së paku që ato të jenë më të larta se një vit më parë, apo në përputhje me planet që vetë komunat i kanë miratuar. Faleminderit!

Hashim Deshishku, d.v.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur nga grupet parlamentare. Nga Qeveria fjalën e ka kërkuar zoti Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit !

I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë, të gjithëve ju falënderoj për kontributin tuaj që e keni dhënë sot në diskutimin lidhur me raportin. Raporti për shpenzimet e vitit 2012 është raport i cili përputhet me harmoni të plotë me Projektbuxhetin e vitit 2012, është një buxhet i cili ka siguruar stabilitet makro-fiskal, është një buxhet i cili ka mundësuar që diku rreth mbi 38% të investimeve kapitale dhe janë realizuar të gjitha investimet kapitale të cilat kanë qenë të parapara, ka rezultuar me rritje të pagave, me rritje buxhetore. U pa që rritja buxhetore është në shifra të pranueshme dhe besoj se ky do të ishte një lajm jashtëzakonisht i mirë, por kur ka rritje të hyrave sigurisht se duhet të ketë edhe rritje të shpenzimeve, sepse kështu funksionon buxheti, pra shteti nuk është organizatë profitabile, por është organizatë e cila duhet mjetet të cilat i mbledhë t'i shfrytëzojë në mënyrën më të mirë të mundshme për qytetarët e saj.

Unë e kuptoj edhe ndjenjën dhe dëshirën e njerëzve për të kursyer, por duhet të kuptojmë edhe atë se taksa e cila merret nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe nuk shpenzohet është humbje, sepse hiqet një pjesë e tyre nga fuqia e tyre investuese në të ardhmen.

Prandaj, në këtë kontekst, besoj se këto rritje buxhetore kanë qenë të realizuara në mënyrë jashtëzakonisht profesionale. Buxheti është realizuar në masë mbi 98%, respektivisht shpenzimet, që kemi raste të rralla të shpenzimeve të tilla, dhe qëndrueshmëria e këtij buxheti është se në asnjë moment nuk ka pasur nevojë për rishikime buxhetore, për shkurtime sikur që ka ndodhur nëpër të gjitha vendet tjera të rajonit.

Pra, është një buxhet i cili u ka siguruar paga të gjithë punonjësve publikë, ka siguruar rritje ekonomike, ka siguruar investime kapitale dhe në këtë kontekst u përmendën këtu edhe subvencionimet, subvencionimet janë dukshëm më të vogla sepse po tregohet që politikat ekonomike të Qeverisë, respektivisht edhe disiplina buxhetore e cila është venë, kanë qenë elemente jashtëzakonisht të rëndësishme.

Dua ta theksoj edhe një çështje të rëndësishme këtu, e ajo është që nga raporti i Bankës Botërore dhe institucioneve tjera financiare ndërkombëtare, Republika e Kosovës është marrë si model për disiplinën fiskale dhe për stabilitetin makro-fiskal duke marrë parasysh krahasimet me të gjitha vendet e rajonit çfarë ka ndodhur.

Prandaj, unë i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë këtë raport dhe të vazhdojmë do të thotë me procedurat tjera si janë të parapara. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se gospodine predsjedniče!

Uvaženi premijeru, zamenice premijera, uvaženi ministri,

Poštovani narodni poslanici,

Dozvolite mi da u par reči dam doprinos na ovu temu, pre svega vezane za Ministarstvo administracije i lokalne samouprave.

Naime, ukupan budžet Ministarstva administracije i lokalne samouprave za 2012. godinu bio je 6 miliona i 740.000 evra.

Od ovog iznosa potrošena su sredstva u iznosu od 5 miliona 749.000 evra ili 85,30% budžeta.

Dalje, daću vam opis prema ekonomskim kategorijama. Dakle plate i dnevnice kao prva kategorija planirani budžeta u ekonomskoj kategoriji plata i dnevnica bio je 779 549 evra. Troškova od ekonomske kategorije tokom 2012. godine je potrošeno 696.534 evra ili 89,41% budžeta.

Obrazloženje: Troškovi na ovom nivou su kao rezultat zaključka rada opštinskog pripremnog tima kao i osnivanje administrativne kancelarije severne Mitrovice tako da je za administrativnu kancelariju severna Mitrovica u drugom šestomesečju izdvojeno je poseban budžet od strane Ministarstva financije.

Poštovani narodni poslanici,

Robe i usluge, planiran je budžet u ekonomskoj kategoriji roba i usluga bio je 702 000 390 evra. Troškovi iz ove ekonomske kategorije za 2012. godinu je potrošeno je 605 800 evra ili 86,25% budžeta.

Obrazloženje: Kategorija roba i usluga, potrošene na ovom nivou sa razlogom selekcije alokacije odnosno odvajanja, na osnovu odluke Vlade za budžetske uštede za ove kategorije.

Opštinski troškovi. Planiran je budžet u ekonomskoj kategoriji opštinski troškova bio je 39 000 evra. Potrošnje iz ove kategorije - ekonomske kategorije za 2012. godinu potrošeno je 23 401 evra, ili 60% budžeta za kategoriju opštinskih troškova.

Obrazložanje s tim da je planiranje izvršeno i za isplatu opštinskih usluga pripremnog opštinskog tima severne Mitrovice i nakon drugog šestomesečja osnivanje administrativne kancelarije za severnu Mitrovicu, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je oslobođen ovih obaveza, tako da iz ovih razloga troškovi su na ovom nivou.

Poštovani narodni poslanici,

Subvencije i transferi. Planiranje budžet u kategoriji subvencije i transferi bio je 489 249 evra. Potrošnje iz ove ekonomske kategorije za 2012. godinu potrošeno je 390 063 evra ili 80,05% budžeta koji je bio lociran za ovu kategoriju subvencija i transfera.

Obrazložanje sa ciljem transparentnosti ovog fonda, njegovo lansiranje imalo je sveobuhvatni pristup, posebno na severnom delu Mitrovice za realizaciju raznih projekata koje se tiču integrisanih građana u kosovsko društvo, kao i osnivanje administrativne kancelarije za severnu Mitrovicu, nekoliko od ovih projekata predloženo je od strane Administrativne kancelarije za severnu Mitrovicu.

Poštovani narodni poslanici,

Ako želite da čujete dalje, kapitalni troškovi, dakle planiranje budžeta u ekonomskoj kategoriji kapitalnih troškova bilo je 4 732 177 evra.

Potrošnje iz ove ekonomske kategorije u toku 2012. godine potrošeno je 4 miliona 33 000 evra ili 85,23% budžeta koji je opredeljen za ovu kategoriju.

Obrazložanje: Kapitalne investicije Ministarstva administracije lokalne samouprave realizuju se u saradnji sa opštinama tako da su procedure početkom godine uzeli dosta vremena i procedure nabavke su uticale na nekoliko projekata da nisu izvršeni do kraja godine, tako da su preneti u 2013. godini.

Poštovani narodni poslanici,

Poštovani narodni poslanici Poslaničke grupe LDK-a,

Rezerve. Početni budžet u kategoriji rezervi, bio je 595 832 evra. Sredstva iz ove kategorije odvojene su u programu kategorije potrošnje za nove opštine. Na osnovu ovog opisa u ekonomskoj kategoriji roba i usluga odvojeno je 376 332 evra. U kategoriji opštinskih troškova 9 miliona evra. U kategoriji subvencija i transfera odvojeno je 70 000 evra, i u kategoriji kapitalnih investicija odvojeno je 140 500 evra. Zahvaljujem se na pažnji.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, nuk ka më të lajmëruar për diskutim. Kalojmë në procedurën e votimit.

Të pranishëm janë 59 deputetë.

(Ndërprerje e incizimit)

Tani janë 61 deputetë dhe po votojmë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 33 vota për, 24 kundër dhe 1 abstenim, miratohet rekomandimi i Komisionit funksional.

Tash e kemi pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, për arsyetim të raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.4.2013 e shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2012 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe ka vendosur që të paraqesë rekomandim për miratim të raportit vjetor të punës për vitin 2012 të këtij Komisioni.

Dëshiroj t'ju njoftoj po ashtu se ky komision tani më ka bërë një traditë për ta sjellë një kualitet shumë të mirë të raportit të punës. Komisioni në debatin e vet e ka shqyrtuar, ka kërkuar edhe informacione shtesë për disa prej çështjeve që deputetë të ndryshëm kanë kërkuar si arsyetim që nuk janë në raportin bazik, ju tanimë e keni një pjesë shtesë të informacioneve të Komisionit. Unë dëshiroj ta falënderoj po ashtu Komisionin për korrektësinë që i është përgjigjur kërkesës së deputetëve që të sjellë informacione shtesë nga ato që i kanë sjellë në raportin zyrtar, e të cilat sot i keni para jush.

Pra, ne e miratojmë dhe kërkojmë nga grupet parlamentare që të miratojnë këtë raport të këtij institucioni. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e deputetëve. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Rregullatorët e pavarur kanë obligim ligjor që një herë në vit t'ia paraqesin raportin e punës Kuvendit të Kosovës.

Kështu dhe në këtë mënyrë, në përputhje me Ligjin për minierat dhe mineralet, sipas nenit 58 të këtij ligji, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ia ka dorëzuar raportin vjetor Kuvendit edhe këtë vit.

Dihet se resurset minerale janë shtyllë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe fatbardhësisht Kosova është mjaft e pasur me këto resurse, kështu që institucionet përkatëse janë përgjegjëse për planifikim, menaxhim dhe zhvillim të këtij sektori.

Ky raport pune përmban aktivitetet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në fushën e gjeologjisë, hulumtimit të xehetarisë, përkatësisht shfrytëzimit, përpunimit. Njëkohësisht përmban edhe rezultatet e arritura gjatë një viti, mandej paraqet problemet me të cilat është ballafaquar ky institucion si dhe objektivat për të ardhmen.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi analizuar me vëmendje dhe jemi të vetëdijshëm se ky Rregullator i Pavarur e ka barrën kryesore në fushën e pasurive minerale si në hulumtim, në shpenzim e tjera, andaj mendoj se si Kuvend që jemi, e të cilit i përgjigjet ky Rregullator, mendoj se nuk është e mjaftueshme vetëm një herë në vit të bëjmë analiza dhe bilance përmes leximit të raporteve të punës, por ndërkohë edhe t'i shohim për së afërmi punën, por edhe vështirësitë me të cilat përballen agjencitë e pavarura.

Të nderuar deputetë,

Në këtë raport, faqe 7, thuhet se në fushën e hulumtimit ka interesim të madh, sidomos për mineralet metalike energjetike, kurse për mineralet industriale dhe ato ndërtimore ka më pak interesim.

Ky vlerësim bëhet duke u bazuar në interesimin dhe kërkesat që i bëjnë kompanitë e huaja, përkatësisht interesimi i investimeve të huaja.

Ndërsa sa i përket interesimit për shfrytëzim thuhet se dominon interesimi për shfrytëzimin e mineraleve që karakterizohen si minerale ndërtimore, siç janë gëlqeroret, rërat, zhavorret e tjera.

Edhe pse ky Rregullator ka lëshuar licenca për shfrytëzim të mineraleve metalike dhe industriale, pritjet nuk janë të kënaqshme.

Sa i përket sektorit të përpunimit edhe në këtë vit, siç thuhet në raport, vazhdojnë të njëjtat probleme, kështu që Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale, mendon se duhet ndërruar qasja tek operatorët të cilët marrin licencat e tilla, mirëpo KPMM nuk jep alternativa, zgjidhje se çka dhe si duhet ndërruar qasja e tyre.

Në raport përmendet se ka pasur angazhim maksimal në ndaljen e operimeve ilegale. Shpresojmë se hyrja në fuqi e Ligjit të ri për miniera dhe minerale, i cili para pak ditësh

është miratuar nga Kuvendi, do t'ia lehtësojë punën dhe do ta zvogëlojë këtë problematikë me të cilën përballlet tash e sa vjet kjo agjenci.

Në faqen 20 të këtij raporti thuhet se janë realizuar dy projekte, siç janë përpilimi i planshetave të hartës gjeologjike të Kosovës, me shkallë 1: 25.000 për rajonin e Drenasit. Ky projekt, kërkim-vlerësim parësor në themel të tij ka hartografimin e rajonit të marrë në studim me të gjitha komponentët e nevojshëm.

Rezultatet e këtij studimi do të ngrejë në nivel më të lartë njohuritë gjeologjike për këtë rajon, kapacitetet prodhuese, zhvillimin e integruar të popullsisë dhe rritjen e nivelit ekonomik të saj.

Përgjithësisht, hartografime gjeologjike në shkallë 1:25 000 do të jenë bazë e shëndoshë për menaxhimin më të mirë të territoreve. Ato do të jenë bazë për ndërtimin e hartave gjeomjedisore, hidrogeologjike, gjeologjinxhinierike, agrogjeologjike e tjera. Mirëpo, kjo duhet të jetë kompetencë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik tani e tutje, që do të dalë edhe si rekomandim në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Tek faqja 22, ku kemi planin e menaxhimit të resurseve thuhet se nuk është realizuar tërësisht ky plan, meqë sipas ligjit kjo kompetencë është dashur t'i dorëzohet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Institutit të Gjeologjisë së Kosovës.

Në faqe 22, flitet për Laboratorin e Gjeologjisë, që edhe ky është njëri ndër sferat të cilat duhet t'i takojnë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Faqe 25, kemi aplikacionet e kompanive për aktivitetet minerare të ndryshme, sa janë në hulumtim, sa janë në vazhdim dhe sa kanë bërë kërkesa fillestare.

Te faqja 48, te Departamenti Ligjor, të cilin vlen ta përmend sot këtu, thuhet se ky Departament është marrë me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit afër lumenjve.

Për shkak të mospërmbushjes së kushteve të licencës, në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale, gjatë vitit 2012 janë anuluar gjithsej 13 licenca, mirëpo prapë nuk thuhet se sa kanë mbetur pa u anuluar, edhe pse ne e dimë që kanë vështirësi në anulimin e këtyre licencave, sepse duhen përkrahje gjithëinstitucionale jo vetëm t'i mbetet barrë vetëm këtij komisioni.

Faqe 55, i kemi problemet që janë paraqitur në këtë raport në sektorin minerar, vështirësitë siç janë shfrytëzimet ilegale dhe mosrespektimi i standardeve ambientale, mosrespektimi i procedurave të licencimit nga aplikuesi. Përmendet një ndër problemet, si koordinimi ndërinstitutional që me theks të posaçëm e paraqesin problemin që shqetëson shumë është mosefikasiteti i kallëzimeve penale të ngritura nga ky Rregullator për operuesit ilegalë. Mandej, vështirësitë financiare, mosrealizimi i buxhetit të planifikuar.

Tek vështirësitë operative do të ndalem vetëm te njëra nga vështirësitë e që ka të bëjë, mungesa e objektit të përhershëm për zyrë, që tash e sa kohë ky institucion punon, funksionon në një objekt privat, i cili është edhe ilegal, nuk është i legalizuar dhe ka shpenzime të mëdha, paraqitet se gjatë këtij viti janë rritur shpenzimet për kontratën për qira.

Në këtë raport kemi edhe synime për të ardhmen, siç është rritja e koordinimit ndërinstitutional, ndalimi i operimeve ilegale, përafrimi dhe harmonizimi i standardeve teknike me ato evropiane, rritja e inkasimit të hyrave nga renta minerare dhe zvogëlimi i llogarive të arktueshme, ngritja e nivelit të shërbimit për palët e treta e kështu me radhë.

Dihet se ri ngritja dhe zhvillimi i industrisë minerale për rivënien dhe vënien në efikasitet të këtyre resurseve minerale do të rrisë edhe gamën e industrisë përpunuese për krijim frontesh punësimi dhe sigurim të ardhura për ekonominë e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë e dimë se Kosova ka resurse të rëndësishme dhe cilësore, si ato të linjtit, të metaleve me ngjyrë e minerale tjera, e në qoftë se do bëhej aktivizimi i këtyre resurseve me finalizim të prodhimit të gatshëm për shitje jashtë vendit, sigurisht se kjo do të ndikonte dukshëm në zbutjen e rebalancit import - eksport, krijimin e disa mijëra vendeve të reja pune dhe do të ndryshonte pozicionin ekonomik dhe politik të vendit.

Kjo është edhe njëra ndër sfidat e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale e paraqitur në këtë raport në faqe 7.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e miratojmë këtë raport dhe rekomandojmë se duhet përgjigjur kërkesës ligjore sa i përket bartjes së kompetencave në fushën e gjeologjisë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Instituti Gjeologjik i Kosovës.

Mandej, mendojmë se duhet të funksionalizur Instituti Gjeologjik i Kosovës që tash e sa kohë funksionon pa kryeshef, sa më parë të ndahen kompetencat në mes të Rregullatorit dhe ekzekutivit në sferën e gjeologjisë, të zbatohet Ligji për miniera dhe minerale që tani ka hyrë në fuqi nga ana e KPMM-së e cila i obligon që shpejti të barten kompetencat nga KPMM-ja në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar raportin. Shqetësimet tona që kanë të bëjnë lidhur me këtë fushë janë shqyrtuar edhe në Komisionin funksional. Dy shqetësimet kryesore kanë qenë ajo që ka të bëjë me licencat që i përmendi edhe kolegja Sala Berisha, por që në realitet nga sqarimet që janë marrë nga anëtarët e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, del se nuk është problemi te to, por shumica e

problemeve qëndrojnë te legjislacioni në ministri tjera, posaçërisht në Ministrinë e Ambientit.

Sa i përket çështjeve financiare mbeten të pasqaruar çështja e mosinkasimit të taksave administrative për shkak se sipas parimit një shërbim i një institucioni publik kryhet pasi të paguhet taksa se është e pakuptueshme që të mbeten taksat administrative të painkasuara.

Në parim edhe Lidhja Demokratike e përkrah raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes” e ka fjalën deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar,

Raporti i Komisionit për Miniera e Minerale për vitin 2012 është një material mjaft voluminoz, pra është i përbërë nga gjithsej 124 faqe, i cili ta krijon përshtypjen fillimisht se ka shumë të dhëna dhe tregues grafikë lidhur me veprimtarinë e KPMM-s, por duhet thënë se shumica e treguesve në material janë të parëndësishëm për vlerësimin e punës dhe janë dhënë si duket vetëm për të krijuar përshtypje vizuale.

Pra, është e vërtetë që pas vërejtjeve të deputetëve në Komision, vërejtje këto të përsëritura edhe nga viti i kaluar, KPMM-ja e ka dërguar një material shtesë me informata shtesë për atë se çfarë janë kërkuar, por jo për të gjitha ato që janë diskutuar në Komisionin funksional që e trajton këtë fushë.

Pra, në raport nuk janë dhënë pasqyrat e performancës financiare, por vetëm disa tregues të afarizmit. Në të dhënat tabelare mungojnë të dhënat nga viti paraprak, janë dhënë të dhënat vetëm në raport me planin, e kjo nuk është e mjaftueshme për ta bërë një analizë korrekte për çështjen.

Në pjesën tekstuale insistohet në mungesën e mjeteve për realizimin e projekteve kapitale, kurse në vitin e raportuar mjetet për projekte kapitale sipas buxhetit të reviduar realizohen me vetëm 60,74% e në krahasim me mjetet e lejuara në fillim me buxhet, pra 550 000 euro, me vetëm 42%. Pra nuk qëndron ky arsyetimi se nuk kemi pasur mjete për projekte kapitale për shkak se mjetet për projekte kapitale janë ato që i kanë tepruar Komisionit për vitin 2012.

Në faqen 51, pastaj flitet për suksesin e madh në zvogëlimin e shpenzimeve të telefonisë në realizimin e projektit VOIP. Pyetja e parë është se për çka janë shpenzuar 25 000, përkundër mbështetjes së kompanisë amerikane, pra për telefoninë.

Në material pohohet se shpenzimet telefonike janë zvogëluar nga 1.200 euro në muaj në 550 sosh për muaj, në tabelën 23, pastaj shpenzimet e telefonisë fikse janë 15 mijë e 22 euro, ose 1 251 euro për muaj.

Në tabelën 22 pika 6, shpenzimet e telefonisë mobile “Vala” janë 20.550 euro ose 1 712 euro për muaj.

Prej kësaj del se në vitin 2012 për telefoni janë shpenzuar 35 572 euro, ose 2964 euro në muaj, pra nuk ka reduktim, por rritje të shpenzimeve për telefoni.

Po ashtu, ka edhe disa gabime dhe lëshime logjike për sa i përket raportit. Për shembull te inkasimi për vitin 2011, veçanërisht te rentat, ku prapë duhet të them që edhe me dorëzimin e materialit shtesë nuk ka informata të mjaftueshme për rentat. Pra, dihet që nga raportet tjera që për 4 vjet, prej vitit 2007 deri në vitin 2010 janë inkasuar vetëm 258 979 euro në emër të rentës minerare, në vitin 2008 janë nxjerr ose shfrytëzuar 677 426,20 tonë xehe të feronikelit për atë vit për tërë Kosovën, ndërsa janë inkasuar në emër të rentës minerare 13 303 euro. Pra, këtu është një pikëpyetje e madhe të asaj se si janë llogaritur rentat minerare dhe deri në çmasë janë llogaritur rentat minerare dhe si janë kalkuluar ato.

Në raport po ashtu nuk ka të dhëna dhe shpjegime për shpërputhje të mëdha në realizimin e parametrave të planifikuara në tabelën 10, faqe 27 ka dyshime të bazuara se në mungesë të inspektimit dhe matjeve të rregullta kompanitë nuk e deklarojnë sasinë e vërtet të eksploatuar dhe me këtë i ikin pagesës së tantiemave apo rentës minerare.

Në material nuk ka qasje të unifikuar për sa i përket dhënies së informatave për ndërmarrje, për disa ndërmarrje natyrisht, por disa sosh janë dorëzuar në materialin shtesë, disa të dhëna veçanërisht për KEK-un, për prodhimin e thëngjillit e cila është zbërthyer edhe sipas planeve dhe sipas realizimit të planeve për muaj, po flas për materialin shtesë.

Po ashtu ka edhe shumë çështje tjera që duhen të diskutohen për këtë raport sidomos për sa i përket inspektimit për shkak se në raportin e kryeinspektorit kryesisht përsëriten të dhënat që vijnë nga raporti i Komisionit, pra ka përsëritje dhe është vështirë ta kuptojmë se çfarë pune ka bërë kryeinspektori gjatë këtij viti 2012. Faleminderit!

KRYETARI: Për Aleancën, s’është lajmëruar kurrkush. Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale dhe duke marrë parasysh se komisioni për miniera dhe minerale thuaja se 8 vjet raportin brenda Komisionit parlamentar dhe 8 vjet raportet e tyre janë në viza vi në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale, mund të themi se kësaj radhe ne kemi kërkuar edhe një material shtesë si komision parlamentar që ky raport të jetë më funksional dhe mund të themi se në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale dhe në bazë të obligimeve që dalin nga ligji raporti i Komisionit për Miniera dhe Minerale i plotëson kërkesat mirëpo prapëseprapë duhet të themi se duhet t’u japim mundësinë që ndoshta edhe brenda 6 muajve të ardhshëm ata të vijnë brenda Komisionit Parlamentar dhe ne të bisedojmë me

ta për çështje tjera për arsye se shumë objektiva të cilat ata kanë menduar se do t'i arrijnë prapëseprapë kanë vështirësi.

Mund të themi se e përkrahim raportin dhe do të japim mbështetje e sugjerime Komisionit të pavarur të Minierave dhe Mineraleve për shumë çështje tjera për arsye se janë një ndër agjencitë e pavarura të cilat mund të sjellin një zhvillim të mirë ekonomik Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Justina Shiroka-Pula e ka fjalën.

JUSTINA PULA-SHIROKA: Faleminderit, kryetar!

Unë do të jap mendimin tim rreth këtij raporti edhe pse anëtarët e Komisionit vazhdimisht e cekën se kanë pasur material shtesë. Unë nuk e kam pas këtë material shtesë, prandaj këto të dhëna të cilat do t'i paraqes janë sipas raportit të cilat i kam pasur që e kemi marrë herën e parë.

Prandaj, do të filloj pikë për pikë, gati për tërë raportin, të cilat mendoj se janë disa vërejtje apo komente të mia për raportin e ardhshëm që të jenë më të mira apo të përmirësohen.

Gjatë analizës së pikës 3.1 licenca për hulumtim gjeologjik, në faqen 12 deri 16 si dhe shtojca 1 - lista e licencave aktive, po vërehet se KPMM ka lëshuar 297 licenca, mirëpo është shqetësuese që shumë pak licenca të lëshuara për minerale metalike, duke mos marrë parasysh licencat e minierave të vjetra.

Mirëpo, në anën tjetër, ka të lëshuara shumë licenca për hulumtim, ndërsa në bazë të listës shihet se ka vetëm 3 licenca të shfrytëzimit për minerale metalike pa llogaritur "Trepçën" dhe Ferronikelin, dhe nga këto tri licenca në raport po vërehet se është një shfrytëzim minimal, i cili po raportohet në tabelën që gjendet në faqen 29 dhe 30.

Këtu po shihet se dy licencat që janë dhënë për shfrytëzimin e nikelit kanë shfrytëzuar zero mundësi të hulumtimit, ndërsa në faqen 33 pasqyrohet shfrytëzimi i kromit në 2 000 tonë.

Nëse i krahasojmë licencat e licencuara apo listën e licencuar të lëshuara nga raporti mund të vërehet se të njëjtat kompani kanë marrë disa licenca, por ka edhe asi raste që një pronar ka regjistruar disa kompani dhe KPMM i ka pajisur me disa licenca.

Gjithashtu ka edhe aso raste kur skadon licenca në emër të njëjës kompani, individ merr licencën e njëjtë me kompaninë tjetër, por pronari apo individ mbetet i njëjtë.

Këtë çështje mund ta verifikojmë edhe në ueb-faqen e KPMM.

Ky Kuvend duhet të kërkojë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të prezantojë dhe shpjegojë a janë duke i respektuar kriteret për lëshimin e licencave të hulumtimit, a janë duke i kontrolluar nëse këto lloj kompani janë duke bërë hulumtime të

mirëfillta apo vetëm janë duke marrë licenca për qëllime të përfitimit apo të tregtimit të tyre?

Në këtë veprim që është duke e bërë Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale, bllokohen resurset dhe mundësia për tërheqjen e investimeve të mirëfillta për hulumtuar dhe investuar në këtë fushë, sepse kjo formë e menaxhimit po i mobilizon zonat e lira çka nënkupton që investorët e investuar po detyrohen të blejnë licencat nga kompanitë tregtare licencuese.

Gjithashtu në raport nuk ka prezentuar apo më mirë të themi nuk po raportohet sa është duke u respektuar neni 6 pika 1.4 të Ligjit të mineraleve, apo janë duke u dhënë licenca të reja që bien në kundërshtim me këtë pikë.

Pse nuk është paraqitur në raport një pasqyrë e hulumtimeve, a është duke u hulumtuar me ligjin, sa është duke u respektuar Ligji për pjesën e shpenzimeve minerale të hulumtimit?

Në raport gjithashtu nuk po raportohet a kontrollojnë KPMM kompanitë dhe çfarë ka ndërmarrë ndaj kompanive të cilat nuk investojnë apo shpenzojnë për hulumtime në përputhje me kërkesat apo rregullat e parapara me ligj.

Nëse nuk monitorohen nga ky aspekt, atëherë mundësohet çdo fushë të pajiset me licencë dhe në këtë rast po bllokohen mineralet e caktuara të hulumtohen deri sa të gjendet ndonjë blerës i licencave.

Kjo mund të shihet më së miri në tabelën e licencave të shfrytëzuara në faqen 17, me ç'rast kemi të lëshuar vetëm një licencë të shfrytëzimit për minerale metalike gjatë vitit 2012. Kjo tregon se kompanitë e pajisura me licenca të hulumtimit nuk janë duke hulumtuar fare.

Në faqen 20 prezentohen projektet e KPMM-së. Në këtë kapitull janë paraqitur projektet e kryera nga KPMM për vitin 2012.

Gjithashtu dihet se KPMM ka bërë projekte shumë të rëndësishme për sektorin e minierave siç janë hulumtimet gjeofizike, hulumtimet gjeokimike, hartat gjeoshkencore e tjera. Gjithashtu, nuk po raportohet se sa janë këto projekte transparente dhe sa po afrohen në shërbim të dhënat nga këto projekte për opinionin e sidomos për investorët të mundshëm, sepse dihet se këto të dhëna duhet të shërbejnë për kompanitë e interesuara dhe jo të mbyllen në arshivë.

Në faqen 24, janë të prezantuara aktivitetet e gjeologjisë, mirëpo do të ishte mirë të afrohen edhe disa informata tjera siç janë - sa është sasia e mineraleve të zbuluara nga hulumtuesit në vitin 2012, çfarë lloj hulumtimesh janë kryer, a janë kryer shpimet, nëse po, sa metra shpime e tjera? Pra, këto të dhëna duhet të nxirren nga raportet e hulumtimit të dorëzuara nga kompanitë e licencuara. Me këto informata plotësuese, të cilat duhet të përfshihen në raport do të duhej të kishin një pasqyrë të qartë për opinionin dhe

investitorët, por edhe për Komisionin e Pavarur për Miniera e Minerale do të ketë mundësinë e kontrollimit nëse janë bërë ndonjë hulumtim dhe sa janë bërë hulumtimet e mirëfillta në Kosovë apo vetëm janë bllokuar zonat në pritje të blerësve të licencave.

Shtojca 4, lista e kompanive me obligime në vitin 2012. Në këtë listë shohim se ka shumë kompani që kanë obligime të mëdha dhe atyre nuk u janë tërhequr licencat. Po ashtu në këtë listë emrat e disa kompanive janë paraqitur disa herë dhe u janë shpërbly obligimet në disa vende rresht. Për shembull, në qoftë se e marrim obligimet të cilat i ka pas miniera e industrisë së magnezitit Golesh. Kjo është e identifikuar në rreshtin 362, e cila ka borxh 36 663 euro. Në rreshtin 406 të cilin kanë 18 424 mijë euro, dhe kështu me radhë. Ka edhe shumë kompani të cilat renditen në disa rreshta për të eliminuar borxhin total të cilin e ka, sa më shumë rreshta llogaritet që këto kompani kanë më pak borxhe ndaj Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve.

Pra, ka shumë kompani që kanë obligime të mëdha dhe nëse shikohet lista e licencave ato janë të licencuara.

NË bazë të Ligjit për miniera dhe minerale, nëse një kompani nuk i paguan obligimet për renten minerale, atëherë duhet t'u tërhiqet licenca.

Sa licenca janë tërhequr deri më tani, si rrjedhojë e mos pagesës së obligimeve për renten minerale? Pse Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve u lejon të vazhdojë me shfrytëzimin dhe obligimet pa i paguar obligimet të cilat i kanë. Në këtë Komisioni i pavarur i Minierave dhe Mineraleve lejon që ato të rrisin obligimet në mënyrë të vazhdueshme.

Në faqen 43, gjeodezia, në këtë pjesë është dashur të paraqiten edhe matjet verifikuese të sasive të shfrytëzuara në raport me atë të raportuara. A bën KPMM matje të tilla, a është dashur që kjo teknologji që posedon KPMM të përdoret edhe për këtë qëllim, të dihet nëse kompanitë janë duke raportuar dhe paguar drejt ka të bëjë me matjet kontrolluese pas shfrytëzimit të këtyre licencave.

Kapitulli Departamenti Ligjor. Në këtë kapitull si dhe në shtojcën, shihet shumë qartë se Departamenti Ligjor ka një volum të madh të punëve. Mirëpo, në këtë raport është dashur të jepet sqarimi se çka ka ndodhur gjatë vitit 2012. Në këtë vit KPMM ka mbyllur 4 licenca të kompanive angleze FOX, të cilat pastaj të njëjtave u është kthyer. A ka vlerësuar Departamenti Ligjor në mënyrë të drejtë që kësaj kompanie t'i merr licencat e shfrytëzimit dhe pastaj të njëjtës departamenti i rekomandon kthimin e këtyre licencave? A është e vetëdijshme KPMM se me këto sjellje i bën dëm Kosovës, a është sjell dikush në përgjegjësi për këtë shkelje dhe a janë marrë masa?

Mendoj se ky Kuvend duhet të kërkojë nga KPMM-ja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe dy minuta, regjia!

JUSTINA SHIROKA-PULA ... të na paraqitet një raport i qartë ligjor. A ka pas të drejtë KPMM-ja të revokojë këto licenca, nëse po, atëherë pse janë kthyer të njëjtat licenca? Nëse nuk ka pasur të drejtë, atëherë pse janë revokuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Raporti i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale është i ngjeshur me shifra, informata dhe i kompletuar, mirëpo mangësia kryesore e tij, është fakti se raporti është i ngarkuar me detaje dhe i mungon kontinuiteti.

Ai duket sikur një përmbledhje e raportit të sektorëve brenda këtij Komisioni dhe ato dalin pa ndonjë ndërlidhje të mirë.

Po ashtu, në të shumtën e rasteve në raport mungojnë krahasimet me vitet e mëhershme kështu që e kemi të vështirë të nxjerrim një pasqyrë se ka pasur ecje, ngecje apo rënie të aktiviteteve. Ndërkaq, ka vende edhe për vërejtje konkrete.

Në këtë rast, unë do të filloj nga fundi i këtij raporti, përkatësisht nga puna e inspektorit.

Sipas shifrave duket se është bërë një punë mjaft e madhe. Ndoshta, kjo ka ndodhur për shkak të vendimit për ndërprerjen e eksploatimit të rërës në shtratin e lëmenjve. Kjo përshtypje krijohet nga numri i madh i gjobave administrative për kompanitë ilegale, që gjithsej janë 197 kompani, kurse numri më i madh i tyre ka të bëjë me eksploatimin e rërës dhe të zhavorrit.

Nga raporti i kryeinspektorit duket një fenomen shqetësues, i cili ka të bëjë me jetën e njerëzve, punëtorëve, atyre që merren me eksploatimin e xehes. Ky problem është i koncentruar te dy kompanitë më të mëdha të Kosovës, njëra publike, Korporata Energjetike e Kosovës dhe tjetra shoqërore “Trepça”. Më lejoni të citoj tabelën 15 në faqe 101: “Nga 8 lëndime të rënda në punë, 6 kanë ndodhur në “Trepçë” e 2 në KEK. Prej dy lëndimeve vdekjeprurëse, që të dyja kanë ndodhur në “Trepçë”. Prej 88 lëndimeve të lehta, 44 kanë ndodhur në “Trepçë” dhe 42 në KEK.

Sa për ilustrim po përmendi shifrat tjera, që dalin nga kjo tabelë. Në Sharr-cem nuk ka ndodhur asnjë lëndim, në Ferronikel dhe në kompanitë Benita-Company kanë ndodhur vetëm nga një lëndim i lehtë.

Kur kemi parasysh këto shifra, atëherë detyrimisht parashtrohet pyetja, se çfarë po ndodhë në kompanitë, të cilat janë në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të institucioneve të Kosovës? Apo mos ndoshta inspekcioni është fokusuar në këto dy kompani, prandaj edhe ka evidentuar më shumë raste!? Unë nuk besoj në këtë, meqenëse inspektorati ka përgjegjësi për të kontrolluar edhe kompani të tjera, që edhe shihet në këtë raport.

Pastaj, shkaktarët e lëndimeve pothuajse përsëriten në secilin vit. Gjendja jo e mirë e pajisjeve, gjendja e shkallëve në minierat sipërfaqësore, pakujdesia dhe neglizhenca, përdorimi i pamjaftueshëm i mjeteve mbrojtëse dhe mungesa e njohurive dhe aftësimi i pamjaftueshëm profesional. E kam të qartë për rreziqet që bartë natyra në punë, në miniera, qofshin ato sipërfaqësore apo nëntokësore, por është e papranueshme që ende të ketë mungesë të njohurive dhe aftësimit të pamjaftueshëm profesional të sektorin e sigurisë. Nëse kjo është kështu, atëherë pse ato janë pajisur me licencë e leje, nëse nuk kanë potenciale për mbrojtjen e jetës së minatorëve?

Po i kthehem fillimit të raportit.

Nën 1, nga raporti del qartë për numrin e madh të kërkesave, pastaj të lejeve e licencave të dhëna të gjitha llojeve, por po e përsëris, se nuk kam pasqyrë të qartë se si qëndrojnë punët kur bëhet një krahasim me vitet e kaluara.

Nën 2, raportit i mungojnë të dhënat mbi numrin e licencave të revokuara, të bartura apo të pezulluara. Nëse nuk ka pasur të tilla licenca, është dashur të bëhet e qartë kjo.

Nën 3, një numër i madh i kërkesave për licenca, thuhet se është refuzuar, por nuk ka shpjegime se përse ato janë refuzuar.

Një vërejtje tjetër kam rreth mënyrës se si bëhet planifikimi i punëve në kompanitë e licencuara. Sa për ilustrim po përmend se te rëra dhe zhavorri plani i prodhimit për vitin 2012 është realizuar vetëm 11,5%, te anteziteti 10,6%, te argjila 18%, një kompani për eksploatimin e nikel-kobaltit edhe pse ka pasur të planifikojë 30 mijë metra kub, nuk ka eksploatuar asnjë metër.

Në bazë të këtyre shifrave pyes Komisionin për Miniera dhe Minerale, se kur lejon dhe miraton plane të tilla, a e ka parasysh potencialin, përkatësisht përgatitjen e kompanive?

Dhe tjetra, planet e këtilla miratohen vetëm sipas dëshirës së kompanisë, apo merren parasysh edhe kërkesat e tregut?

Çështja tjetër janë financat e KPM-së, përkatësisht me nivelin e përmbushjes së detyrimeve që kanë operatorët. Sipas tabelës nr. 25 në faqen 40 del se në vitin 2012 janë arkëtuar gjithsej 6,4 milionë euro. Mirëpo, në këtë shumë hyjnë edhe obligimet e bartura që nga viti 2007 e deri në vitin 2011. Pyes, pse ka kaq shumë vonesa dhe me këtë rast KPM-ja a aplikon ndonjë masë ndëshkuese nga borxhlinjtë, qoftë duke u llogaritur kamata? Këtu duket se nuk ka aplikuar kamatat. Me këtë nuk ka përmbushur njërin prej rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Pastaj, pse në raport nuk përmbahen edhe informacionet, se çfarë ka ndodhur me 44 kallëzime penale, që janë paraqitur në Prokurorinë kompetente?

Te sfidat, si vështirësi në punën e KPM-së përmendet edhe shkalla e ulët e koordinimit ndërinstitutional, mirëpo nuk ka informata konkrete përkatësisht se në cilat hallka

mungon ky koordinim. Kush po e pengon atë dhe çfarë duhet të bëhet për të tejkaluar këtë situatë? Faleminderit!

KRYETARI: Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të gjitha agjencitë e pavarura, të cilat i raportojnë Kuvendit, janë të obliguara që bashkë me raportin e punës të paraqesin njëkohësisht edhe raportin financiar, në të cilin duhet të pasqyrojnë të gjitha të dhënat për shpenzimet e tyre gjatë vitit që ka kaluar.

Këto institucione të pavarura kanë pasur forma të ndryshme të raportimit. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka hartuar formularë standardë të raportimit, ku është paraparë që këto institucione t'iu përgjigjen kërkesës së Komisionit, që t'i paraqesin të dhënat më të detajizuara, ku kemi mundësi t'i shohin të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me planifikimet buxhetore për vitin aktual dhe vitin e mëparshëm, si dhe realizimin e buxhetit për vitin e kaluar dhe vitet tjera.

Kështu që, me paraqitjen e këtyre formularëve ne kemi pasur mundësi që të marrim të dhëna të mjaftueshme nga të gjitha institucionet e pavarura, përfshirë edhe Komisionin për Miniera dhe Minerale, të cilët e kanë plotësuar formularin dhe na kanë ofruar shënime, të cilat ne i kemi kërkuar.

Në raportin e shpenzimeve të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve për vitin 2012, kanë qenë të planifikuara mjete prej 1 695 564 euro, ndërsa buxheti përfundimtar, domethënë ka qenë 1 505 564 euro.

Ndryshimi në shumën prej 190 mijë eurove ka shkuar si kursim, me vetë kërkesën e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe ky kursim ka qenë 170 mijë euro nga investimet kapitale dhe 20 mijë euro nga subvencionet dhe transferet.

Shohim se kjo agjenci e pavarur ka realizuar buxhetin diku 83,8%, kurse për paga dhe mëditje janë shpenzuar 98,4% të mjeteve, për mallra dhe shërbime 82% të mjeteve, kurse për investime kapitale 60,7% të mjeteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar informata shtesë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në lidhje me mosrealizimin e mjeteve për investime kapitale dhe pasi që ka marrë informata të nevojshme nga përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka miratuar me shumicë votash raportin financiar të kësaj agjencie të pavarur. I rekomandojmë deputetët, që ta miratojnë këtë raport.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e radhës, për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të deputetëve.

12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012

Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, edhe pse ky komision nuk e ka kryer detyrën e vet në konfliktin që është në mes IPKO-s dhe KTV-së.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Në vend të Idriz Vehapit, fjalën e ka zëvendësi i tij Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtetë janë dy zëvendëskryetarë të komisionit. Unë do ta paraqes në mënyrë kolegjiale raportin.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2013, shqyrtoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012 dhe vendosi, që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim: Të miratohet raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për media për vitin 2012.

Në këtë mbledhje Komisioni vlerësoi se i njëjti përmbushë obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Komisioni i Pavarur për Media i ka raportuar Komisionit për Buxhet dhe Financa, sipas formularëve që i ka kërkuar Komisioni për Buxhet. Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2012 Komisioni i Pavarur për Media ka pasur të planifikuara 997 651 euro, ndërsa ka shpenzuar 668 403 euro, çka do të thotë se ka shpenzuar buxhetin vetëm 68%, ku ka pasur një suficit të theksuar në shpenzimin e mjeteve.

Në kategorinë paga dhe mëditje ky institucion i ka shpenzuar mjetet 94%, mallra dhe shërbime 89%, kurse është një dukuri që po përcillet nga viti në vit, sa i përket shpenzimeve kapitale. Edhe në vitin 2011 kanë qenë të planifikuara 240 mijë euro për

investim kapital, ndërtimin e objektit të KPM-së, mirëpo në vitin 2011 janë shpenzuar vetëm 8 mijë euro.

E njëjta shumë e mjeteve është planifikuar për ndërtimin e këtij objekti të Komisionit të Pavarur për Media prej 240 mijë eurove dhe në vitin 2012, mirëpo prapëseprapë ky objekt nuk është ndërtuar. Dhe, arsyetimi i përfaqësuesve të Komisionit të Pavarur të Mediave ka qenë, sepse nuk ia ka ndarë parcelën komuna e Prishtinës. I njëjti arsyetim ka qenë edhe në vitin 2011. Ky arsyetim është përsëritur edhe në vitin 2012, për çka ka bërë që buxheti i këtij institucioni të jetë diku 68% i shpenzuar.

Ky institucion realizon edhe të hyra. Në periudhën janar-dhjetor janë realizuar të hyra në vlerë prej 221 290 euro, prej tyre 214 mijë euro u takojnë të hyrave nga licencat, ndërsa 2 800 euro dhe 4 667 euro ju takojnë kamatave për vonesë dhe gjoba, çka do të thotë që totali i të hyrave ka qenë 221 290 euro, të cilat i ka realizuar ky institucion i pavarur.

Nga evidenca e të dhënave, që kanë qenë për planifikimin e buxhetit dhe shpenzimin, kemi vërejtur se ky institucion ka shpenzuar mbi atë që është planifikuar, sa i përket shpenzimeve që kanë të bëjnë me udhëtime jashtë vendit, në vlerë prej 30 485 euro. Domethënë, ka tejkaluar shumë nga ajo që është planifikuar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar që të jepen sqarime të nevojshme, pse është tejkaluar kjo shumë nga ajo që është planifikuar. Dhe, kemi marrë përgjigjen, se këto mjete janë shpenzuar, sepse ka pasur nevojë për hartimin e strategjisë për kalimin nga sistemi analog i transmetimit në sistemin digjital, kështu që ka kërkuar më shumë mjete për udhëtime jashtë vendit e të tjera.

Kurse, për mallra dhe shërbime sa i përket kategorisë derivate për gjeneratorë, janë shpenzuar 13 928 euro më shumë, kështu që arsyetimet kanë qenë jo edhe aq bindëse për Komisionin për Buxhet. Megjithatë, komisioni me shumicë votash e ka miratuar raportin dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë.

KRYETARI: Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar Blerta Deliu - Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Këtu u përmend edhe njëherë konflikti, që ka Komisioni i Pavarur i Mediave ndërmjet IPKO-s dhe Kohës Ditore, në fakt KTV-së dhe unë si deputete e këtij Parlamenti po e përmend edhe njëherë jolegjitimitetin e kryetarit të Komisionit të Pavarur të Mediave, për shkak se është përmendur edhe njëherë brenda këtij Parlamenti dhe ky kryetar me emërimin e tij e ka vënë në lajthitje gjithë Parlamentin e Kosovës dhe po e përmend për hir të transkriptit, sepse duhet të jetë pjesë e këtij transkripti dhe të gjithë ata që e shkelin ligjin, duhet që të ndëshkohen.

Ndërsa sa i përket raportit, ne e votojmë raportin dhe kërkojmë që ky raport të miratohet.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nga raporti kemi parë se është një avancim i punës, duke pasur parasysh vonesat në kompletimin e anëtarëve të Këshillit, kështu që kanë qenë lëndët e bartura nga viti që ka shkuar, megjithatë janë shënuar avancime, si në punët e brendshme ashtu edhe në avancimin e bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane.

Përparim në hartimin e strategjisë për digjatilizim. Ajo që na ka rënë në sy si komision, ka qenë shkelja e rregullores, evidentimi i shkeljes së Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve, nga përmbajtjet e dëmshme programore nga mediumet audio-vizuele, që mendojmë se është shqetësuese për secilin.

Siç e pamë, unë edhe nga një dëgjim më herët publik me Komisionin për të Drejta të Njeriut, është prezantuar një shkelje e tillë. Prandaj, mendoj se në këtë drejtim mbetet që të kërkohet korrigjim më tutje.

Raporti prezanton suksese të punës dhe besojmë se në të ardhmen do t'i eliminojë të gjitha ato që janë defekte të kësaj pune. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit Vetëvendosje, deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar dhe të nderuar deputetë!

Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka shqyrtuar raportin vjetor të KPM-së dhe si të tillë e përkrah në parim.

Kjo lëvizje pajtohet me disa nga konstatimet, që dalin nga ky raport, që lidhen me sfidat me të cilat përballet ky institucion kushtetues, të cilat kanë qenë që nga mungesat e stafit të plotë të Këshillit e deri te disa ambivalenca ligjore, që aktualisht e vështirësojnë funksionalitetin e plotë të KPM-së.

Edhe në raport ceket, se KPM madje ka hartuar edhe një draft-strategji, e cila parasheh digjitalizimin e shërbimeve audio-mediave, ndonëse dihet se ky proces duhet të realizohet mbi një bazë tjetër ligjore. Pra, duhet të ekzistojë një ligj tjetër i veçantë, mirëpo KPM-ja e ka paraqitur dhe përgatitur këtë draft-strategji.

Çështje tjetër, që vlen të veçohet nga ky raport është edhe monitorimi që i është bërë mediave lidhur me pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve nga përmbajtje të dëmshme programore.

Dhe, fatkeqësisht KPM ka konstatuar se shumica e medimeve tona kanë bërë shkelje të kësaj rregulloreje, edhe pse rregullorja shumë qartë e normativizon këtë çështje.

Por, ajo që përbën shqetësim kryesor për Lëvizjen Vetëvendosje vazhdon të mbetet shpërfillja flagrante që është duke iu bërë tash e sa kohë këtij institucioni nga ana e operatorit kabllor IPKO, në lidhje me rastin e televizionit nacional KTV.

Është e ditur se KPM-ja si institucion i pavarur kushtetues ka konstatuar qartë shkeljet ligjore, që ka bërë IPKO me zhvendosjen e KTV-së nga numri 3 në numrin 83. Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” e rikthen edhe njëherë në vëmendje për diskutim këtë abuzim radikal të dyfishtë ligjor të IPKO-s, si ndaj KTV-së ashtu edhe ndaj KPM-së, duke mos respektuar vendimet e këtij institucioni të pavarur kushtetues.

Prandaj, kjo lëvizje i bën thirrje urgjente këtij Kuvendi, që të mendojë seriozisht për të mbrojtur institucionet e pavarura kushtetuese, të cilat e kanë bazën edhe në këtë legjislativ ndaj shpërfilljes që mund të vijë nga operatorë të caktuar, të cilët është dëshmuar se janë të pleksur drejtpërdrejtë me pushtetin e që qëllim kryesor në fund të fundit, kanë abrogimin e të drejtës së qytetarëve, për informim të drejtë publik dhe politik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe pse, Kuvendi e ka kryer detyrën e vet, ka nxjerr ligjin, ka zgjedhur bordin dhe bordi duhet t’i marrë përgjegjësitë, që ka me ligj.

(Ndërhyrje.)

Nëse ka konstatuar, le ta dënojë.

(Ndërhyrje)

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012 dhe ka hasur, përpos shumë pengesave që ka pasur, megjithatë është bërë një punë në këtë komision dhe do ta përkrahim në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar këtë raport të Këshillit të Pavarur të Mediave dhe të njëjtin e miratojmë.

Ne gjatë shqyrtimit të këtij raporti në komision, kemi pasur një debat mjaft të gjerë, ku kemi ngritur shumë probleme, të cilat veçse i potencuan edhe kolegët. Duke u nisur nga ajo se ka pasur një thyerje flagrante të Kodit të Mirësjelljes nga operatorët kabllorë, si Kujtesa, IPKO apo edhe nga televizionet lokale apo nacionale.

Gjithashtu, ka edhe disa probleme tjera, ku operatorët kabllorë i ofrojnë pakot e obligueshme qytetarëve, të cilët dëshirojnë të kenë një pjesë të pakos apo jo të programeve, të cilat i kanë ata. Dhe, në marrëveshje të cilat i bëjnë televizionet me operatorë të jashtëm për transmetimin e emisioneve apo ngjarjeve të ndryshme sportive dhe në një moment të caktuar, marrëveshjen e arrin tjetri operator kabllor dhe në këtë

mënyrë qytetari i cili ka bërë pagesën për ta shikuar një ngjarje sportive, ne kemi dëshmi se nuk iu kanë kompensuar dhe kjo ka shkuar në dëm të qytetarit.

Gjithashtu, kemi informata se ka pasur pengesa sa i përket licencimit të operatorëve të ndryshëm, siç janë pra, televizionet apo radiot lokale apo nacionale, për çka edhe në Komision kemi marrë pra informatën dhe premtimin nga përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur të Mediave, se janë duke i punuar dokumentacionin e brendshëm, i cili ka mundësi për t'i rregulluar këto probleme, sepse me dokumentacionin të cilin ata tani e kanë, nuk kanë pasur mundësi që t'i evitojnë të gjitha probleme, të cilat i kemi ngritur edhe ne.

Gjithashtu, duhet përgëzuar se KPM-ja ka arritur, që ta dizajnojë draft-strategjinë për digjitalizim, të cilën ia ka dorëzuar Qeverisë dhe presim që kjo të punohet sa më shumë në këtë drejtim dhe të hyjë në fuqi, kur është edhe e paraparë.

Ne presim që Komisioni i Pavarur për Media në këtë vit do të bëjë punë edhe më të madhe dhe të mbrohet interesi i qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, nënkryetari Petar Miletic e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovane kolegice i kolege,

Govoreći prošle godine, negde baš u ovo vreme o izveštaju oradu Nezavisne Komisije za Medije, kazao sam da ne funkcionisanje ove nezavisne institucije izazvano nepostojanjem njenog saveta, predstavlja primer kako blokiranje rada i institucija dovodi do toga, da jedna važna oblast počinje da se urušava kada se na njoj ne radi.

Ovaj propust svih nas na žalost ima jednu uslovno rečeno dobru stranu. Period u kome Nazavisna Komisija za Medije nije funkcionisala očigledni je primer zašto su regulatorna tela bitna.

Nakon dugog perioda blokade, Skupština Kosova je 30 avgusta 2012.godine imenovala članove Nezavisne Komisije za Medije. Četiri meseca koliko je u izveštajnoj godini Nezavisna Komisija za Medije radila, suviše je kratak period da bi se iz dokumenta o kome danas raspravljamo, mogli videti ozbiljnije rezultati.

Zato i izveštaj, koji danas usvajamo više doživljavam kao izveštaj o radu same institucije u smislu broja odluka, dodeljenih licenci ili rezultata inspekcijskog rada, nego kao osnov za analizu medijske scene, o čemu Skupština treba da debatuje na osnovu godišnjeg izveštaja.

Izveštaji institucija, kao što je Nezavisna Komisija za Medije moraju sadržeti analizu stanja u oblasti kojom se bave, identifikovati uzroke koji na njega utiču i predlagati sistemska rešenja za njegovo poboljšanje. Naime, izveštaj koji Nezavisna Komisija za Medije ali i druga regulatorna tela, koja po zakonu dostavljaju izveštaje Skupštini,

dominanto mora sadržati analizu stanja u oblasti koju regulišu a ne samo stanje u institucijama, koja informišu Skupštinu.

Svakako da ovim ne umanjujem značaj finansijskih i izveštaja o radu ovih institucija, kako to definiše Zakon.

U želji da ne ostanem nedorečen, želim da na konkretnom primeru izveštaja koji je pred nama, pojasnim na kakvu analizu stanja mislim. Izveštaj nezavisne Komisije za Medije koji danas razmatramo ne sadrži podatke o govoru mržnje u medijima, poštovanju upotrebi jezika i stanju medijskih sloboda na Kosovu.

Svi u ovoj sali znamo da su ovo najvažnije teme, čije je uređenje i podizanje na evropski nivo zadatak Nezavisne Komisije za Medije ali i Vlade i Skupštine Kosova. To je takođe i jedan od uslova koji se pred nas postavlja na putu ka Evropskoj Uniji. Važnost uređenja medijskog prostora i stanja u medijima posebno se može videti u izveštaju o napredku Kosova ka Evropskoj Uniji, u kome je ovoj temi posvećena velika pažnja.

Napominjem da će uskoro shodno zakonu koji smo u ovom domu usvojili, početi sa radom i RTK 2, kanal na srpskom jeziku, čije je funkcionisanje bitno pre svega za srpsku zajednicu ali i za senzibilizaciju kosovskog društva. Uređenost medijskog prostora ili drugim rečima funkcionalna nezavisna komisija za medije, bitan je uslov da započeti posao završimo do kraja.

Takođe, stvaranje zakonodavnog okvira i institucionalnog ambijenta za nastupajući proces digitalizacije emitovanja na Kosovu, nemoguće je bez funkcionalne i tome posvećene nezavisne komisije za medije.

Bilo bi značajno da se iz izveštaja Nezavisne Komisije za Medije mogu pročitati i analizirati i drugi reperi stanja u kosovskom društvu, koji se prelamaju u medijskoj sveri, kao što su zastupljenost žena u medijima, kadrovska struktura ili materijalni položaj zaposlenih.

Mediji su važan korektiv svakoj vlasti i zato je važno da ova institucija informiše Skupštinu i o problemima, koje novinari imaju prilikom izveštavanja o radu Kosovskih institucija kako bi kao najviši zakonodavni organ mogli da reagujemo.

Želim da se na kraju osvrnem i na delove izveštaja koje treba pohvaliti, kao što su monitoring o zaštiti dece i maloletnika od štetnog programskih sadržaja. U prirodi je politike da želi da ima uticaj na medije. Institucija Nezavisne Komisije za Medije dokazan je maknizam za zaštitu medija od političkog uticaja. Deblokiranje rada ove institucije krajem prošle godine prilika je da se novom energijom i precizno definisanim ovlašćenjima i odgovornostima uredi ova oblast. Nezavisna Komisija za Medije na tom putu ima punu podršku Samostalne Liberalne Stranke. Hvala.

KRYETARI: Tani është fjala në emër të Grupit të Ri Parlamentar të ZB-së, deputeti Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovane kolege poslanici,

Nova Poslanička Grupa Zajednička Budućnost podržaće izveštaj Nezavisne Komisije za Medije. Mi smo ga detaljno analizirali i utvrdili nekoliko činjenica.

Posmatrajući ovaj izveštaj možemo reći, odnosno možemo i pohvaliti rad ove komisije. A sa druge strane, posmatrajući neke njihove podatke koje su nam dali u izveštaju moramo i treba da se zabrinemo za stanje u medijskoj sveri.

Mislim da je za pohvalu što je u vrlo kratkom vremenskom periodu Nezavisna Komisija za Medije uradila nacrt strategije zajedno sa Vladom Kosova i sa Civilnim društvom. Takođe je veoma pohvalno što su uspeli da urade uredbe o audio-vizuelno-komercijalnoj komunikaciji. Takođe vrlo bitna tema za kosovsko društvo je zaštita dece i maloletnika od medijskih serviseri. Zatim, možemo pozdraviti i mnoge odluke koje su doneli prilikom rešavanja nagomilanih problema zbog nefunkcionisanja ove komisije tokom prethodnih dveju godina.

Ono što je zabrinjavajuće to je činjenica da većina televizije i provajdera krši upravo donetu uredbu o zaštiti dece i maloletnika od štetnog programskog sadržaja, kao što su strah, nasilje, erotika i pornografija.

Zatim, ima puno slučajeva kršenja autorskih prava. Jedna od činjenica koja je veoma ovako interesantna a sa kojom se susrećemo i koja nam ponekad sigurno smeta jeste dužina reklama, koja se pojavljuje u toku emitovanja programa od jednog sata.

Ovo kršenje se najčešće dešava kada su najinteresantiji televizijski programi, kada imamo utakmice na televiziji.

Dalje. Kao jedan od velikih nedostataka možemo da navedemo i pokrivenost tv-signala na teritoriji Kosova, koja iznosi samo 62%. Znači, mnoge naše opštine, odnosno mnoga područja ostaju bez pokrivenosti ovog televizijskog signala.

Ono što je interesantno za srpsku zajednicu a želim da navedem da u ovoj sveri, u sveri medija imamo veliki broj radio i TV stanica, koje emituju program na srpskom jeziku. Taj broj je, što se tiče TV stanica, znači imamo 5 TV stanice od 21 i 25 radio stanica od ukupnog broja koji iznosi 23.

Kao veliki problem sa kojim se susreće nezavisna Komisija za medije jeste sigurno i veliki broj slučajeva ilegalnog emitovanja program.

Poslanička grupa Zajednička Budućnost, još jednom ponavljam, podržaće ovaj izveštaj i glasaće za njega. Zahvaljujem!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Të pranishëm janë 50 deputetë. Vazhdojmë me pikën e 13-të të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni për Legjislacion dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetin Arben Gashi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin, ku e ka ftuar edhe drejtorin ekzekutiv të raportojë në Komision dhe komisioni e ka përkrahur raportin dhe i rekomandon seancës, po ashtu që ta përkrahë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kryetarja e komisionit Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

E di që është vonë dhe shumë deputetë po më thonë shkurt, dhe unë do të përpiqem ta them raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa sa më shkurt.

Ky institucion i pavarur po ashtu, ka raportuar dhe vërejmë se i ka 512 515 euro të planifikuara dhe prej tyre ka shfrytëzuar 88,49% të mjeteve.

Po ashtu, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka pasur mbështetje nga institucionet ndërkombëtare, nga USAID-i, UNDP-ja, GIZ-ja e të tjera dhe vërehet se 40 858 euro kanë rrjedhur përmes Thesarit dhe janë menaxhuar nga Instituti Gjyqësor, ndërsa 692 657 euro janë raportuar nga donatorët, por janë menaxhuar nga vetë donatorët.

Ajo që më shtyri të marr fjalën është që nëse vërejmë kategoritë e shpenzimeve, shohim se ky institucion nuk ka ndonjë buxhet të madh sa kanë institucionet tjera, por vërehet që në kategoritë e rëndësishme siç janë:

- Shpenzimet e udhëtimit, janë tejkaluar shpenzimet për 25% nga ajo që është planifikuar,
- Shpenzimet e telefonisë fikse janë tejkaluar për 29% nga ajo që është planifikuar,
- Të telefonisë mobile për 23% janë tejkaluar nga ajo që është planifikuar,
- Për blerjen e telefonave në më pak se 1 mijë euro, buxheti është shpenzuar për 59% më shumë nga ajo që është planifikuar.

- Kurse, për mirëmbajtjen e mobileve dhe pajisjeve janë shpenzuar mjete 307,25% më shumë nga ajo që është planifikuar.

Megjithatë, Komisioni për Buxhet dhe Financa ia ka dhënë një votë pro këtij raporti, por ka kërkuar nga Auditori Gjeneral, që të bëjë auditimin e performancës së këtij institucioni dhe auditimin e rregullsisë, që të verifikohet se sa janë respektuar rregullat e menaxhimit financiar nga ky institucion, meqenëse pothuajse në pjesën kryesore të kategorive të shpenzimeve janë tejkaluar shpenzimet.

Nuk po kanë durim të më dëgjojnë, se edhe nja tri fjalë pata për t' i thënë. Faleminderit!

KRYETARI: Mundësisht, shefat e grupeve dhe shkurt. Në emër të Partisë Demokratike, Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi shqyrtuar këtë raport dhe e përkrahim.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që Kuvendi nuk po e kryen punën e vet sa i përket organeve të pavarura, sidomos ato që drejtpërdrejtë i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, me faktin, sepse jo vetëm disa të meta që i tha kolegja nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, edhe pse ne kemi mendim pozitiv sa i përket raportit dhe punës së këtij institucioni.

Zoti kryetar, edhe për hir të deputetëve kolegëve këtu dhe transparencës, më lejoni që unë të theksoj një çështje që unë edhe kam kërkuar si deputet në Komision, që pjesë e këtij raporti t' i bashkëngjitet edhe ata që mbajnë trajnime në këtë institucion, i cili ka të bëjë me arsimimin e vazhdueshëm në fushën ligjore.

Zoti kryetar i Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Ne vazhdimisht jemi ankuar edhe qytetarët e vendit, sepse drejtësia në vend po mungon dhe kjo është një prej kritikave që unë dua ta them këtu, pse mungon në këtë aspekt. Është vetëm një fakt, sepse gjithmonë dhe vazhdimisht edhe vetë Këshilli Gjyqësor i Kosovës është ankuar që ne kemi numër të vogël të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Dhe, nga raporti që i është bashkëngjitur me kërkesën time dhe me kërkesën e Komisionit, në këtë institucion mbajnë trajnime hiç më pak se 92 gjyqtarë dhe prokurorë të vendit, duke filluar nga kryetari i Gjykatës Supreme e deri te pjesa tjetër që janë avokatë.

Kjo, zoti kryetar, tregon edhe atë faktin që Agjencia Kundër Korrupsionit ka evidentuar se zyrtarët e lartë dhe zyrtarët të cilët janë të detyruar ta kryejnë punën ashtu siç i takon me ligj, mbajnë shumë pozita dhe paguhen nga shumë vija buxhetore.

Jo vetëm ata gjashtë zyrtarë që i ka evidencuar, sepse ne e kemi potencuar edhe këtu në Kuvend, sidomos njerëzit që janë detyrimisht ta vënë në funksion sundimin e rendit të ligjit, këtu shihet që vazhdimisht mbajnë trajnime dhe numri i lëndëve të pazgjidhura çdo ditë rritet. Ne vetëm këtë vit e kemi në raport që në Kosovë janë më shumë se 200 mijë lëndë të pazgjidhura.

E dyta, gjithmonë është thënë se ka mungesë të prokurorëve, sidomos të Prokurorisë Speciale. Shikoni nga raporti se të gjithë prokurorët e Prokurorisë Speciale mbajnë trajnime, aty dhe atëherë vihet në pikëpyetje, se cila është puna efektive që e bëjnë ata në prokuroritë e caktuara edhe në Prokurorinë Speciale edhe në prokurori të Gjykatës Themelore, të Apelit, e tjerë.

Prandaj, kjo duhet të jetë një vërejtje shumë serioze nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të jetë ky mesazh shumë i qartë, sepse është e pamundshme një gjyqtar i Gjykatës Supreme, të punojë në 5 vende, të japë mësim në 5 vende dhe njëherësh ta kryejë punën ashtu siç i takon me ligj dhe me Kushtetutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Armend! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka shqyrtuar raportin e Institutit Gjyqësor dhe më tej do t’i them disa vërejtje sa i përket këtij raporti.

Nga raporti i prezantuar i Institutit Gjyqësor të Kosovës prezantohen disa publikime, shumica e të cilave përshkruajnë aktivitetin e këtij Instituti dhe ndonjë doracak për mënyrën e ofrimit të trajnimeve.

Mirëpo, fatkeqësisht, Instituti Gjyqësor i Kosovës duket që nuk ka qenë në gjendje të përmbushë mandatin e tij rreth hulumtimeve ligjore dhe gjyqësore për të identifikuar kështu problemet rreth zbatimit të ligjit, por është marrë me disa publikime jo përmbajtësore, që nuk i ndihmojnë fare orientimit të mirëfilltë të planeve apo programeve trajnuese të saj.

Jo pse disa nga publikimet, për shembull doracakët e prezantuar në raport, nuk janë të rëndësishëm, por se ajo që është më prioritare për realizimin e mandatit të tij, duket të jetë shpërfillur plotësisht nga IGJK-ja.

Pra, IGJK-ja është dashur që ta sajojë dhe botojë praktikën gjyqësore, e cila do t’i shërbente gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë punës së tyre. Është praktikë e shumë vendeve, që sidomos gjykatat e larta të botojnë buletine me publikime shkencore, si dhe të botojnë koleksione të praktikës gjyqësore të gjykatave të larta.

Raporti përmend si një nga sfidat e Institutit edhe ndryshimet e shpeshta ligjore. Nga raporti nuk mund të arrihet ndonjë përfundim se si i është qasur IGJK-ja kësaj sfide, si i ka përcaktuar prioritetet gjatë procesit të përgatitjes së planeve për trajnimet. Raporti nuk

të jep kurrfarë përfundimi nëse ka pasur koordinim me Shoqatën e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve apo me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për qëllime të identifikimit të nevojave dhe orientimit të planit të avancimit sipas nevojave reale dhe kërkesave të dala nga puna praktike e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Duke filluar nga viti 2013 organizimi i sistemit gjyqësor iu ka nënshtruar rristurimit, mirëpo raporti përmend shkarazi disa trajnime të ofruara dhe një trajnim njëditor për Ligjin për gjykatat, mirëpo nuk mund të përfundohet nëse trajnimet rreth rristurimit të gjykatave janë trajtuar me prioritet, përkundër peshës së ndryshimeve të organizimit të gjyqësorit.

Nuk mund të përfundohet nëse IGJK-ja ka arritur t'i përgjigjet nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për aftësim profesional në lidhje me detyrimet e tyre për procedime sipas Ligjit të ri për gjykatat.

Raporti më tej nuk prezanton se cilat janë vlerësimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si përfitues kryesorë të këtij institucioni në lidhje me trajnimet aftësuese të ofruara nga IGJK-ja dhe adresimit të duhur të nevojave të tyre përmes këtyre trajnimeve.

Gjithashtu, raporti nuk jep kurrfarë indikacionesh se cilat kanë qenë dhe sa janë respektuar parametrat e përgjithshëm të përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në raport me përgatitjen e programit të punës për qëllime krahasimi.

Instituti ekziston për shkak të bartësve të funksionit gjyqësor dhe prokurorial dhe programet e punës duhet përgatitur ashtu që të jenë të përshtatur për nevojat e tyre dhe jo sipas përcaktimeve ad hoc apo sipas tekeve të Institutit Gjyqësor apo realizimit të projekteve të planifikuara nga ana e ndonjë donatori.

Nuk ka asnjë raportim rreth hartimit të strategjisë së punës, e cila po ashtu duhet planifikuar në pajtim me parametrat e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Në këtë kontekst raporti nuk jep kurrfarë indikacioni se a ka pasur dhe cili ka qenë koordinimi i Institutit Gjyqësor të Kosovës me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Pra, këto janë disa nga vërejtjet tona si Grup Parlamentar dhe shpresojmë, që ky Institut në raportet e ardhshme do t'i marrë parasysh, në mënyrë që në të ardhmen të na sjellë një raport më të kompletuar dhe më përmbytësor. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar raportin. Raporti është me plot mangësi, por megjithatë do ta përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë këtë raport, duke iu bashkëngjitur vërejtjeve të cilat i përmendi deputeti Zemaj këtu në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të ri ZB-së, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

I poslanička grupa Zajednička Budućnost podržaje izveštaj o radu Sudskog Instituta Kosova za 2012. godini i glasaće za njegovo usvajanje.

KRYETARI: Faleminderit! Të tjerë nuk ka të lajmëruar prej grupeve. Edhe deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Një nga sfidat tjera të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sipas raportit shënohet edhe koordinimi dhe mbështetja nga donatorët. Në raport pasqyrohen donacionet, por nuk mund të konstatohet nëse këto kanë qenë nevojat reale të institutit.

Nuk prezantohen cilat projekte i ka kërkuar IGJK-ja dhe cilat nga projektet e kërkuara janë miratuar. Kështu, lë të kuptohet se IGJK-ja pranon çka t'i ofrohet nga donatorët, pavarësisht se cilat janë nevojat reale, si të vetë institucionit, ashtu edhe përfituesve të shërbimeve të këtij institucioni.

Raporti prezanton vizita studimore në vende të ndryshme, madje edhe në vende të cilat nuk kanë qenë të përfshira në ndonjë mënyrë apo tjetrën, në përkrahjen e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial të Kosovës. Këto vizita janë zhvilluar me arsyetimin se kanë pasur për qëllim bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet e caktuara. Por, nga përmbajtja e raportit nuk mund të identifikohet se cili është ai bashkëpunim dhe natyra e bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucione të caktuara, ku janë zhvilluar vizita studimore dhe nuk mund të përfundohet se cilat janë përfitimet e IGJK-së dhe përfituesve të saj, cilat janë veprimet konkretet të ndërmarra nga IGJK-ja pas vizitave studimore dhe si janë zbatuar apo si planifikohet të zbatohen njohuritë e fituara dhe përvojat e këmbjera në këto vizita.

Në të prezantohen po ashtu, disa të dhëna statistikore si për shembull, gjinia e pjesëmarrësve, bartësve të funksionit gjyqësor dhe prokurorial, kurse nuk prezantohet se sa është përqindja e vijuesve në raport me numrin e përgjithshëm të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, a ka trendë të rritjes apo zvogëlimit të numrit të pjesëmarrësve në trajnimet e ofruara nga IGJK-ja?

Të dhëna të tilla statistikore dhe jo statistika për përkatësi gjinore të pjesëmarrësve, do të jepnin ndonjë indikacion se sa vlerësohet puna e IGJK-së nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Po ashtu, nuk mund të përfundohet se cilat janë rezultatet as të planeve afatshkurta, afatmesme apo afatgjatë, të aftësimit për qëllim të krijimit të një gjyqësie të pavarur,

efikase dhe të paanshme. A janë realizuar ndonjëherë këto plane, si janë matur rezultatet, nëse ka pasur ndonjë?

Pothuajse, asnjë nga aktivitetet e IGJK-së sipas raportit të prezantuar, nuk duhet të jetë i matshëm me rezultatet e synuara. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Në radhë është pika e katërmëdhjetë:

14. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013

Ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonajn për arsyetimin e rekomandimit, shkurt mundësisht.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, po përpqem ta them shkurt, po ka qenë mirë që këto pyetjet parlamentare dhe ngritja e çështjeve të mbetet në fund të seancave ose një ditë të veçantë e mos lodhemi ne për të harxhuar energji para dite, mandej s'po kemi durim t'i dëgjojmë çështjet e rëndësishme në fund të seancës.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka bërë një kërkesë për caktimin e tarifës vjetore. Kërkesa ka ardhur pak me vonesë, siç e dimë për shkak të miratimit të ligjit, plotësim- ndryshimit të ligjit, sepse ka pasur problem në përcaktimin e taksës operacionale dhe investuese të këtij institucioni.

Në bazë të nenit 4, paragrafi 17 të Ligjit nr. 04 L-101 për fondet pensionale të Kosovës, aktivitetet e Fondit financohen përmes pagesave të arsyeshme, të bazuara në shpenzimet e llogarive individuale.

Kuvendi i Kosovës e cakton taksën investive dhe operacionale në bazë të kërkesës së Fondit për çdo vit kalendarik, e cila kërkesë duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përlllogaritura për periudhën në të cilën paraqitet kërkesa në pajtim me nenin 2, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.4.2013 shqyrtoi kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013 dhe analizoi buxhetin e Fondit të miratuar nga bordi udhëheqës dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë taksën operacionale prej 0,15% dhe taksën investive prej 0,38%, që përfshin periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2013.

Komisioni rekomandoi që taksa investive të miratohet për 0,4% më ulët nga ajo që është kërkuar nga fondi, që është 0,42% dhe kjo ka të bëjë me zbritjen e shumës së planifikuar dhe miratuar nga bordi udhëheqës për 10% në emër të tolerancës për shpenzime investive, pasi që kërkesa e fondit për të planifikuar mjete rezervë, nuk është në harmoni me Ligjin 04 L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, në bazë të cilit Kuvendi i Kosovës mund të caktojë taksë investive shtesë, sipas

kërkesës së fondit, e cila duhet të jetë e specifikuar dhe arsyetuar për aktivitetet investive, varësisht nga aktiviteti financiar dhe lëvizja e çmimeve në treg.

Kështu që, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që të miratohet taksa operacionale për 0,15% dhe taksa investive 0,38% për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2013. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Safetja e kreu fjalën. Tash nga koalicioni për Kosovë të Re e ka kërkuar fjalën, kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj teme, mua po më befason edhe opozita në këtë rast pse s'debaton kur dihet mjaft mirë kërkesën që e ka kërkuar Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013.

Në rast se e shohim pasqyrat të cilat i ka dërguar Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, atëherë si deputetë kemi përgjegjësi që të diskutojmë në lidhje me këtë kërkesë për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013.

U tha nga kryetarja e Komisionit mjaft qartë, që do të ishte e rrugës ndoshta, ky emision "Hajt-pak" 3-minutash dhe pyetjet parlamentare të vendosen në një pasdite dhe paradite të diskutohet, kryetar, një temë shumë e rëndësishme si kjo dhe jo tash kur janë temat shumë të rëndësishme, veç të kalohen shpejt e shpejt.

Si koalicion përkrahim vendimin e Komisionit për Buxhet dhe shpresojmë, që në të ardhmen kjo temë të vendoset pak më herët në rend dite e jo në pikën e fundit.

KRYETARI: Mirë, ju shefat e grupeve parlamentare merruni vesh dhe e qesim kur të doni. Fjalën e ka në emër të "Vetëvendosjes", Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" përkrah kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e tarifave vjetore. Kjo edhe për arsye, për shkak se janë ulë taksat menaxhuese dhe për këtë arsye domethënë e mbështesim këtë kërkesë të Fondit të Kursimeve Pensionale.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës, meqenëse është shqyrtuar kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013, këto janë shqyrtuar edhe në Komisionin Parlamentar, ku Komisioni është në përbërje nga të gjitha grupet parlamentare me përfaqësues, është votuar në Komision dhe ne do ta përkrahim.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Faleminderit! Pika e 15-të e rendit të ditës:

15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Po shkojmë. Partia Demokratike i ka dy kandidatë, kë e propozoni?

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon Xhevahire Izmakun dhe Ganimete Musliun, ndërsa, Xhevahire Izmakun si kryetare të Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike, kryetari i Grupit Parlamentar, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne propozojmë zonjën Lirie Kajtazi dhe zotin Hashim Deshishkun.

KRYETARI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja” e ka fjalën deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne propozojmë deputeten Albulena Haxhiu të jetë anëtare e Komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës një anëtar. Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës propozon deputeten Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e ka fjalën. Ju?

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re propozon deputeten Suzan Novobërdaliun.

KRYETARI: Faleminderit! SLS-ja kryetari Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke za ad hoc komisiju predlaže poslanika Hamzu Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi 6+, nuk ka. Grupi Parlamentar ZB-ja, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!
Poslanička Grupa Zajednička Budućnost predlaže Milivoje Stojanovića.

KRYETARI: Faleminderit! Por, pasi që nuk kemi kuorumin për votim, votojmë prej pikës 11 deri në pikën 15, do të thotë katër çështje kemi për t'i votuar. Nëse jeni dakord, nesër në orën 11:00 do ta kryenim votimin dhe pastaj e kemi seancën tjetër në përkujtim të veprimtarit, Ukshin Hoti.

Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 16 maj 2013
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Para se të fillojmë, ju lus t'i vendosni kartelat dhe të përgatitemi për votim. Tani i kemi 62 kartela dhe përputhen me numrin fizik të deputetëve.

Pra, po vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar dje më 16 maj 2013.

Të pranishëm, siç tregojnë kartelat, i kemi 64. Të mos kemi më shumë kartela se deputetë? Prania fizike, i kemi 65 me kartela.

Atëherë nëse dikush ka vendosur më tepër kartela, është mirë t'i heqë. Kartelat e huaja, hiqni!

Janë 62 deputetë, kurse 63 kartela janë të vendosura. Pra, prania është 62 deputetë.

(Reagime)

Atëherë, edhe një herë votojmë për praninë. Votojmë tash!

61 deputetë, 1 ka abstenuar 62. Vazhdojmë!

Fillimisht do ta votojmë pikën *Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012.*

Diskutimet janë kryer dje. Në mbledhje janë të pranishëm 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 49 vota për, 6 kundër dhe 3 abstenime, miratohet raporti.

Mirëpo, realisht nuk po e kuptoj pse nuk po deklaroheni në votim elektronik. Veç t'i thuhet dhënë regjisë dhe Administratës që ata që nuk votojnë, i humbin mëditjet!

(Reagime)

Tash e votojmë pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës - *Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012.*

Diskutimet i kemi kryer dje. Të pranishëm tani janë 63 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012.

Në radhë e kemi pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës - *Raporti i punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012.*

Diskutimet kanë përfunduar dje. Të pranishëm tani janë 65 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 58 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012.

Pika e katrëmbdhjetë të rendit të djeshëm të ditës - *Kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013.*

Të pranishëm janë 66 deputetë. Diskutimet janë kryer dje. Lus deputetët e regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 55 vota për, 3 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi e miratoi kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013.

Dhe, pika e pesëmbdhjetë e rendit të ditës - *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtar i Komisionit të Pavarur për Media.*

Diskutimet janë kryer dje. Të pranishëm janë 66 deputetë. Kërkoj nga Grupi “6+” që ta propozojë një anëtar për këtë komision. Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputeten Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Tani na duhet një votim formal, me ngritje dore.

Kush është për formimin e këtij komisioni me kandidatët e propozuar?

Është shumica absolute. A ka kundër? Janë 3. Faleminderit!

Kuvendi e miratoi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11 të Ligjit numër 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t’ia paraqesë raport me rekomandime.

Dhe këtu e përfundojmë seancën e vazhduar, por kërkoj nga deputetët që herëve tjera të mos na e harxhojnë kohën me vonesat e tyre. Mirupafshim në seancën e radhës, në orën 12:00.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë